
Shtator 2013
Numri: 66
E përmuajshme

ETIKA

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den



ZGJEDHJET NË JETË
OSMAN NURI TOPBASH



FJALA DHE IMAZHI
TAHSIN GËRGYN



SJELLJA E MIRË NDAJ PRINDËRVE
M. JASHAR KANDEMIR



NJË DRITARE NË ZEMËR
RABIA CHRISTINE BRODBECK



TËHUAJËSIMI
ASPEKTI ETIK DHE ESTETIK
EDISON ÇERAJ



DR. AID EL KARNI
KUR SUKSESI BËHET MËKAT!

Feja DHE NJERIU

në kohët moderne

ISSN 2227-3611


şimşek
Hayatın Tatlı Yanı...
Bien
Croissant
Cocoa Cream
Bien
Croissant
Bien
Croissant
Tio
Ring
10 Adet
Paradise
Chocolate Chip Cookies
Roxy
Karamelli
Roxy
Fıstıklı
www.simsek.com.tr

Editorial

بسم الله الرحمن الرحيم

Njeriu që iku prej shtëpisë së Allahut, pasi u përplas sa andej këndej, e kuptoi se nuk mund ta vazhdonte jetën e tij kështu, i vërvitur në vlera dosido dhe ndjeu nevojën për të disiplinuar vetveten. Dhe për të arritur këtë, në vend që t'u kthehej përsëri burimeve hyjnore, u prir t'i prodhojë vetë vlerat...

Dijetarët islamë e kanë përkufizuar fenë me një shprehje shumë kuptimplote: **"et-Ta>dhim li emril-lah ue>sh - shefkatu ala halkil-lah"**, e cila do të thotë: **"Pranimi dhe respektimi i ligjeve/rregullave të Allahut, si vlerat më të larta dhe mëshirë ndaj krijesave të Allahut"**. Nga një anë, vërejmë një marrëdhënie që e sheh primare **"mëshirën"** ndaj të gjitha krijesave, një sistem shoqëror që ka për parim mëshirën dhe, nga ana tjetër, vërejmë dëshirën që kjo të arrihet me anë të besimit në Allahun, besnikërisë, lidhjes dhe respektit ndaj Tij... Që kontrolli i fuqisë të lidhet me **"pushtetin hyjnor"**...

...

E gjithë jeta njerëzore rrjedh prej Ademit (a.s.), njeriut të parë, profetit të parë, i cili u krijua prej Allahut nga dheu i tokës, por u krijua në Xhenet, në fshehtësi të plotë, larg pamjes së të gjitha krijesave të tjera qofshin këto edhe engjëj. Mandej, formës së krijuar pa jetë Allahu i fryu nga Shpirti i Tij. Këtu mori jetë krijesa e re, e quajtur Adem (Njeri). Me fryrjen e Shpirtit në brendësi të kësaj forme, Ademit iu mësuan emrat e Allahut, cilësitë e Tij, emrat e sendeve, kuptimet dhe lidhjet me to. Engjëjt u habitën dhe lavdëruan Allahun me falënderime të larta, pasi që më parë i ishin bindur urdhrit për t'i rënë në sexhde krijesës së re.

Pra Ademi, qenia e re në jetën e tij njerëzore tashmë ishte një qenie e gjallë dhe e udhëzuar drejpërdrejt prej Allahut dhe kishte pëlqimin dhe favoret e Tij. Ai ishte njohës i realiteteve të larta të Xhenetit dhe kjo aftësi njohëse iu dha prej Gjithëditësit, i Cili e vuri atë para një sprove besimi. Të mos hante nga pema e ndaluar. Kjo ndalesë tregon se Ademi ishte një krijesë dhe krijesat janë të kufizuara e duhet të jetojnë mes rregullave të besimit. I gënjyer prej Iblisit, Ademi hëngri nga pema e ndaluar, duke thyer ndalesën, duke mos e kaluar sprovën e besimit. Kjo solli rënien e tij në tokë, ku do të shtonte llojin e vet e, kur të vinte udhëzimi (Librat e Allahut), kush do ta ndiqte, do të shpëtonte. Me ardhjen e Kuranit feja u përsos. Besimi u lartësua, megjithëse sprovat u shtuan. Kurani është udhëzues për njeriun, një mënyrë se si njeriu t'i përballojë sprovat e jetës së përkohshme në tokë, duke mos harruar atdheun e vërtetë, Xhenetin.

Jeta si sprovë u lehtësua nga Kurani si udhëzues për kalimin me sukses të sprovave në tokë, ky libër i Allahut, është një libër ku sqarohen të gjitha çështjet e kësaj bote dhe ahiretit. Ky libër rikthen dritën e besimit dhe mënyrën e adhurimit, jep lajmin e mirë për besimtarët dhe paralajmëron tiranët dhe jobesimtarët. Jeta ka rregulla, besimi janë rregullat e jetës, ligjet e e saj. Allahu krijues i Gjithëdijshëm krijon me rregull dhe pastaj udhëzon krijesat, duke u treguar kufijtë e së lejuarës dhe të së ndaluarës.

Pra jeta njerëzore është e frymëzuar që në krijim me besimin, nuk ka njeri pa besim. Besimi i është brendashkruar, sepse kufijtë janë brendashkruar. Jeta është si uji, kurse besimi është si ena. Uji nuk ka formë të vetën dhe i duhet ena, forma dhe edukimi që të marrë formë. Njeriu e ka të vështirë ta pijë ujin e jetës pa enën e besimit, por ka raste edhe kur njeriu e fut ujin e jetës brenda enës së besimit, i mbyll tapën fort dhe e hedh atë në errësirat e egos dhe ndihet sërish i humbur. Uji dhe ena duhen përdorur për të ngjallur shpirtin, i cili ndihet ngushtë në këtë botë të vogël. Kjo ringjallje ka të bëjë me kujtesën e fshehur të xhenetit, që ndodhet brenda zemrës sonë.

Jeta dhe besimi na janë dhënë të dyja: jeta si sprovë, kurse besimi si lehtësim. Allahu është Lehtësuesi dhe krijuesi i sprovës. A do ta kujtojë krijesa njerëzore, që mori përsipër përkujtimin dhe adhurimin e Allahut? Jo pa ndihmën e Tij, sepse ai ka krijuar sebepe pa fund për të na afruar me Veten. Dhe sebepi më i madh i krijuar është Profeti Muhamed, drita e Mëshirës, ngjallësi i besimit, dashurisw dhe shpresës, dhënësi i jetës së përhershme, imami i imamëve, Profeti i profetëve...

Revista ETIKA

Shtator 2013

VITI: VII
NUMRI: 66

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR & KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahusha

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime. com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni : 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Përmbajtja










5 **Feja dhe njeriu në kohët moderne**
Ahmet Tashgetiren
10 **Gara për në xhenet**
Ali Riza Temel
12 **Allahu është i paperceptueshëm, përse?**
Nexhat Ibrahimi
15 **"Me dashtë" tha Zoti dhe u krijua Muhamedi (a.s.)**
Albri Brahusha
16 **Sjellja e mirë ndaj prindërve**
Prof. dr. M. Jashar Kandemir
21 **Mund të fle edhe në stuhi**
A. Jasin Demirxhi
22 **I'tisami**
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
27 **Shija e jetës**
Mehmet Dinç



Njohja e Prof. dr. Geri Miler me Islamin 28

Përmasa sociale e besimit 30
Prof. dr. Mehmet Gërmez
Një Ajet - Një Hadith 32

Rilindja ka nevojë për njerëz të rinj 39
Atasoj Myftiollu
Të qash për gjynahun tënd 40
Salih Zeki Meriç
"Ata që e lexojnë librin e Allahut... shpresojnë në një tregti që kurrë nuk humbet" 42
Imam Muhamed Sytari
Ç'të mbjellësh do të korrësh 44
Filiz Konxha
E vërteta ime! 46
Ma. Luan Afmataj
Përse? 48
Xhemal Nar







FEJA DHE NJERIU
në kohët moderne

Ahmet Tashgetiren

Nga aspekti i **"vlerës"**, ajo që i nevojitet njeriut të parë në tokë ose e shprehur ndryshe, njeriut të parë që është krijuar, është përgjigjja e pyetjes se cilat do të jenë zgjedhjet e tij në lidhje me vetveten dhe botën që e rrethon.

Kur në mes futet edhe një njeri i dytë, përsëri nga aspekti i **"vlerës"**, lind pyetja se cili do të jetë kuadri i marrëdhënieve midis dy njerëzve. Kur rritet numri i njerëzve, tashmë nevojitet kërkimi i **"vlerës"** për një shoqëri të tërë. Islami dhe fetë hyjnore, në të gjitha këto raste, kësaj pyetjeje i përgjigjen me faktin se njeriu i parë ishte edhe profeti i parë. Ndërsa profeti është njeriu, që i ka sjellë njerëzimit lajme, dije dhe mesazhe prej Krijuesit ose e përmbledhur në një shprehje të vetme që i përmban të gjitha këto, një **"Hartë rrugore"**. Emri i përveçëm i mesazhit që vjen prej Krijuesit, është **"vahj/shpallje"** dhe gjithësia e vahjit, nënkupton **"fenë hyjnore"**.

Po të tjerët si e shpjegojnë? P.sh. të marrim shpjegimin e Tomas Hobs. Sipas tij, njerëzit e fillojnë udhëtimin si ujqër të njëri-tjetrit. Parimi i tyre është ngrënia e njëri-tjetrit, përplasja, goditja dhe eliminimi... Kështu kalojnë vitet. Më vonë, njeriu e kupton se nuk ecet duke ngrënë tjetrin dhe thotë: *"Ta ndalim përplasjen. Të formojmë një forcë që është mbi të gjithë ne dhe t'i japim të drejtën të zgjidhë mosmarrëveshjet midis nesh, duke pranuar çdo gjykim të tij."* Hobs mendon se kështu kanë lindur **"shteti"** dhe **"parimet e shtetit"**. Mirëpo, Hobs nuk mjaftohet me kaq. Ai shprehet se në fazat e mëtejshme të "shtetit", fuqia që i është dhënë atij, shndërrohet në një përbindësh. Ky përbindësh është një krijesë që e ka marrë emrin prej Teuratit/Torës dhe Inxhilit/Ungjillit dhe simbolizon të keqen. Emri i tij është **"Leviathan"**.

Tomas Hobs e shpjegon këtë koncept në librin e tij *"Leviathan, brendësia, forma dhe fuqia e një shteti fetar dhe botëror"*:

"Mënyra për t'i mbrojtur ata (shtetasit) nga pushtimi i të huajve, për t'i penguar që të dëmtojnë njëri-tjetrin dhe për të siguruar industrinë e tyre dhe frytet e tokës, është t'ia japësh të gjithë fuqinë dhe pushtetin një njeriu ose një këshilli (parlamenti) njerëzish... Njerëzit (që jetojnë në shoqëri), duhet t'i thonë njëri-tjetrit, *"Unë heq dorë prej të gjitha të drejtave të mia dhe ia jap ato këtij njeriu ose këtij këshilli njerëzish"*. Në këtë mënyrë, e gjithë fuqia dhe pushteti përqendrohet në një njeri të vetëm. Ky quhet shtet, ose latinisht *"civitas"*. Kjo është lindja e Leviathan-it të madh."

Kjo mënyrë shpjegimi, *-më parë sheh nevojën e një* ***"vlere"*** *të njerëzve që jetojnë në shoqëri. Pastaj, në kuadër të kësaj vlere, sheh të nevojshëm një autoritet, i cili do të menaxhojë marrëdhëniet njerëzore. Ndërsa në fazën e tretë, parashikon transferimin e përgjegjësisë së përfaqësimit tek ky autoritet dhe respektimin e vendimeve të tij.* Mirëpo Hobs, këtu nuk e anashkalon piketimin e rrezikut të kthimit në një përbindësh të këtij autoriteti, që i është dhënë përgjegjësia e përfaqësimit. Në fakt, ky është edhe problemi që ekziston së bashku me njeriun: Si do të

mbahet nën kontroll kjo fuqi? Edhe një njeri i dobët ka një farë fuqie dhe, nëse ai e përdor atë pa kontroll, mund të bëhet i rrezikshëm për njerëzit. Por kur fuqia e njeriut të marrë dimensione të paimagjinueshme, përdorimi i saj sjell në rend të ditës një zhdukje/katastrofë në shkallë universale. Në analizën e Hobs, shteti i cili del në skenë si një forcë rregullatore, është një institucion që do të menaxhohet nga njerëzit. Hobs nuk e sheh të pamundur që një institucion njerëzor të kthehet në **"Leviathan, në një përbindësh"**. Prandaj lind nevoja e një **"vlere mbizotëruese"** dhe një **"përgjegjësie"**, e cila do ta kufizojë, si fuqinë e një njeriu të vetëm, ashtu edhe fuqinë e një njeriu të pajisur me vullnetin e shtetit. Pra, çështja është të zgjedhësh: ose çdo gjë do të përcaktohet/kontrollohet nga fuqia e një njeriu apo e shtetit, ose të gjitha fuqitë do të lidhen pas një pushteti mbizotërues, ndaj të cilit do të mbajnë përgjegjësi... Në fakt, nëse zgjidhet që një person ose shteti të jetë përcaktues/kontrollues fuqie, gjithmonë ka rrezik që në një farë pike ata të kthehen në një **"përbindësh lufte"**.



Kurani fisnik demaskon ***"fuqinë brenda njeriut që me këmbëngulje nxit të keqen"***. Kjo do të thotë se edhe një njeri i vetëm edhe formacione të tjera, mund të bëhen provokatorë luftërash... Nëse i referohemi kohës sonë, vërejmë se bota është kthyer në shesh lufte të hapur apo të fshehtë, nga përbindësha të vegjël e të mëdhenj. Një gjë është e vërtetë, aq sa rritet fuqia, aq rritet edhe nevoja për ta kontrolluar atë. Kjo, sepse fuqia e pakontrolluar, në çdo moment është e gatshme të largohet nga të qenit një forcë pozitive dhe të kthehet në një forcë **"shkatërruese"**. Dhe me të vërtetë që njeriu i kohës sonë ka arritur fuqi të jashtëzakonshme, në sajë të zhvillimeve shkencore dhe teknologjike. Nëse parimi, **"njeriu është ujk i njeriut"** vazhdon të rrjedhë ende në damarët e njeriut, ai tashmë është pajisur me fuqi të jashtëzakonshme për të zhdukur ekzistencën e vet dhe të universit. Tashmë, në sajë të një arme shkatërrimi në masë, mund të fshish nga faqja e dheut vende e popuj. Duke manipuluar gjenet njerëzore, mund të nxirrni qenie krejt të ndryshme: mund të vrisni fëmijët në barkun e nënës, mund të bëni qitje mbi fëmijët, mund të ndërtoni fusha të vdekjes, Gulaufe, Guantanamo, Ebu Garibë, Palestinë, Bosnjë, Çeçeni, Ruanda etj...

Çfarë do ta ndalojë njeriun? Ta supozojmë se Leviathani i kohës sonë është Amerika. Çfarë do ta ndalojë atë? Ta supozojmë se është Kina, Rusia apo Izraeli. Kush dhe si do t'i ndalojë këta kur të përdorin forcën?.. Thuhet: **"Mirë që ka një ekuilibër force, sepse në këtë mënyrë nuk mund të përdoren armët e shkatërrimit në masë. Nëse njëri prej tyre e përdor, duhet të marrë parasysh se do i vërë flakën gjithë botës."**

Shikoni pra këtë dilemë pa rrugëdalje! Duhet të zotërosh fuqi vdekjeprurëse, që jeta e njerëzve të vazhdojë! Në fakt, nuk është se njeriu nuk po kërkon vlera që do ta kapin për dore. Për sa i përket të drejtave njerëzore dhe rregullit universal, disa **"Marrëveshje Universale"**, mund të shihen si reflektimi i kërkimit të një **"vlere mbizotëruese"** në planin universal.

Nevoja për **"vlera etike"**, e cila kohët e fundit po përmendet shumë, pa diskutim që shpreh domosdoshmërinë e një vlere obliguese mbizotëruese. Mirëpo edhe ndjenja e vlerës etike mund të ngelet e pakuptimtë përballë njeriut, i cili ka prirjen të gdhendë gjithçka sipas vetes së tij. Për shembull, Amerika dhe Turqia janë dy shtete, të cilat nuk e nënshkruajnë marrëveshjen e Kjotos. Marrëveshja e Kjotos cakton parimet e ruajtjes së ambientit dhe të ekuilibrit ekologjik. Pra, që të shpëtojë ajri, uji dhe të mbjellat. Që njeriu të mos helmohet kur të marrë frymë. Por me pretekste të ndryshme, si Amerika, ashtu edhe Turqia nuk e firmosin atë.

Një shembull tjetër, klonimi... Për shkak të "vlerave etike", rrethi shkencor ende nuk e konsideron të drejtë këtë çështje. Por dikush nga krahu tjetër, duke vënë në lëvizje vlerat etike personale, mund ta legalizojë manipulimin me fatin e njerëzimit.

Feja... Ajo i sjell të gjithë njerëzimit një vlerë mbizotëruese. Feja deklaron se përcaktuesi i këtyre vlerave, është **"Krijuesi"**. Feja ligjëron rregullin se të gjithë

të fuqishmit janë të lidhur pas këtyre vlerave. Pra, Ai është zotëruesi i fuqisë absolute. Pranë fuqisë së Tij, askush dhe asnjë forcë nuk mund të shndërrohet në një Leviathan. Askush nuk ka të drejtë të bëhet Leviathan, qoftë në emër të Tij, qoftë kundër Tij. Ai nuk do që në tokë të ndodhin ngatërresa. Nuk do që njerëzit t'i kalojnë kufijtë. Çdo njeri dhe çdo forcë duhet të qëndrojë brenda **"kufijve hyjnorë"**. Ai që i kalon kufijtë do të përballet me pushtetin hyjnor. Në këtë pikë, një pjesë e dënimit është lënë për në "botën tjetër". **"Ndjenja e përgjegjësisë para Allahut"**, është kuadri i edukimit kryesor i të gjitha feve. Por kjo nuk është pengesë për zbatimin e dënimeve brenda kornizës së "kufijve hyjnorë" në këtë botë. Ndërsa, në rastet kur nuk merren fare parasysh kufijtë hyjnorë, formohet një fushë force plotësisht e pakontrolluar, e cila quhet **"tirani"**. Dhe aty, ku nuk janë marrë parasysh kufijtë hyjnorë, në çdo kohë kanë ndodhur tirani të papara.



Por, a s'mund të kthehen në përbindësha njerëzit, duke përdorur "kufijtë hyjnorë"? Sigurisht që mund të kthehen në përbindësha. Por edhe lufta me ta, përsëri mund të bëhet duke kujtuar kufijtë hyjnorë. ***"Allahu nuk e do tiranin dhe tiraninë!"***

Në fakt, kërkimi i **"vlerave etike"** është kërkimi i fesë.

Njeriu që iku prej shtëpisë së Allahut, pasi u përplas sa andej këndej, e kuptoi se nuk mund ta vazhdojë jetën e tij kështu i vërvitur në vlera dosido dhe ndjeu nevojën për të disiplinuar vetveten. Dhe për të arritur këtë, në vend që t'u kthehet përsëri burimeve hyjnore, priret t'i prodhojë vetë vlerat. Ajo, të cilën e quajmë **"vlerë etike"**, nuk është gjë tjetër veçse një orientim kah vlerat e përbashkëta të prodhuara nga njeriu.

Në fakt, të ashtuquajturat **"vlera etike"** zënë vend brenda një kuadri më gjithëpërfshirës, p.sh. brenda kritereve hyjnore. Por me kusht që të qëndrojnë të lidhura me vetëdijen e përgjegjësisë ndaj Allahut Teala...

Dijetarët islamë e kanë përkufizuar fenë me një shprehje shumë kuptimplote: **"et-Ta'dhim li emril-lah ue'sh - shefkatu ala halkil-lah"**, e cila do të thotë: **"Pranimi dhe respektimi i ligjeve/rregullave të Allahut, si vlerat më të larta dhe mëshirë ndaj krijesave të Allahut"**. Nga një anë, vërejmë një marrëdhënie që e sheh primare **"mëshirën"** ndaj të gjitha krijesave, një sistem shoqëror që ka për parim mëshirën dhe, nga ana tjetër, vërejmë dëshirën që kjo të arrihet me anë të besimit në Allahun, besnikërisë, lidhjes dhe respektit ndaj Tij... Që kontrolli i fuqisë të lidhet me **"pushtetin hyjnor"**... Në historinë islame, parimi që reflektonte rregullin shtetëror ishte ky: ***"Mos u mburr o padishah, Allahu është më i madh se ti!"***

Ndërsa Allahu Teala i ka tërhequr vërejtje Pejgamberit tonë (a.s.), me këto fjalë:

"...Ti je vetëm këshillues dhe jo i ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!" (Gashije, 21-22.)

Përderisa edhe Pejgamberi (a.s.), nuk mund të jetë **"detyrues"** në marrëdhëniet fe-njeri, as klerikët fetarë nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë.

Nëse i referohemi Kuranit Kerim, na bëhet e qartë se **"kthimi në zot i klerikëve fetarë"**, është një devijim i madh nga rruga hyjnore. (shih. et-Teube, 31.) Feja islame u ka vënë kushte të gjitha fushave të forcës jashtë Allahut Teala dhe burimin e lejes së tyre e ka kufizuar me llogarinë që do t'i jepet Allahut Teala. Në bazë të kësaj, çdo forcë është e detyruar të përdoret në atë mënyrë, që të mund të jetë e justifikuar përballë vullnetit hyjnor...

Jemi në një kohë kur mendja e njeriut është shumë e turbullt. Pyetja: **Si do të pastrohet turbullira e mendjes së njeriut?**, ka vetëm një përgjigje:

Duke u mbështetur në hartën e rrugës, që Krijuesi e ka përpiluar për njeriun me anë të Islamit... Nëse do ta shprehim me gjuhën kompjuterike, duke formatuar zemrën dhe mendjen... Duke u kapur përsëri pas dorës së Rasulallahut, Muhamed Mustafait sal-lallahu alejhi ue sel-lem...



Prof. dr. Tahsin Gërgyn

FJALA DHE II

Filozofi gjerman Martin Haideger, në një broshurë të botuar në vitin 1938, duke marrë në konsideratë karakteristikat dalluese të epokës moderne e shpalli atë si epokën e imazhit.

Një nga fjalët shumë të përdorura dhe të përhapura sot është "image is everything" (imazhi është çdo gjë). Në psikologjinë sociale dhe në shkencat sociale, madje edhe në politikë, njeriu nuk përcaktohet nga vlera e tij si qenie njerëzore, por nga pozita dhe vlera që ka në syrin e të tjerëve.

Prandaj, pikëpamjet funksionaliste dhe strukturaliste, vlerën dhe praninë e njeriut e kanë reduktuar vetëm me funksionin që kryen brenda një strukture. Shprehja e gjithë kësaj me konceptin "rol" tregon lidhjen e ngushtë të vlerësimit përmes imazhit, duke i bashkëngjitur këtu dominimin e mendimit se vetëm veprat e dukshme kanë kuptim dhe njeriu nuk është gjë tjetër veçse produkt i veprimeve të tij të jashtme, për rrjedhojë, diskutimi mbi "shpirtin" si entitet i padukshëm dhe i pavarur nga veprimet dhe sjelljet, është i pakuptimtë, dhe vjen si shkak i rrëzimit të vlerës së njeriut vetëm në imazh dhe veprimet e tij të jashtme.

Dominimi i botëkuptimit monist mbi jetën në epokën moderne ka sjellë braktisjen pothuajse krejtësisht të një të vërtete të madhe dhe të pavarur nga njeriu. Kjo pikëpamje mbi jetën ka sjellë një drejtësi të bazuar mbi forcën dhe për pasojë e drejta u takon atyre që zotërojnë forcën dhe fuqinë. Për këtë shkak edhe dituria vlerësohet si mjet për arritjen e fuqisë.

Artet e promovuara në periudhën moderne pothuajse të gjitha i adresohen syrit dhe të gjitha e perceptojnë njeriun si "sy". Botën në këtë këndvështrim mund të themi lehtësisht se e kanë ndarë në dy pjesë, në vëzhgues dhe të vëzhguar, në subjekt dhe objekt. Zhvillimi i kinemasë, mbështetja e lajmeve me pamje, zgjerimi i fushës vizuale dhe kulturës pamore në përgjithësi, tregon një botë ku sundimi mbi njeriun realizohet përmes imazhit. Bota reale po merr gjithnjë e më shumë pamjen e një bote virtuale të bazuar në imazhe të lëvizshme.

Imazhi është një figurë, një shëmbëlltyrë. Ngaqë është shëmbëlltyrë e diçkaje apo e dikujt, imazhi i përket më shumë subjektit që e shëmbëllen se sa objektit të shëmbëllyer, i përket më shumë shenjuesit sesa të shenjuarit. Megjithëse shëmbëllimi po e trondit truallin e reales, ai nuk mund ta zëvendësojë kurrë qenien reale. Koncepti "imazh" po gjen hapësirë përdorimi në shumë fusha, përfshi edhe fushën fetare. Por përdorimi i koncepteve të tilla në fushën e fesë është me shumë risk. Sepse nuk mund të krijohet një ide, koncept apo imazh në çështjet e fesë sipas dëshirës së njerëzve.

Prandaj, në asnjë mënyrë imazhi nuk mund të shprehë realitetin; fundja imazhi nuk është gjë tjetër veçse një trillim. Ai mund të përputhet ose jo me realitetin në raporte të ndryshme. Imazhi është shprehje e përpjekjes për t'i gjetur ekzistencës një burim njerëzor.

Gjuha ndryshon thelbësisht në krahasim me imazhin.



IMAZHI

Megjithëse i përket njeriut, ajo nuk mund të jetë pronë e një njeriu të vetëm, gjuha është ndërnjerëzore. Një njeri mund të zotërojë njëherësh disa gjuhë. Është interesante se filozofi i lartpërmendur Haideger, i cili konstatoi problemet që do të sjellë imazhi, si zgjidhje propozoi gjuhën. Sepse në gjuhë dhe përmes gjuhës ne krijojmë marrëdhënie dhe komunikim me të vërtetën. E vërteta derdhet në fjalë, pra në gjuhë dhe e vërteta e shprehur në fjalë shërben si pikëmbështetje për gjithë njerëzimin, si në marrëdhëniet vertikale, ashtu edhe në ato horizontale. Njerëzit përmes gjuhës arrijnë komunikimin dhe bashkimin rreth saj. Si tërë gjithësia edhe feja islame ka filluar me një fjalë.

Në periudhën klasike islame njeriu është cilësuar si qenie që flet, pra është synuar përkufizimi i tij mbi bazën e gjuhës.

Gjëja e parë që i është mësuar njeriut janë "konceptet". Njohja e emrit të sendit është shkalla e parë drejt njohjes së atij sendi. Çdo gjë e fiton vlerën e vërtetë vetëm kur shprehet me anë të gjuhës. Dukuria e të folurit më së paku ndodh midis dy palëve. Njëri është përçuesi i mesazhit, tjetri marrësi i mesazhit. Kur e kupton palën përballë, nuk mund të hiqesh sikur nuk kupton. Kuptimi është përkapja e domethënies së një fjale (shenje). Zbulimi i së vërtetës përmes gjuhës siguron bazën për zbulime krejt të reja.

Megjithëse midis imazhit dhe syrit ka një lidhje të ngushtë, imazhi nuk duhet përdorur për të manipuluar syrin. Ashtu si imazhi mund të konsistojë në keqpërdorimin e syrit, ashtu edhe gjuha mund të bjerë në të njëjtën gjendje. Edhe gjuha mund të keqpërdoret. Gjuha shumë lehtë mund të bëhet një mjet keqinformimi dhe mashtrimi. Ai që do të verifikojë gjuhën dhe do ta pengojë atë nga keqpërdorimi është syri. Këtë rol nuk mund ta luajë syri si shqisë shikimi, por syri i zemrës. Vetëm ai mund të provojë vërtetësinë dhe saktësinë e diçkaje. Ndërsa imazhi e injoron syrin e zemrës duke u fokusurar vetëm te syri si shqisë shikimi.

Imazhi, i cili i ofron njeriut si mjet verifikimi vetëm syrin, duke injoruar plotësisht syrin e zemrës, ka çuar në manipulimin e njerëzve, kurse verifikimin e saktë mund ta kryejnë vetëm ata që shikojnë përmes syrit të zemrës, të cilët nga ana e tyre kanë mundësinë e vlerësimit edhe përmes imazhit edhe përmes gjuhës.

Në gjuhë gjenden njësi bazë, si predikati, pyetja dhe urdhri. Predikati e nxit njeriun të pohojë ose të mohojë, pyetja e nxit për kërkim dhe studim, kurse urdhri parashikon vullnetin e lirë të subjektit për t'u bindur ose për të kundërshtuar urdhrin. Sado që bukuria fizike perceptohet me anë të shikimit, bukuria e vërtetë mund të perceptohet vetëm përmes syrit të zemrës. Kjo tregon që bukuria nuk është e lidhur vetëm me syrin, por me të gjitha organet e tjera shqisore. Bukurinë, aq sa e percepton syri, e percepton edhe dora. Madje syri në bashkëpunim me dorën bëjnë ndryshime në botën fizike, duke krijuar artet, zanatet, godinat, lagjet, qytet, etj.

Në literaturën klasike islame dora shpreh fuqinë dhe forcën për të ndryshuar. Mirëpo forca nuk është karakteristikë dalluese e njeriut, përkundrazi, forca është jonjerëzore. Ajo që e shndërron forcën në mjet arti është arsyeja.

Duke qenë diçka e krijuar nga njeriu, imazhi fiton kuptim dhe ekzistencë në raport me fuqinë e njeriut.

Krijuesit e imazhit, duke qenë se vendosin vetë për mënyrën e përdorimit të tij, e instrumentalizojnë atë. Midis imazhit dhe krijuesit të tij ka një marrëdhënie të njëanshme të detyruar. Piktura me pretendimin e të vërtetës e vendos njeriun përballë faktit të kryer. Kurse në komunikimin gjuhësor kemi bashkëbisedim, pjesëmarrjen e të paktën dy palëve.

Feja islame është fe me profet. Pejgamberit (a.s.), zbulesa i ka ardhur me anë të gjuhës. I gjithë qytetërimi islam është shprehje e ndryshimit dhe projektimit që solli kjo gjuhë. Krishtërimi, i bazuar në filozofinë e mishërimit, u zhvillua përmes pikturës, pra kulturës pamore. Në qytetërimin islam mjeti kryesor i komunikimit është gjuha, kurse në krishtërim piktura. Kuptimi i ri që ka fituar piktura dhe imazhi në periudhën moderne, në fakt është i lidhur ngushtë me krishtërimin.

Jeta e njeriut në periudhën moderne po orientohet gjithnjë e më shumë drejt një dimensioni, kryesisht drejt imazhit dhe kulturës pamore. Syri po perceptohet si mjeti i vetëm lidhës midis njeriut dhe botës. Sot gjithnjë e më shumë po jetojmë në një botë imagocentriste. Por së fundmi, shumë mendimtarë kanë zbuluar gjuhën dhe po kërkojnë rrugët për të gjetur të vërtetën përmes gjuhës. Në të ardhmen, ecuria e lidhjes së njeriut me gjuhën do të përcaktohet nga rezultatet.



Gara për në xhenet

Ali Riza Temel

Parë nga një këndvështrim, jeta është një garë. Në përgjithësi, gara bëhet në vepra të mira ose në të këqija. Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë: ***Thuaj: "Çdokush sillet sipas mënyrës së vet, por Zoti juaj e di më së miri se kush është në rrugën më të drejtë."*** (Isra, 84.)

Ka prej atyre që e shikojnë të shëmtuarën të bukur dhe të bukurën të shëmtuar. Ata që garojnë në të këqija dhe në të mira, pandehin se po bëjnë punë të mira dhe të bukura. Për këtë arsye, caktimi i së mirës, së keqes, së bukurës dhe së shëmtuarës, nuk mund t'i lihet vetëm dëshirës dhe mendjes së njeriut. Dëshira dhe mendja e shëndoshë mund të formohen vetëm nën edukimin e shpalljes hyjnore.

Edhe pse virtyti më i bukur i femrës është turpi, ata të cilët e zhveshin atë nga kjo bukuri dhe e ulin deri në bukurinë fizike, nuk po garojnë në diçka të bukur, por në diçka të shëmtuar. Bukuria e përhershme nuk është në trup, por në shpirt. Siç ka thënë edhe Mevlana, parfumin duhet t'ia hedhim shpirtit dhe jo trupit. Sidoqoftë, trupi në fund do të kalbet dhe do të bëhet dhe. Asgjë nuk ka ngelur prej trupave të atyre që janë zgjedhur të bukurat e vendit apo të botës. Atëherë, ne duhet të garojmë për të stolisur gjërat e përhershme. Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë:

"Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt ..." (Kehf, 46)

Lojërat dhe sporti në përgjithësi janë objekt i garës. Në fund të këtyre lojërave, fitohen shpërblime simbolike ose shpërblime që kanë vlerë materiale. Shpërblimi i garës lidhet me vështirësinë e saj. Shpeshherë, këto gara janë gara për jetë a vdekje.

Garat që bëhen për një çështje dhe shpërblim të vlefshëm, janë garat që bëhen në dije, kulturë, në fushën e mirësisë dhe atë të shërbimit (hyzmetit), prej të cilave kanë dobi individët dhe shoqëritë. Frytet e këtyre garave janë të përhershme. Ndërkohë që gara e një loje futbolli jep vetëm një emocion të çastit, dobia e një zbulimi shkencor, e një vakëfi apo e një vepre letrare zgjat për shekuj të tërë.

Allahu i Madhëruar na lajmëron se në cilën fushë duhet të garojmë:

"Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t'ju mbledhë të gjithëve; Ai është i Fuqishëm për çdo gjë." (Bakara, 148.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë se smira nuk mund të gjendet në kërkimin e dijes dhe në shpenzimin e pasurisë në mirësi, por që më e shumta mund të të kihet zili.

Së pari, shpërblimi më i madh për të cilin ia vlen të garosh, është kënaqësia e Allahut Teala, pastaj xheneti dhe xhemalullah (shikimi i Allahut), të cilat janë rezultat i kësaj. Allahu Teala thotë:

"Prandaj garoni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është i përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ajo është mirësia e Allahut që ia jep kujt të dojë. Allahu ka mirësi të pafund." (Hadid, 21)

"Me të vërtetë, të mirët do të gjenden në xhenet duke shikuar nga fronet mirësitë që u janë dhënë. Ata do t'i njohësh prej fytyrave të tyre, që shkëlqejnë nga lumturia. Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë, fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të garojnë ata që përpiqen." (Mutaffifin, 22-26)

Nëse dikush nuk e ka fituar dot lumturinë e përhershme, xhenetin, do të thotë se nuk ka fituar asgjë, sepse fitimet e përkohshme marrin fund. Çdo gjë e kufizuar konsumohet. E rëndësishme është që të përkohshmen ta kthejmë në të përhershme. Hazreti Isai (a.s.) ka thënë:

"Çfarëdo që të keni, shiteni dhe jepeni sadaka! Bëni për vete torba që nuk vjetrohen dhe thesare që nuk shterrohen në qiej. Atyre nuk mund t'u afrohet hajduti dhe nuk mundet t'i prishë mola." (Luka, 12/33)

Xheneti është i përhershëm. Aty nuk ka frikë dhe as pikëllim. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik, përshkruhet xheneti, por këto përshkrime në lidhje me xhenetin janë vetëm për të formuar një tablo dhe një përfytyrim në mendjen tonë, sepse xhenetin e vërtetë është e pamundur ta perceptojmë me përmasat e kësaj bote. Xheneti, siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka një bukuri që *"asnjë sy s'e ka parë, asnjë vesh nuk e ka dëgjuar dhe asnjë mendje s'e ka perceptuar"*. Për shkak se xheneti, që nuk mund ta shohim, nuk mund të përkufizohet me të panjohurën, mund të përfytyrohet duke e përngjasuar vetëm me ato që shohim.



Sipas përshkrimit të Kuranit Fisnik dhe hadithëve të sakta, jeta e xhenetit mbart këto veçori kryesore:

1- Bukuri të përhershme dhe rehati.
2- Paqe dhe qetësi të vazhdueshme.
3- Forcë dhe shëndet shpirtëror dhe fizik.
4- Ngopje shpirtërore.
5- Shikimin e Allahut Teala.
6- Përjetësinë.

Kur të hyjnë në xhenet, të gjithë besimtarët do të mirëpriten nga engjëjt dhe do t'u thuhet:

"Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: 'Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, ndaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!" (Zumer, 73)

Besimtarët do të hyjnë në xhenet duke përhapur drita si hëna e plotë ose si yjet ndriçuese. Aty do të hanë dhe do të pinë si të dëshirojnë. Tretja e ushqimeve që do të hanë, nuk do t'u sjellë ndonjë vështirësi tjetër, përveçse gromësirë dhe djersë me erë të mirë. Banorët e xhenetit nuk do të kenë nevojë për gjumë, ngaqë nuk do të ndjejnë lodhje dhe mërzi.

Gjithmonë do të jenë të shëndetshëm dhe kurrë nuk do të sëmuren. Do të jetojnë përgjithmonë dhe nuk do të vdesin. Rinia dhe gjallëria e tyre nuk do të prishet. Do ta arrijnë lehtë çdo gjë që e dëshirojnë. Do të shikojnë çdo gjë që dëshirojnë. Në zemrat e tyre nuk do të ketë urrejtje dhe smirë. Përfundimisht, do të jetojnë në një lumturi të përhershme larg çdo gjëje që mund të bëhet shkak për frikë dhe pikëllim.

Dëshirat e kënaqësisë së pakët në këtë botë, atje do të realizohen në kuptimin ideal të tyre. Aty do të ketë gra të pastra, që nuk do të kenë mangësi fizike dhe shpirtërore. Lehonia, menstruacionet dhe dobësimi nuk do të ekzistojnë. Ato do të jenë në kulmin e bukurisë dhe përsosmërisë. Përtej të gjitha këtyre mirësive, banorët e xhenetit do të shohin Zotin e Lartësuar që e kanë besuar dhe nuk e kanë parë në këtë botë. Kjo lumturi do t'i lërë në hije të gjitha mirësitë e tjera.

Ne duhet të garojmë për ta fituar këtë garë dhe për ta arritur këtë shpërblim madhështor e të pafund si xheneti dhe Bukuria e Allahut. Humbjet e disa garave të tjera mund të kompensohen. Ai që humb në një lojë futbolli, mund të fitojë në një tjetër, por edhe nëse nuk fiton, nuk ndodh ndonjë tragjedi. Ndërsa, mospjesëmarrja në garën e adhurimit ndaj Allahut Teala, apo mosmarrja në mënyrë serioze e kësaj gare, nënvlerësimi i këtij shpërblimi që do të jepet në fund dhe mashtrimi i vetes me garat që janë lojëra të thjeshta, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, ***"është një humbje e qartë"***. Tragjedia e madhe si privimi nga ky shpërblim madhështor dhe futja në xhehnem, i cili është vend ndëshkimi, nuk mund të imagjinohet.

Besimtari ecën në rrugën e cila e ka fundin në xhenet. Garon në mirësi që e afrojnë te xheneti dhe e largojnë nga xhehenemi. Së fundi, me mirësinë e Allahut Teala, arrin shpërblimin e përhershëm që i është premtuar. Sa bukur ka thënë Mevlana:

"Nëse do të ecësh, ec drejt Atij që të ka dhënë këmbët!" Kjo është siratu'l-mustekim- rruga e drejtë. Fundi i kësaj rruge është kënaqësia e Allahut të Madhëruar dhe xheneti, i cili është vendi i lumturisë së përhershme. Allahu Teala na bëftë prej atyre që gjithmonë ecin dhe përparojnë në këtë rrugë!

Amin!

Allahu është i paperceptueshëm, përse?

Nexhat Ibrahimi

HYRJE

Përgjigjja në pyetjen: Pse Allahu është i padukshëm?, na çon drejt shkencës, jetës së përditshme dhe pyetjeve të zakonshme, nga fëmijëria e deri kur rritemi. Padukshmëria nuk është tipar vetëm i Krijuesit, sepse e dimë se shumë gjëra, fenomene, dukuri, nuk janë të dukshme, përkundër faktit se ekzistojnë. Për shembull, fakti konkret me hekurin dhe magnetin flet mjaft. Nëse magneti vendoset përballë hekurit (metalit), do të shohim tërheqjen e hekurit nga magneti. Pra, e shohim magnetin dhe hekurin, por jo edhe forcën që vepron përkatësisht, që i vë në veprim lëvizjet e caktuara. Ngjashëm është edhe me energjinë elektrike. Ajo nuk vërehet, nuk shijohet, nuk kapet, por i vërejmë efektet e saj në llambat elektrike etj. Të tilla janë rrezet ultravjollcë, gravitacioni dhe dukuri të ngjashme. Prandaj, nuk duhet të habitemi me faktin se Krijuesi është i padukshëm, i paperceptueshëm, i pakapshëm, kur edhe shumë dukuri, të krijuara, nuk shihen, nuk shijohen, nuk kapen me gjymtyrët, shqisat apo ndjenjat tona.

ÇFARË FORME KA ALLAHU?

Njeriu nuk e di formën e Allahut, as nuk ka kurrfarë imazhi lidhur me këtë. Forma apo dukja e Tij është jashtë mundësisë së perceptimit dhe imazhit intelektual e shqisor. Kjo bën që Ai në këtë botë të mos shihet.[1] Një dijetar merr një shembull nga përditshmëria, duke thënë se ne besojmë që stilolapsi me të cilin shkruajmë është i dizajnuar nga dikush dhe i punuar nga makineri të caktuara. Pra, ne e dimë se stilolapsi është punuar nga makineri të ndryshme, pa e parë formën e tyre, pra ky është thelbi i çështjes.

A KUNDËRSHTOHEN FEJA ME SHKENCËN?

Feja dhe shkenca në parim nuk kundërshtohen, madje shkenca në realitet çon drejt besimit po ashtu siç besimi çon drejt shkencës. Shumë dijetarë me famë botërore theksojnë se feja dhe shkenca në parim pajtohen, por gjysmëfeja dhe gjysmëshkenca mund të sjellin kokëçarje. *"Që kur ekziston feja"*, thotë filozofi El-Menufi mysliman, *"detyra e shkencës origjinale kurrë nuk ka qenë të luftojë dhe të marrë qëndrim kundërshtues ndaj saj, ta mohojë apo të gjykojë për ekzistencën apo mosekzistencën e fesë." "Funksioni i shkencës është hulumtimi, studimi dhe vrojtimi i fenomeneve natyrore e jo mohimi apo pohimi i të vërtetave teologjike, të cilat qëndrojnë jashtë fenomeneve dhe proceseve natyrore."*[2]

Albert Mac Cub Dinshtiz, profesor i biologjisë në Fakultetin Bailor dhe ish-dekani i Akademisë së Shkencave në Floridë thotë:

"Duke punuar në fushën e shkencës e kam ndihmuar besimin tim në Zotin në atë masë, sa u bë më i fuqi-

1. Sami Xheko, Udhëzime praktike akaidore dhe fikhore, Shkup, 2012, fq. 13-106.
2. Mahmud Ebul-Fajd El-Menufi, Filozofija islama, Sarajevë, 1983, fq. 69.

shëm dhe më i thellë se më parë. Pa dyshim, shkenca e rrit pikëpamjen njerëzore ta njohë fuqinë e Allahut. Pyetjet e reja, të cilat njeriu mund t'i zbulojë, mund ta ndihmojnë besimin e tij në të vetmin Zot."

Studimi statistikor, i përgatitur nga shkencëtari gjerman Denirt, duke analizuar pikëpamjet e shkencëtarëve të njohur gjatë 400 viteve të fundit, konstaton që nga 290 të tillë 38 kanë qenë ateistë, 242 publikisht kanë pranuar fenë, 20 kanë qenë indiferentë ndaj fesë, që përkthyer në përqindje është se 92.5 % publikisht kanë pranuar fenë.[3] Kjo tregon se shumica dërrmuese e shkencëtarëve të suksesshëm nuk besojnë në kundërthëniet mes fesë dhe shkencës. Dhe mendojnë se feja dhe shkenca janë plotësuese dhe se plotësojnë njëra-tjetrën. Edhe kur ndodh që ndonjë teori kundërshtohet me ndonjë ajet kuranor apo me ndonjë hadith të saktë, atëherë e kemi të qartë se teoria e caktuar edhe nuk është përfundimtare.

Një numër i konsiderueshëm i shkencëtarëve bashkëkohorë nga fusha e mjekësisë, astronomisë, biologjisë, gjeografisë dhe shkencave të tjera eksperimentale e kanë ndërprerë luftën kundër fesë, madje ata janë vënë në shërbim të fesë duke konfirmuar pafuqinë e tyre për ta luftuar Zotin dhe çdo gjë lidhur me fenë.

ZOTI I GJITHËFUQISHËM DHE NJERIU I PAFUQISHËM

Disa intelektualë e pranojnë shkencën në vend të Zotit. Ata harrojnë se shkenca është prodhim njerëzor dhe pikarritja e saj është e kufizuar brenda njerëzores, në hapësirë dhe kohë. Për këtë arsye, nëpërmjet disa shembujve, do ta demonstrojmë pafuqinë e njeriut...

Shembulli i parë është **uji**, i cili përbëhet prej hidrogjenit dhe oksigjenit (H_2O), e për të cilin Allahu i madhërishëm thotë:

"Më thoni ju Mua: ujin të cilin po e pini, ju apo Ne nga qielli e zbresim?" (Vakia, 68-69)

Shtrohen disa pyetje bazë: kush e krijoi ujin? Kush e zbret atë nga qielli në tokë? A mundet shkenca të prodhojë ujë, shi apo diçka tjetër? Çdo përpjekje për të prodhuar shi në kohë thatësirash apo mungese uji do të dështojë, përkundër miliona dollarësh të shpenzuara. Përse retë kalojnë mbi shkretëtirë dhe nuk japin shi, kurse mbi tokën e blertë japin shi me bollëk? Normalisht, shkenca është eksperimentale dhe vepron brenda një laboratori. Ajo nuk është e gjithëfuqishme, por e kufizuar nga i Gjithëfuqishmi.

Shembulli i dytë është **qumështi**. Allahu i madhërishëm thotë:

"Ju keni shembull edhe te kafshët: Ne bëjmë që nga barku i tyre të pini qumësht të pastër, që bëhet nga përtypja në stomak dhe nga gjaku – të shijshëm për ata që e pinë." (Nahl, 66)

Nëse do të soditni, do të shihni se qumështi është çudia vijuese e Allahut. Fjala vjen, lopa nuk ushqehet me ushqim të veçantë kafshësh për prodhimin e tij, por me ushqim të zakonshëm. Përkundër analizave të shumta, identifikimit të përbërësve të ndryshëm, njeriu nuk ka arritur ta prodhojë qumështin - ajo që mund të bëjë njeriu më së shumti, është ta rrisë, stimulojë prodhimin, apo ta konservojë qumështin natyror.[4]

Këta dhe shembuj të tjerë dëshmojnë se njeriu përkundër përparimit tekniko-teknologjik është i paktë kundrejt gjithëfuqisë së Krijuesit, i Cili do të mbetet i tillë deri në Ditën e Gjykimit. Kjo për arsye se njeriu nuk e prodhoi ligjin e rëndesës, as fushën magnetike, as atmosferën. Nuk e prodhoi as elektricitetin, avullimin e ujit, nuk e nxori as vajin dhe derivatet e tij, nuk e krijoi oksigjenin në masën e duhur për të mbetur gjallë krijesat! Shkenca vetëm i identifikoi prodhimet dhe ligjet ekzistuese, u dha emërtime për nevojat e saj e të cilat Allahu i krijoi për të mirën e njeriut. Në këtë aspekt, njeriu edhe më tutje do të zbulojë gjëra e ligje të reja, ndërsa këto vetëm sa do ta forcojnë bindjen tonë se Allahu është krijues i paimagjinueshëm, i pashtershëm, i mahnitshëm. Ai thotë:

"Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) ***është e vërteta..."*** (Fussilet, 53).

PESË GJËRAT E PADUKSHME

Një ajet kuranor përmend pesë fenomene, pesë çudi, të cilat janë unikale dhe të cilat janë ekskluzivisht në dijen dhe madhështinë e Allahut. Në ajet thuhet:

"Pa dyshim, vetëm Allahu e di Orën e caktuar. Ai e zbret shiun dhe e di ç'ka në barkun e shtatzënës. Asnjë njeri nuk di ç'do të fitojë nesër dhe askush nuk di se në ç'vend do të vdesë. Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Njohës i çdo gjëje." (Lukman, 34)

Edhe pse shkenca në llogaritë e saj do të bëjë hulumtime për fillimin e botës, ajo nuk do të arrijë llogari të saktë e sidomos nuk do të dijë me saktësi fundin e saj. Dija për fundin e botës është në dijen absolute të Allahut dhe të askujt tjetër. Edhe shiu është një nga dukuritë që nuk kontrollohet nga shkenca. Lëvizja e reve është mbi dijen njerëzore, prandaj edhe kemi hapësira të mëdha gjeografike me thatësira tmerruese dhe hapësira të mëdha gjeografike, ku uji është me bollëk. Po të ishte në dorën (dijen) njerëzore, do të shmangej varfëria dhe do të shmangeshin vdekjet e shumta gjatë çdo viti në Afrikë, Azi, Amerikë latine etj. Ngjashëm

3. Maurice Bucaille, Bibla, Kur'ani dhe shkenca, Shkup, 2012.

4. Maurice Bucaille, po aty.

është edhe me mitrën e nënës. Përkundër zhvillimit të hovshëm të mjekësisë, ajo ende nuk di për vetë thelbin e mitrës, por për gjërat periferike. Fjala vjen, nëpër spitale të specializuara mund të mësohet për gjininë e embrionit pas formimit, kur analizohet materia e mitrës së nënës, nëpërmjet teknologjisë së ultra-zërit. Por shkenca nuk di për mitrën para dhe gjatë formimit të embrionit në mitër, sidomos nuk di për aspektin emocional dhe shpirtëror. As furnizimi i së nesërmes nuk mund të planifikohet, përkundër mjeteve të avancuara teknologjike. Po ashtu, njeriu nuk di as kohën as vendin e vdekjes. Aparaturat e shumta "inteligjente" nuk mund të parashikojnë afatin e jetës dhe vdekjes, as tek të pasurit as tek të varfrit, as në këtë vend, as në atë vend, as në këtë moshë as në çfarëdo moshe tjetër.[5]

A EKZISTON RASTËSIA?

Intelektualë të caktuar e perceptojnë fillimin e botës si rastësi, duke mohuar rolin krijues të Zotit. Edhe pse rasti është i paqëndrueshëm edhe në filozofi edhe në biologji, ai megjithatë përdoret nga rryma të caktuara filozofike ateiste.



Si reagim ndaj këtij perceptimi Kurani thotë:

"A mos vallë, ata janë krijuar pa Krijues apo mos janë ata krijues të vetvetes?" (Et-Tur, 35)

Ateistët besojnë se natyra e krijoi njeriun, duke ia dhënë edhe arsyen. Ky botëkuptim është ushqyer qysh me enciklopedistët francezë, për të kulmuar më vonë me Marksin, Engelsin, Leninin, dhe ateistët e tjerë në botë dhe te ne. Edhe në këto kohë kemi intelektualë të këtillë, që mohojnë Zotin dhe në vend të tij përmendin natyrën. Ata thonë se bota, ndërtesat dhe çdo gjë tjetër është krijuar rastësisht. Atë e krijoi nëna natyrë dhe ligjet e saj. Mirëpo, ideja e tyre është tejet absurde dhe i ngjan asaj përrallës kur një ditë ndodhi një termet. Nga një shtypshkronjë që ishte aty afër u shpërndanë shkronjat e shumta. Nga kjo rrëmujë e shkronjave, krejt rastësisht, u hartua një libër, me kuptim të caktuar, me kapituj, literaturë e pjesët e tjera të nevojshme për një libër. A mund të besohet një gjë e tillë? Normalisht që jo. Kësisoj, është edhe me krijimin e kozmosit apo njeriut rastësisht. Do të ishte jonormale të besohet në këto rastësi.[6]

PREJARDHJA E NJERIUT

Pyetja se **kush është njeriu?** na çon në hulumtimin dhe studimin e prejardhjes së tij. Kemi disa mendime dominuese, varësisht nga këndvështrimi ideologjik.

Jobesimtarët kanë mendime të ndryshme për prejardhjen e njeriut. Disa mendojnë se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit. Ata me këtë pohim tentojnë ta mohojnë Allahun, duke na thirrur në teori si ajo evolucioniste e Ç. Darvinit, H. Spenserit, K. Marksit etj. Ata me bindjet e tyre e degraduan njeriun nga rrafshi human në atë kafshëror, nga njeriu te kafshët.

Mirëpo, këtë teori e përgënjeshtruan besimtarët. Ata mendojnë se njeriu është i krijuar nga Allahu:

" I Cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar krijimin e njeriut prej baltës. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur." (Sexhde, 7-8)

Mbi të gjitha, Allahu e ngriti lart njeriun, duke e bërë krijesën më dinjitoze:

"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar." (Isra', 70)

Teorinë evolucioniste e refuzuan edhe vetë shkencëtarët. Kris Morison[7], në veprën e tij, duke diskutuar për këtë çështje, thotë: *"Teoria e cila pohon se prejardhja e njeriut vjen nga majmuni, është refuzuar nga shkenca moderne dhe hulumtimet antropologjike dhe arkeologjike që në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Këto dy krijesa janë plotësisht të ndryshme. Njeriu ka disa funksione, që nuk janë te majmuni. Për shembull, përsiatja dhe aftësia e komunikimit; jeta në fise dhe popuj dhe përkatësia e shoqërive dhe religjioneve. Njeriu, gjithashtu, ka edhe shumë aftësi: biologjike, demografike, antropologjike, psikologjike, etnologjike dhe morfologjike!"*

Shkencëtarët kanë gjetur mbetje dhe eshtra që u përkisnin fiseve dhe mbetje të shtazëve të tyre në ngrehinat nga guri, të hershme para një milion vitesh, por nuk kanë gjetur zinxhirin aq të përfolur që do të sillte deri te majmuni, të cilin e përfaqësojnë dhe propagandojnë Ç. Darvini dhe shumë evolucionistë të tjerë.

Edhe Dr. Wallace mohon prejardhjen e njeriut nëpërmjet evolucionit, duke thënë: *"Evolucioni është i pamundur. Njeriu është i krijuar në mënyrë të veçantë."*[8]

5. Shih analizën e 250 ajeteve kur'anore: Mustafa Mlivo, Kur'an ispred nauke i civilizacije, Bugojno, 2001-1422.

6. Nedim El-Xhisr, Kissat'ul-iman ose përkthimi boshnjak: Vjerovanje u Boga, Sarajevë, 1984, fq. 200-210; Maurice Bucaille, po aty, fq. 243-388.

7. Kris Morison, *Science Leads to Faith* (Shkenca shpie deri te feja).

8. Maurice Bucaille, po aty.

"ME DASHTË" THA ZOTI DHE U KRIJUA MUHAMEDI (A.S.)

Albri Brahusha

Me dashtë, tha Zoti e atëherë kupat e qiejve u trandën, engjëjt çuen krenat të habitun, yjet nisën me pulsue prej drojes si zemrat e zogjve që ende nuk janë krijue, ngjyrat humbën shkëlqimin, drita u mpak, errsina u drodh, gjithçkasë iu hoq tanësia, shkretinë në hapësinën e fjetun, përulje. E kur Zoti thotë fjalë të reja, ajo çka Ai ka krijue i përshtatet fjalëve, Vullnetit të Tij. Por fjala *me dashtë* nuk asht thjesht nji fjalë e re, asht nji fjalë që të merr shkëlqimin, asht nji fjalë pa përmasa, e hapësina e njeh mirë përmasën, ndaj ajo asht e përulshme tashma, prej fjalës *me dashtë*.

E kur Zoti flet, Ai nuk e ka tuj qeshë, me dashtë me qeshë Zoti qesh, por kur thotë diçka tjetër, ajo ndodh. E kur tha, me dashtë, kjo ndodhi si tana herët e tjera kur ai hidhte fjalë të reja në eter, veçse këtë herë fjala me dashtë krijoi atë që u quejt ma vonë drojë. Droja asht filli i dashnisë, sepse që me ndodhë dashnia duhet me u zbehë gjithçka tjetër, pikërisht se asht nji fjalë pa përmasë, nji fjalë që e përul hapsinën, por që i jep asaj pafundsinë.

Me dashtë dhe kështu pafundsia erdhi në hapësinë, Zoti e hodhi vullnetin e Tij jashtë, e kështu gjithçkaja e krijueme deri atëherë u ba njish me Zotin e Zoti u ba njish me të. Zoti e din se shtrimja e Tij në pafundsi ka shkaktu drojen e prandaj dhe e krijoi gjithçka, me dashtë asht me zgjanue pafund, me thellue pa fund, me kenë pa fund, por me u dashtë shkakton drojë që ushtron pushteti i atij që të don, me dashtë asht tepri, asht mangësi kufijsh, me dashtë asht pafundësia e drojes ndër damarët e kohës, e gjithë kohës, ngjethje asht me u dashtë, me dashtë asht me mbledhë, me dhanë, me përqendrue në nji gja të vetme shkëlqimin e të gjitha gjanave. Me dashtë, asht vullneti i Zotit që i dhurohet gjithsisë, vullneti i shpallun në veprim, asht përmbytja që pafundësia u ban kufijve, asht zhbamja e kufijve dhe krijimi i pakufishmërisë.


Tashti gjithçkaja po pret qëllimin e kësaj fjale, pasojën e ka pësue, drojen prej madhështisë së Atij që e krijoi, mpakjen prej shtrimjes në pafundësi, e përuljen për shkak të fuqisë, që e ban këtë të fundit me kenë. Por qëllimi i Zotit cili asht? Gjithçka ecte për bukuri edhe ma parë, si nji *perpetum mobile* atje mbrenda Krijuesit, pse u desht që këtë *perpetum* Zoti me e nxjerrë jashtë, me dashtë e me drashtë? Kërkush, as gjithsia nuk i din planet e Zotit pikërisht e sidomos tashti, çdo gja asht përqendrue në vetvedi e zbaton përpikshmërisht atë pjesë të vogël vullneti në pafundësinë e vullnetit të Zotit.

Gjithkush mujti me pa sa i vogël asht, para dhe në pafundsinë, tashma krenaria për peshën e gjithsecilit mundet me u aplikue vetëm me të afërmit. Kështu konfuzioni u kthye menjëherë në fuzion, me dashtë krijoi rregull, distancë të duhun e marrdhanie të drejta, pikërisht sepse me dashtë vendos natyrshëm harmoninë, e askujt nuk i duhet me ba përpjekje të kota me meritu ma shumë se i takon. Pafundësia që krijon fjala me dashtë kufizon mbrenda rregullit një liri të kotë, që në kaos nuk kishte kuptim, duke i dhanë asaj kuptimin dhe motivin e qenies. Me dashtë asht me realizue vullnetin e mbrendshëm tuj e projektue ndër e bashkë me faktorë të jashtëm, me dashtë asht me rrethue diçka me dashni për t'i dhurue kësaj përjetësinë, edhe kur kjo nuk e ka peshën me e mbajtë këtë përjetësi, me dashtë asht me drashtë tuj dhanë ndjesinë e lumtunisë.

Po askujt nuk i shkon mendja pse? As engjëjvë, as yjeve, trupave, as dritës, as eterit. Lumtunia që ndjejnë tashti ua ka heqë të drejtën me mendue, sepse lumtunia shkakton dehje, me u shtri në shtratin e pafundësisë don me thanë me kenë i lirë prej të kenunit i veçuem, e me u ushqye prej nji energjie që kushtëzohet vetëm prej qëllimit fillestar me të cilën çdo gja asht krjue.

Një qenie e papame kurrë ma parë, erdhi në më të errëtën e botëve. Erdhi Dritësjellësi, njeriu i Përbotshëm, Modeli i qenieve, Mëshira e të gjitha botëve, i Dërguari, i Dashuri, i Lavdëruari, Besniku, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin përjetësisht mbi të! Sepse me dashtë paska kenë diçka krejt e re, nji Qenie e Përsosun nji dritë e përqendrueme në nji hapësinë trupore të kufizueme fizikisht, diçka e krijueme me, në dhe për Dashninë e Allahut.

Sepse me mbajtë diçka pa dashni, asht e pamujtun, e atëherë Zoti e krijoi Dashninë si Muhamed (a.s.), ashtu si nji litar që lidh deven për të zotin e, po të mos ishte litari, as devja nuk do ishte krijue. Ky Njeri, Dashni dhe Mëshirë, asht nji namaz, asht nji lidhje mes Krijuesit të përhershëm dhe së krijuarës së përkohshme. Kështu, tuj terhek drejt vetes litarin, Krijuesi e merr deven afër. Deri kur të vijë dita, që litari dhe devja të hyjnë në Kopshtet e fshehta të Tij, ku nuk do të ketë më as etje e as uri.



Sjellja e mirë ndaj prindërve

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Allahu Teala ka urdhëruar të sillemi mirë ndaj prindërve. Nisur nga kjo:

Të gjithë duhet të sillen mirë ndaj prindërve dhe të jenë mirënjohës kundrejt tyre.

Nëse njëri prej tyre apo që të dy plaken pranë fëmijëve të vet, fëmijët nuk duhet t'u thonë as "of!"

Nuk duhet t'i qortojnë.

Duhet t'u thonë fjalë të buta dhe të mira.

Duhet t'ua hapin krahët me dhembshuri dhe të luten ashtu siç na mëson Allahu Teala në Kuranin Fisnik:

"O Zot! Mëshiroji ata siç më rritën duke u përkujdesur për mua kur isha i vogël!"

Allahu Teala njofton se dikur mori premtimin prej Beni Israilëve, se ata do të silleshin mirë ndaj prindërve.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nën dritën e këtyre ajeteve fisnike, ka bërë disa paralajmërime të rëndësishme në lidhje me çështjen e bindjes dhe mirësisë ndaj prindërve:

"Njëra prej gjërave që e gëzon shumë Allahun Teala, është mirësia dhe bindja e njeriut ndaj prindërve të tij."

"Një fëmijë nuk mund ta paguajë kurrë hakun e babait, përveçse në një rast: Nëse e gjen babanë e tij rob, e blen dhe e liron atë."

Haku i nënës

Nënat i mbartin fëmijët në barqet e tyre duke hequr vuajtje të mëdha dhe i sjellin në këtë botë me shumë vështirësi. Haku i nënës është i pamundur të paguhet, ngaqë rritja dhe edukimi i fëmijës nuk është më pak i vështirë se mbartja e tij në bark.

Një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe e pyeti:

-Ndaj kujt duhet të sillem më mirë dhe t'i shërbej më shumë?

-Nënës tënde!

-Po pas saj, ndaj kujt?

-Nënës tënde!

-Po pas saj?

-Përsëri ndaj nënës tënde?

-Po pas nënës sime?

-Babait tënd!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka treguar se haku i nënës është aq i madh, saqë nuk mund të matet me asnjë tjetër.

Edhe nëse nëna nuk është myslimane, fëmijët e kanë për detyrë ta respektojnë dhe të sillen mirë ndaj saj.

Nëna e vajzës së Ebu Bekrit, pra nëna e Esmasë, akoma nuk e kishte pranuar Islamin.

Gruaja e shkretë shkoi një ditë për të vizituar vajzën e saj. Esmaja, radijallahu anha, nuk po dinte çfarë të bënte. Nëna e saj ishte adhuruese e idhujve. Vallë, a ishte e drejtë ta merrte brenda atë?

Shkoi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe e pyeti:

"Nënën e kishte marrë malli për mua dhe ka ardhur te shtëpia ime. A mund ta nderoj atë?" I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

"Po! Sillu mirë ndaj nënës tënde!"

Sahabi i nderuar, Harithe bin Nu'mani sillej shumë mirë ndaj nënës së tij. Një ditë i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, pa një ëndërr. Ndodhej në xhenet dhe Harithe ishte aty duke lexuar Kuran.

Pasi ua tregoi sahabëve të nderuar ëndrrën, u shpreh: *"Ja, kjo është mirësia."* Pastaj tha se Harithe, radijallahu anhu, e ka fituar xhenetin, për shkak se është sjellë mirë ndaj nënës.

GJYSMA E NËNËS

Një burrë i tha të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem:

-O i Dërguari i Allahut! Kam bërë një mëkat të madh. A më pranohet pendimi, nëse pendohem?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

-A i ke prindërit?

-Jo, nuk i kam.

-A ke teze?

-Po, kam.

-Atëherë, sillu mirë ndaj saj!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha se njeriu mund të shpëtojë nga mëkati duke u sjellë mirë ndaj tezes, e cila është "gjysma e nënës", nëse nuk i ka prindërit.

DUHET T'I GËZOJË ATA

Prindërit janë garancia e xhenetit për fëmijët dhe shkak që ata të hyjnë në xhenet nga dera kryesore.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë tri herë: "U shkatërroftë!", për atë pranë të cilit prindërit arrijnë ditët e pleqërisë dhe ai nuk mund të hyjë në xhenet. Po ashtu, është shprehur se fëmijët që nuk i gëzojnë prindërit në periudhën e fundit të jetës së tyre, janë në një humbje të madhe.

Një sahab erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe i kërkoi leje për xhihad. Hazreti Pejgamberi (a.s.), e pyeti:

-A i ke gjallë prindërit?

-Po, që të dy janë gjallë.

-Atëherë shko dhe përpiqu t'u shërbesh atyre!

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tregoi se shërbimi ndaj prindërve është më i vlefshëm se xhihadi nafile.

Dikush tjetër i tha të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, se kishte ardhur të luftonte bashkë me Të apo të shpërngulej te Ai duke i lënë prindërit me lot në sy. Pejgamberi, alejhi's-selam, i tha:

"Menjëherë kthehu pranë prindërve dhe gëzoji, siç i ke bërë të qajnë!"

Të gjitha këto ngjarje tregojnë këtë:

Ai që i gëzon prindërit, fiton kënaqësinë e Allahut Teala. Ndërsa ai që i zemëron prindërit, tërheq zemërimin e Allahut të Madhëruar.

PRINDËRIT NUK DUHET TË KUNDËRSHTOHEN

Kundërshtimi i prindërve është një mëkat shumë i madh.

Kur i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, foli rreth mëkateve më të mëdha, së pari përmendi kundërshtimin ndaj Allahut të Madhëruar dhe pastaj kundërshtimin ndaj prindërve.

Po, mëkati më i madh prej mëkateve të mëdha është adhurimi i diçkaje tjetër për zot, përveç Allahut dhe mosrespektimi i prindërve.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha se ofendimi dhe mallkimi i prindërve prej fëmijëve të tyre janë prej mëkateve të mëdha.

Sahabët u habitën nga kjo dhe i thanë:

-Si mund t'i ofendojë dikush prindërit e tij?

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u përgjigj:

"Vjen dhe ofendon babain e dikujt tjetër. Edhe ai ia ofendon babanë. Ofendon nënën e dikujt. Edhe ai ia ofendon nënën e atij." Në këtë mënyrë, ka ofenduar prindërit e tij.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve selem, e përdorte shumë pak mallkimin, por megjithëkëtë, tha:

"Allahu e mallkoftë atë që mallkon prindërit e tij."

Hazreti Pejgamberi, alejhi's-selam, na ka mësuar:

Allahu i Madhëruar e ka ndaluar kategorikisht mosbindjen ndaj prindërve.

Ja pra, për këtë arsye nuk mund të hyjnë në xhenet ata që i kundërshtojnë prindërit e tyre.

PAS VDEKJES SË PRINDËRVE

Detyrat e fëmijëve kundrejt prindërve të tyre nuk mbarojnë edhe pas vdekjes. Kanë detyra të tjera edhe pasi ata t'i japin lamtumirën jetës së kësaj bote.

Një sahab e pyeti të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, për këtë:

-A ka ndonjë mirësi që mund ta bëj për prindërit pasi ata të ndërrojnë jetë?

Hazreti Pejgamberi, alejhi's-selam, iu përgjigj:

-Po, duhet të lutesh për ta dhe të kërkosh (nga Allahu) që t'ua falë mëkatet e tyre,

Të zbatosh porositë e tyre,

Të mbrosh të afërmit e tyre dhe

Të nderosh miqtë e tyre.

Fëmijët duhet të sillen mirë ndaj mikut të babait, madje edhe ndaj familjes së tij. Duhet t'i mbrojnë dhe t'i ndihmojnë ata.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e ka cilësuar këtë si mirësinë më të vlefshme.

SI DUHET TË LUTEMI PËR PRINDËRIT?

Kurani Fisnik na mëson se si duhet të lutet një fëmijë për prindërit e tij:

"O Zot! Mëshiroji ata siç më rritën duke u përkujdesur për mua kur isha i vogël!"

"O Zot! Më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët ditën kur do të jepet llogari!"

Fëmija duhet të japë sadaka për prindërit e tij pasi ata të ndërrojnë jetë. Sevapet e mirësive që bëhen për ta, do t'u shkojnë shpirtrave të tyre.

Ai "Trëndafil"

Dr. Mehmet Gynesh

Ai *Trëndafil* ishte pranvera mëshiruese e tetëmbëdhjetë mijë botëve, që i predikoi të gjithë njerëzisë hytben e fundit hyjnore, që biri i Ademit të arrinte përsëri atmosferën e udhëzimit...

Ai *Trëndafil* ishte burimi i krenarisë së gjithësisë, që përgëzoi me mbrojtje, në kuptimin e plotë të saj, njerëzinë që kishte humbur njerëzillëkun dhe cilësitë e saj prej njeriu... Atij *Trëndafili* nuk i qe dhënë një detyrë e caktuar për një popull të veçantë, për një kohë të veçantë dhe për një krahinë të veçantë. Ai ishte një thirrje universale për të gjithë njerëzinë, për të gjitha kohët që do të vijnë deri në kiamet dhe për të gjithë gjeografinë e botës...

Ai *Trëndafil* ishte arkitekt shpërndarës trëndafilash të një sevdaje të dashuruar me *Tulipanin* e stolisur me dashuri hyjnore që zemrën e kishte trëndafil, jetën e kishte trëndafil, veten e kishte trëndafil, fjalën e kishte trëndafil, gjendjen e kishte prej trëndafili, bukurinë e kishte prej trëndafili, trupin si trëndafil dhe djersën që i lëshonte aromë trëndafili...

Ai *Trëndafil* ishte vendi i parë në të cilin u shfaq drita e Allahut të Madhëruar, ishte vendi i fundit ku u vendos trupëzimi i profetësisë me ajetin, ishte rruga e shpëtimit të përhershëm për njerëzimin, mëngjesi me fytyrë të buzëqeshur i atmosferës së dashurisë ndaj Allahut Teala dhe rënkimi i të dashuruarve, që thonë "Allah, Hu" në kohët e seherit (paraagimit)... Të fshehtat e Shenjtërisë dolën në pah me çeljen e atij *Trëndafili*, njerëzimi u zgjua me Të në muzgun e mëngjeseve të përgëzuara dhe me dorën e tij gjithësia u ngjyros me "sibgatullah-Ngjyrën e Allahut" për herë të fundit dhe në mënyrën më madhështore...

Ai *Trëndafil* ishte i pashoq në moral, në edukatë, në personalitet dhe në karakter...


Ai *Trëndafil* nuk kishte të ngjashëm në përkujtim, në meditim, në mbështetje ndaj Allahut Teala dhe në kryerjen e shkaqeve... Ai *Trëndafil* ishte i pashoq në predikimin, mësimin dhe përfaqësimin e fesë... Ai *Trëndafil* gjithmonë i takonte të tjerët me dashuri, me mendim të mirë për ta, u jepte sihariq, u jepte shpresë dhe u shfaqte dhembshuri...



Ai *Trëndafil* ishte emri më i detajuar dhe më i përsosur i devotshmërisë, turpit, besnikërisë, virtytit, mirësjelljes, mëshirës, sinqeritetit dhe burrërisë... Ai *Trëndafil* ishte në shkallën më të lartë në ibadet, falënderim, durim, pendim, lutje dhe në të gjitha fazat e adhurimit ndaj Allahut Teala... Ai *Trëndafil* ishte shembulli i përkryer i të gjitha bukurive mbi sipërfaqen e tokës dhe me këto bukuri, zotëronte veçori të pafundme, që e tejkalonin çdo lloj përkufizimi, përshkrimi dhe imazhi...

Ai *Trëndafil* ishte më lart se të lartët me besimin, sinqeritetin, durimin, butësinë, mendjemprehtësinë, trimërinë, bujarinë, drejtësinë, modestinë, dashurinë, të folurit, të qëndruarit e të ngriturit, domethënë, me moralin e bukur të tij që përfshinte çdo sjellje, me administrimin familjar, shoqëror, ekonomik, administrativ e ushtarak dhe me vizionin e tij individual e profetik.

Ai *Trëndafil* ishte myslimani më i mirë, njeriu më i përsosur, robi më adhurues, besimtari më bujar, njeriu më modest, personaliteti më i sigurt, miku më i dëlirë, i dashuri më besnik, bashkëshorti më i dashur, shoku më i mirë, kryetari më i butë i familjes, babai më i mirë, gjyshi më mirëdashës, komandanti më guximtar, diplomati më i aftë, burri më i drejtë i shtetit, udhëzuesi më i saktë dhe profeti më i madh...



Ai *Trëndafil* cilësohej nga poeti si "më i bukuri i të bukurve"... Ai *Trëndafil* ishte mirësia më e madhe, ndihma më madhështore dhe mëshira më e gjerë e Allahut Teala për njerëzimin... Ai ishte *Trëndafili* në emrin e të cilit u betua Zoti... Ai *Trëndafil* ishte zotëruesi i privilegjit "Leamruke'l-muejjed"...

Me atë *Trëndafil*, njerëzimi u lartësua përsëri në shkallën e duhur, duke vendosur kurorën e Islamit... Ai *Trëndafil* na mësoi ekzistencën, njësimin, fuqinë dhe madhështinë e Allahut Teala në kuptimin e vërtetë të tyre...

Ai *Trëndafil* na tregoi për fshehtësitë e krijimit, për nderin e adhurimit, për privilegjin e të qenit mysliman, për fitimin e Ahiretit dhe për sihariqin e shpëtimit të përhershëm... Me lutjen e atij *Trëndafili* pati rënë mbi tokë shumë shi mëshire... Të gjitha farërat që patën ngelur në dimër, hodhën shtat me dashurinë e *Trëndafilit* dhe gjelbëruan në atmosferën e mëshirës së Tij...

Ai *Trëndafil* erdhi në këtë gjithësi me dashuri dhe i bëri zemrat të dashurojnë, për t'i shndërruar në pranvera të xhenetit dynjanë dhe ahiretin e të gjithë njerëzisë, për t'i shndërruar pranverat në natyrën e tyre të vërtetë me *trëndafilin e pavyshkur të gjithësisë* dhe për t'u dhënë erë *Trëndafili* "trëndafilave të salavateve të pranverës"...

Ai *Trëndafil* i solli shkretëtirat e mallëngjyera, gjuhët e thara, duart e shtrembëra, robërit mizorë dhe rrugët që të shpinin në detin e mëkateve, në një gjendje të atillë sa shkretëtirat u bënë bahçe trëndafilash, gjuhët u bënë epope që përkujtonin Zotin, duart u bënë shërbëtore të sevapit, robërit u bënë mysafirë të dashurisë dhe rrugët u bënë vende të pandryshueshme mirësie dhe begatie...

Ata që i morën erë atij *Trëndafili*, u nderuan me besim.

Tepritë u takuan me kufjtë e tyre. Ata që u ishin nënshtruar urdhrave të egos, ata që ishin dhënë pas lakmisë së kësaj bote dhe ata që lundronin në dallgën e padrejtësisë e të imoralitetit, notuan drejt bregut të qetësisë shpirtërore dhe errësira e injorancës u takua me një agim të trëndafiltë... Dhe bota, në një kohë shumë të shkurtër, i hapi krahët kësaj shoqërie të civilizuar... Sepse me atë *Trëndafil*, ekzistencës i erdhi krenaria, njerëzisë nderi, Islamit mirësia, kohës lumturia, dynjasë begatia dhe botëve mëshira...

Me atë *Trëndafil* u buzëqeshi fytyra vajzave të pafajshme, që varroseshin të gjalla në tokë, u buzëqeshi fytyra skllevërve të ngratë që trajtoheshin si kafshët, u buzëqeshi fytyra jetimëve ndaj të cilëve nuk shfaqej dhembshuri, u buzëqeshi fytyra të vetmuarve që nuk mëshirohesin, u buzëqeshi fytyra atyre që e kishin zemrën të thyer, u buzëqeshi fytyra varfanjakëve, u buzëqeshi fytyra nënave të përvëluara në shpirt, u buzëqeshi fytyra baballarëve me zemrën si prej guri...

Ai *Trëndafil* i ktheu zemrat e mbushura me urrejtje në bahçe dashurie, dhembshurie, butësie, dhe mirësjelljeje në atmosferën e udhëzimit dhe vëllazërisë. Të gjitha sjelljet negative i shndërroi në virtyte të larta...

Ai *Trëndafil* i kishte dhënë më shumë përparësi jetës së të tjerëve se jetës së tij, gëzimit të të tjerëve para gëzimit të tij, ngrënies së të tjerëve para se të hante vetë, veshjes së të tjerëve para se të vishej vetë dhe ahiretit para dynjasë... Ai asnjëherë nuk i mbajti vetë paratë, pasurinë dhe plaçkat e luftës, por menjëherë ua shpërndante nevojtarëve. Ai bëri një jetë të thjeshtë, të dëlirë dhe modeste...

Ai *Trëndafil*, na ka treguar recetën e vërtetë të shpëtimit, ka theksuar se duhet të bëjmë një jetë me në qendër ahiretin, pa e lënë pas dore dynjanë, ka vendosur në mënyrën më të përsosur ekuilibrin dynja-ahiret dhe ka përkufizuar një rend jete me bosht ahiretin me dimensione të kësaj bote, duke thënë:

"Punoni për këtë botë sikur nuk do të vdisni asnjëherë dhe punoni për ahiretin sikur do të vdisni nesër."

Ai *Trëndafil* ua mësoi të gjithë besimtarëve se gjëja më e bukur që mund t'i shfaqim Zotit ditën e Tubimit, është një **"zemër pa shirk dhe një vepër e mirë"**...

Ai *Trëndafil* ishte krijesa më e mirë, miraxhi i njerëzisë, i dashuri i Zotit, që Allahu Teala nuk e thirri me emrin e tij si pejgamberët e tjerë në Kuran, por me shprehje lartësuese si "O Resul, o Nebi, o Muddeththir, o Muzzemmil", ishte simboli i dashurisë muhamedane, që arriti gradat përtej horizontit në horizontin e dashurisë ndaj Allahut... Ai *Trëndafil* ishte Profeti i mëshirës dhe dashurisë që na e la trashëgimi dashurinë për krijesën për hir të Krijuesit... Në lidhje me këtë çështje, e bëri besimin gurin themelor të paqes së shoqërisë, duke thënë:

"Nuk do të hyni në xhenet, derisa të besoni dhe nuk do të besoni në kuptimin e vërtetë të fjalës, derisa nuk do ta doni njëri-tjetrin."



Ai *Trëndafil* me një intuitë muhamedane, i hapi edhe kyçet e pahapura të zemrave më të ndryshkura... Ai *Trëndafil*, me petalet e tij, e zhduku një herë e përgjithmonë dhunën dhe padrejtësinë, me një shikim të tij shkriu malet prej akulli dhe me sjelljet e tij çliroi zemrat, agresivët u bënë të butë përballë tij dhe ata që erdhën për ta vrarë, u ringjallën te ai... Ai *Trëndafil* i udhëzoi ata që patën devijuar dhe **"i ktheu kusarët në udhëzues të udhëtarëve"**...

Ai *Trëndafil* ishte i lidhur me Allahun Teala me një besim shumë të fortë, iu dorëzua plotësisht Atij, gjithmonë veproi me një ndjenjë të përsosur përgjegjshmërie dhe asnjëherë nuk u shmang nga besimi dhe kauza e tij...

Ai *Trëndafil* ishte një monument besimi dhe veprimi, që nuk u lëkund kurrë as në kushtet më të vështira, nuk ra në pesimizëm, nuk nxitoi, nuk hezitoi dhe nuk i la të tjerët të hezitonin, nuk e ndërroi kurrë sjelljen e tij burrërore, qëndroi i fortë në këmbë dhe asnjëherë nuk u përul... Ai, krahas trimërisë, nuk e nënvlerësoi kurrë marrjen e masave dhe vetëpërmbajtjen...

Aliu (r.a.), e tregon kështu trimërinë e atij *Trëndafili*:

"Kur lufta arrinte kulmin dhe kur sytë skuqeshin prej zemërimit, ne fshiheshim pas Tij." Ndërsa Bera b. Azib (r.a.), në lidhje me këtë, përdori këtë shprehje:

"Edhe më trimi prej nesh, nuk e arrinte dot gradën e trimërisë së Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem."

Kur u shfaq paniku në luftën e Hunejnit dhe kur ushtria filloi të prapësohej, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ishte i vetmi që luftoi trimërisht kundër armikut që sulmonte dallgë-dallgë myslimanët dhe që nuk u prapësua përballë gjithë atyre ushtarëve politeistë, sepse ai *Trëndafil* kishte një vullnet të madh, një vendosmëri të hekurt dhe një trimëri të pashoqe...

Ai *Trëndafil* ishte një bedër që vrau me kamë në zemër mohimin e fesë dhe një diell i së vërtetës që ndezi pishtarin e besimit të fortë nëpër zemra... Ai *Trëndafil* ishte fryma e "të vdekurve të gjallë" në errësirën e injorancës dhe e "ringjalljes pas vdekjes" për xhenazet e gjalla që kanë humbur njerëzillëkun sa më shumë që të largohen nga Ai (a.s.), në çdo kohë... Ai *Trëndafil* vendosi bukuri ndriçuese në zemrat si gërmadha, e bëri të qartë drejtimin e vërtetë të dashurisë dhe umetin e tij e bëri fatlum me dashurinë ndaj Allahut Teala...

Ne, në sajë të atij *Trëndafili* shpëtuam nga rënia në esfeli safilin dhe nga shkatërrimi i përhershëm, duke dalë nga errësira katran e mohimit... Ne u nderuam me eliksirin qiellor që Ai ua dha shpirtrave tanë, me mesazhin muhamedan që ua paraqiti mendjeve dhe me sihariqin e lumturisë së përhershme që ua fali zemrave tona...

Ai *Trëndafil* ishte zotëruesi i "gjurmëve" që të çonin nga shkretëtirat e dashurisë për te Zoti dhe udhëzuesi i fundit i padevijueshëm i rrugës së Zotit... Për këtë arsye, edhe nëse mexhnunët që zbritën nëpër shkretëtira për shkak të dashurisë që ndjenin për robin, thonin "Lejla", zemrat që iu drejtuan Zotit (xh.xh.), me dashurinë e *Trëndafil* gjithmonë thanë, thonë dhe do të thonë "Allah, Allah..."

Salatet dhe selamet qofshin mbi *Trëndafilin* e pavyshkur të gjithësisë, deri kur trëndafilat të çelin petale...



Mund të fle edhe në stuhi

A. Jasin Demirxhi

Allahu Teala në Kuranin Fisnik thotë: ***"Begatitë, që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t'i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."*** (Fatir, 2.)

La Tahzen / Mos u mërzit

Në këtë botë nuk mund të gjesh asnjeri që nuk ka halle apo vështirësi, qofshin ato pak apo shumë. Atëherë, ngushtimin që lind në zemrën tënde për shkak të vështirësive dhe vuajtjeve me të cilat po përballesh, zgjeroje me vepra të mira, në mënyrë që zemra të gjejë qetësi.

La Tahzen / Mos u mërzit

"Kije kujdes zemrën! Gjithmonë mbroje gjendjen e dhikrit dhe qetësisë shpirtërore! Kur të përparosh në këtë rrugë, vendos t'i dalësh për zot zemrës deri në një kufi të caktuar, vendos se nuk do ta humbësh afrimitetin me Allahun (xh. sh.) dhe se nuk do të biesh në neglizhencë! Nëse vepron kështu, do ta arrish qëllimin dhe do ta plotësosh dëshirën tënde."

Para disa vitesh, një bujk kishte blerë një fermë në një kodër ku frynte shumë erë. Pasi u vendos aty, puna e parë që bëri ishte gjetja e një ndihmësi. Por as në fshatrat e afërta dhe as në ata të largëta askush nuk donte të punonte në fermën e tij. Të gjithë ata që kërkonin punë, hiqnin dorë sapo shihnin vendin e punës dhe thonin: "Këtë vend e rrahin shumë stuhitë. Do të ishte mirë që edhe ju të hiqnit dorë nga kjo fermë."

Së fundi, punën e pranoi një burrë i dobët, që e kishte kaluar moshën e mesme. Pronari i fermës e pa gjendjen e burrit dhe nuk duroi dot pa e pyetur:

"A di të punosh në fermë?" Burri i tha: "Diçka mendoj se di. Them se mund të fle edhe kur të fillojë stuhia."

Pronari i fermës mendoi pak për këtë fjalë pa lidhje, por pastaj nuk i dha shumë rëndësi dhe e mori burrin në punë. Pasi kaluan disa javë dhe vuri re se burri i administronte mirë punët e fermës, u qetësua.

Derisa filloi stuhia.

Në mes të natës, u zgjua prej zhurmës së frikshme të stuhisë. Ajo ishte aq e tërbuar, sa edhe ndërtesa dukej se po shkulej nga vendi. Menjëherë u ngrit nga shtrati dhe shkoi në dhomën e punëtorit: "Çohu, çohu! Ka filluar stuhia. Le të bëjmë çdo gjë që duhet para se era t'i marrë të gjitha!"

Burri pa u ngritur fare nga shtrati përshpëriti:

"Mos u brengosni, zotëri! Shkoni dhe flini! Unë ju pata thënë kur më morët në punë se mund të fle edhe kur të fillojë stuhia."

Bujku desh u hutua nga nënvlerësimi i punëtorit. Puna e parë që do të bënte të nesërmen, ishte përzënia e tij, por tani duhej të gjente një zgjidhje për stuhinë. Doli jashtë dhe shkoi te mullarët e kashtës. Sa çudi! Mullarët e kashtës ishin vënë bashkë, ishin mbuluar me mushama dhe ishin lidhur fort. Shkoi në ahur. Të gjitha lopët ishin futur brenda dhe dera ishte mbyllur mirë. Pastaj u drejtua nga shtëpia. Qepenat e shtëpisë ishin të mbyllura.

Bujku u kthye i qetë në dhomën e tij dhe u shtri në shtrat. Stuhia vazhdonte të fishkëllente. Buzëqeshi dhe, kur po mbyllte sytë, përshpëriti:

"Mund të fle edhe kur të fillojë stuhia."

Si përfundim, nëse

- logjikisht (keni dije dhe plane),

- shpirtërisht (lutje),

- materialisht (merrni masa) kundrejt vështirësive,

mund të flini rehat edhe kur të fillojë stuhia. Madje gjatë gjithë jetës.

I'TISAMI

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz



Dekreti hyjnor: ***"Vërtet, prej Allahut vijmë dhe tek Ai është kthimi ynë"*** (Bekare,156) thekson qartë shkakun e ekzistencës së njeriut në tokë, i cili është drejtimi dhe kthimi nga Allahu. Kthimi tek Allahu është dydimensional. Njëri dimension është vullnetar, i cili shpreh dorëzimin e zemrës tek Allahu dhe bindjen e plotë ndaj urdhrave dhe ndalesave të Tij. Kurse dimensioni tjetër është i detyrueshëm. Ai shpreh mbarimin e kësaj jete dhe kthimin përfundimtar tek Allahu. Ky proces në Kuran dhe Hadith shprehet me termin "I'itisam." Kjo fjalë në fjalor ka kuptime të tilla si: zgjat dorën dhe rrok diçka a dikë për t'u mbajtur ose për t'u mbështetur, mbrojtje, strehim etj. Kjo fjalë vjen nga rrënja "Ismet", që ka kuptimin "i mbrojtur nga mëkatet". Kurse në terminologjinë fetare "Ismet" shpreh kapjen fort pas urdhrave dhe distancimin total prej ndalesave për të mos rënë në mëkate. "I'itisami" shpreh jetën kushtuar Krijuesit, pa neglizhuar asnjë porosi të Tij.

"I'itisami" përmban dy përmasa. Njëra përmasë shpreh mbështetjen fort dhe me gjithë zemër tek Allahu në raste vështirësie dhe dobësie. Kurse tjetra është kapja fort mbas një metode të zgjedhur midis shumë alternativash të tjera gjatë rrugëtimit të jetës dhe zbatimi me sukses i asaj metode me të gjitha kushtet që kërkon. Në të parën ka zgjedhje dhe vullnet të lirë. Në të dytën kërkohet luftë me egon dhe faktorë të tjerë që pengojnë zbatimin e metodës.

Kapja pas mësimeve të Allahut i ngjason përmasës së dytë të I'itisamit. Siç theksohet në Kuran: "***Luftoni për hir të Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait***

tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh më parë (në Shkrimet e Shenjta) ***dhe në këtë*** (Kuran)***, me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë. Andaj, faleni namazin, jepni zeqatin dhe mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrojtësi juaj. Sa Mbrojtës dhe Ndihmës i mrekullueshëm është Ai!*** (Haxh,78)

Allahu në ajetin e mësipërm në vend të shprehjes "luftoni në rrugën e Allahut" ka përdorur shprehjen **"për hir të Allahut."**. Shprehja **"për hir të Allahut"** jep përpjekjen për forcimin e jetës fetare përballë rezistencës së egos. Këtë e përforcon edhe urdhri për faljen e Namazit dhe dhënien e Zekatit në fund të ajetit. Kurse Ragip el-Isfahani në fjalorin e tij të famshëm xhihadin, e përkufizon si përdorim i të gjitha mundësive kundër armikut. Xhihadi është tre llojesh: xhihadi i jashtëm, xhihadi kundër shejtanit dhe xhihadi kundër egos.

Në Kuran fjala "I'itisam"(kapje) herë është përdorur bashkëngjitur me fjalën "habël", e cila vjen në kuptimin Kuran dhe herë vjen e bashkëngjitur direkt me fjalën Allah, siç është në ajetin e mësipërm, i cili shpreh krijimin e lidhjeve të forta miqësore me krijuesin e gjithësisë.

Në ditët tona, ku jeta është bërë krejtësisht sekulariste dhe mondane, njeriu gjithnjë e më shumë po vetmohet dhe alienizohet. Çdo punë dhe veprim i tij është i lidhur ngushtë me përfitime të kësaj bote, duke e përjashtuar krejtësisht rolin e fesë në jetën e njeriut. Mirëpo ky mentalitet po e bën njeriun skllav të egos dhe pasurisë materiale. Jeta e dynjasë përmes bukurive dhe pasurive të saj të përkohshme po e përshpejton më shumë procesin e largimit nga vlerat hyjnore dhe morali i bukur. Besimi tek Allahu, kërkimi i ndihmës, mbështetjes dhe suksesit nga Allahu, është një I'itisam i fuqishëm, sepse kjo shpreh një kthim drejt Allahut duke e pastruar zemrën nga çdo ndotje dhe papastërti. Përmes kapjes fort mbas Allahut, besimtari arrin të thotë me gojë dhe me zemër: ***"Ai (Allahu) më mjafton, sa mbrojtës i mirë është Ai"*** përballë rasteve më të vështira dhe tundimeve më të forta.

Lirinë e vërtetë dhe çlirimin e plotë prej robërisë dhe skllavërisë së të tjerëve, njeriu e arrin vetëm duke adhuruar Allahun, ashtu siç urdhërohet në suren Fatiha:***"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë."*** Besimtari i beson, i kërkon ndihmë dhe mbështetje vetëm Allahut të përhershëm dhe të përjetshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mbështetet në krijesat dhe sendet e përkohshme. T'i shprehësh dëshirat, shqetësimet ankesat vetëm Allahut dhe të merakosesh vetëm për t'u bërë një rob i pranuar dhe me vlerë tek Allahu, është niveli më i lartë i I'itisamit.

Kapja fort pas Kuranit dhe Traditës Profetike e mbron njeriun, duke i ndriçuar rrugën e jetës nga humbja, devijimet, gabimet dhe mëkatet. Suksesi është i lidhur ngushtë me intensitetin e forcës së kapjes pas Kuranit dhe Hadithit. Kapja duhet të jetë e fortë, jo me majën e gishtave. Me majën e gishtave preket, por nuk mund të kapet asgjë. Ai që i mban punët me majën e gishtave, është gjithmonë në rrezik; në çdo moment mund të rrëzohet. Prandaj, kapja mbas Kuranit dhe Sunetit duhet të jetë e fuqishme, që mos të të shpëtojë.

Kapja fort pas Kuranit dhe Traditës Profetike i shërben besimtarit si hartë në rrugën e jetës. Kapja pas Krijuesit është një qëllim sublim dhe një ndjenjë madhështore, kurse kapja pas Kuranit dhe Traditës Profetike është si recetë që siguron pastërtinë dhe dëlirësinë e kësaj ndjenje. Prandaj, Allahu në Kuran urdhëron: "***Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut*** (Kuranin) ***dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë."*** (Al 'Imran,103)

Ajeti jep mesazhe të rëndësishme për kapjen pas Kuranit dhe Sunetit, për arritjen e bashkimit dhe solidaritetit dhe sigurimin e rrugullit dhe harmonisë sociale. Kapja pas Kuranit dhe jeta sipas porosive të Tij, sjell bashkimin e zemrave, dashurinë dhe suksesin social. Sepse Kurani i këshillon njerëzit të duan njëri-tjetrin, të sakrifikojnë për njëri-tjetrin dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Edhe Pejgamberi (a.s.), na informon se përsosmëria e besimit arrihet përmes ushqimit të dashurisë për njëri-tjetrin.

Kapja pas Krijuesit dhe kapja pas Kuranit dallon vetëm për nga niveli. Kapja pas Allahut shpreh dorëzimin e plotë dhe sigurinë totale tek Ai, kurse kapja pas Kuranit shpreh mënyrën e jetës sipas Kuranit dhe Sunetit, rregullimin e çdo veprimi dhe sjelljeje sipas urdhrit të Allahut.

Një dritare në zemër

Rabia Christine Brodbeck

Për ata që kërkojnë Allahun, shpallja hyjnore, Kurani Kerim, është burimi kryesor dhe më i vlefshmi. E vërteta kuranore është gjëja e vetme që duhet të synojnë njerëzit. Kuptimi i natyrës së shpalljes së Allahut, është detyra e njeriut. Të arrish të kuptosh të vërtetat e Kuranit Kerim, do të thotë të njohësh Allahun dhe të familjarizohesh me Të. Për këtë arsye, njerëzimi është përballë një çështjeje të përjetshme: Si duhet ta kuptojë Kuranin? Si duhet t'i kuptojë shpalljet hyjnore? Çështja kryesore është: A mund ta arrijmë Allahun me anë të Kuranit?


Mevlana i nderuar, në lidhje me këtë çështje shprehet: *"Ka disa njerëz që i afrohen Allahut me Kuran. Disa të tjerë që janë edhe më të zgjedhur, vijnë prej Allahut duke e gjetur këtu Kuranin dhe e kuptojnë që atë e ka dërguar Allahu."* Nga kjo kuptojmë se Mevlana bën fjalë për një të vërtetë shumë të madhe. Ai thotë se besimtarët në adhurimin e Allahut, pikësëpari duhet të plotësojnë një kusht hyjnor. Dhe ai kusht, është hapja e dritares, e shumë dritareve të reja perceptimi dhe ndjesimi: *"Namazi është lidhja ime me Zotin tim. Namazi është drita e syve të mi. Aty shfaqet e fshehta. Dritarja e shpirtit tim është e hapur me dëshirë dhe mirësia e Allahut vjen aty pa ndërmjetës. Mirësia, mëshira dhe drita e Allahut hyn prej asaj dritareje drejt e në shtëpinë time. Shtëpia pa dritare, është xhehnem. O njeri, feja e vërtetë është hapja e kësaj dritareje."* (vol I., bejtet 2401-05.)

Mendimin e mësipërm mund ta shpjegojmë në këtë mënyrë: Për t'u afruar drejt Kuranit, besimtarët duhet të hapin një dritare në zemrat e tyre dhe prej aty të lexojnë shpalljen hyjnore. Kur lexojmë librin tonë të shenjtë, Kuranin, ndjekim rreshtat dhe shfletojmë, nuk do të thotë se po e ndjekim shpalljen dhe i kemi kuptuar të vërtetat e Kuranit. Më parë, duhet të zotërojmë një zemër, e cila është e hapur ndaj shpalljes hyjnore. Kjo do të thotë që t'i mbyllim sytë ndaj kësaj bote dhe t'i hapim

ndaj botës tjetër. Dritaret e të vërtetave hyjnore dhe dera e sarajit të mëshirës hyjnore, do të na hapen vetëm kur ne t'i kemi mbyllur të gjitha lidhjet me këtë botë. Dhe kjo do të thotë se para se të shfaqemi, duhet të zhdukemi, para se të martohemi, të divorcohemi, para se të bashkohemi, të ndahemi, para se të ekzistojmë, të eliminohemi, para se të ringjallemi, të vdesim dhe para se të fitojmë jetën e përjetshme, duhet të bëjmë sakrifica në këtë botë të përkohshme.

Për të arritur ekzistencën e vërtetë, duhet të braktisim ekzistencën tonë të rreme. Duhet të themi "La" para se të themi "il-lallah". "La"-ja e pastron zemrën nga shirku, ndërsa "il-lallah", i jep urtësi dhe dashuri. Ky është kuptimi i vërtetë, shikimi i pastër dhe vizioni i fshehtë, që reflektohet në pasqyrën e një zemre të pastër.

Gjithashtu, Mevlana thotë: *"Ata që i kanë ndriçuar shpirtrat, kanë shpëtuar nga ngjyrat dhe erërat. Në çdo frymëmarrje shohin një mirësi dhe një urtësi. Ata e kanë braktisur bukurinë e lëvozhgës së dijes dhe kanë ngritur flamurin e dijes së vërtetë. E kanë lënë mendimin dhe kanë gjetur detin e njohjes. Ata janë tretur në bashkim."* (Vol. I, 3492-94.) *"Mbylle derën e fjalës dhe hap dritaren e zemrës! Dhe hëna do të të puthë prej dritares."*



Ndërsa, për të hapur sytë ndaj botës tjetër, mund të arrihet vetëm pasi të duash shumë Pejgamberin tonë dhe sahabët fisnikë. Kjo, sepse dashuria për ta i shkrumbon dhe i zhduk dëshirat e kësaj bote. Dhe pikërisht kjo dashuri do të të divorcojë me këtë botë. Ajo dashuri t'i mbyll sytë ndaj kësaj bote, sepse vetëm me dashuri mund ta zbulojmë botën shpirtërore. Vetëm me dashuri mund t'i kuptojmë të vërtetat kuranore. Vetëm me urtësinë e përuljes, mund ta shijojmë bukurinë dhe përsosmërinë hyjnore. Vetëm me thesarin e mëshirës hyjnore mund të shkojmë në sarajin e mëshirës hyjnore. E shprehur ndryshe, dashuria për Pejgamberin (a.s.), është çelësi i kuptimit të Kuranit, sepse ai ishte mëshirë për të gjitha botët.

Kur të jemi duke lexuar Kuran, duhet të ndjejmë aromën e Pejgamberit (a.s.) dhe duhet ta lexojmë qartë përgjërimin e tij këmbëngulës, kur thoshte; "Umeti, Umeti - Populli im, Populli im!". Ne duhet ta lexojmë mirë personin të cilit iu zbrit Kurani dhe jo vetëm të lexojmë rreshtat e të kthejmë faqet. Bukurinë e qetësisë së tij shpirtërore duhet ta shohim në çdo fjali e fjalë. Kur të komentojmë Kuranin, duhet të meditojmë shumë mbi Pejgamberin (a.s.), i cili, tha: *"Nëse nuk do të ishte mëshira e Zotit tim, unë nuk do të mund të shpëtoja prej xhehnemit"*. Duhet të përfitojmë prej thesareve të mëshirës së tij të madhe. Duhet ta arrijmë nderin e ndritur të devotshmërisë së tij.

Çështja është se leximi i Kuranit nuk përbëhet vetëm prej shfletimit të tij. Kuptimi i domethënieve të ajeteve nuk mjafton për të kuptuar të vërtetën. Kurani nuk përmban vetëm urdhra për jetën e njeriut. Kurani nuk na njofton vetëm për hallallin dhe haramin, të drejtën dhe të gabuarën. Kurani nuk na mëson vetëm se si të fitojmë xhenetin dhe t'i shpëtojmë xhehnemit. Kjo, sepse Kurani është frymëzim, dritë dhe mëshirë hyjnore. Ai është bisedë miqësore me Allahun. Kurani i shpie njerëzit në një fund të suksesshëm, larg "frikës dhe hidhërimit". Ai e frymëzon njeriun të kapërcejë frikën ndaj vdekjes dhe dashuritë tokësore. Kurani, është një shtues i nevojës për të vërtetën, një frymëzim për shtimin e dijes së vërtetë, një ftesë për t'u vetëdijësuar ndaj së vërtetës dhe një thirrës për në miraxh dhe në xhenetin e miqësisë. Më tepër se dije, Kurani është shërim. Kurani është zgjim shpirtëror për të shkujdesurit. Kurani është një ringjallje dhe jo një bindje e verbër ndaj urdhrave. Kurani nuk është për të përfituar avantazhe, as për të bërë tregti sevapesh dhe as për të fituar biletën për në xhenet, por ai i thërret besimtarët t'ia shesin veten Allahut. Kurani është libri i mëshirës hyjnore, të cilën duhet ta arrijmë.

Kurani i flet zemrës me gjuhën e zemrës. Kurani i ka zbritur Pejgamberit (a.s.), si një shi yjesh. Muhjiddin ibnu'l- Arabi, e shpjegon kështu zbritjen e shpalljes në zemrën e njeriut: *"Sipas mufesirëve* (komentuesve të Kuranit), *Kurani Kerim zbriti i plotë në qiellin e kësaj bote dhe prej aty zbriti në zemrën e Muhamedit (a.s.), në formën e një shiu yjesh. Ajo zbritje do të vazhdojë, derisa Kurani të lexohet haptas apo fshehtas. Nëse e shohim nga pikëpamja e besimtarit, Nata e Kadrit shfaqet në veten e tij pasi ai të pastrohet plotësisht. Një pastrim që e bën njeriun si atëherë kur ka lindur prej nënës"*.

Zemra është vendi i së vërtetës. Aty është vendi i ekzistencës së Tij. Vendi ku shfaqet Ai. Pra, përderisa Ai që e ka dërguar Kuranin gjendet në zemër, si është e mundur që Kuranin të mos e gjejmë aty?

Muhjiddin ibnu'l-Arabi ka edhe disa komente të rëndësishme në lidhje me këtë çështje: "Nuk qëndron njeriu në Kuran, por Kurani tek njeriu. Fjalët hyjnore e mbështjellin të urtin në atë mënyrë, saqë Kurani bëhet natyra e tij". "Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Ka prej atyre që e lexojnë Kuranin në atë mënyrë, saqë ai lexim nuk u kalon përtej fytit."* Ja pra, ai është Kurani, që zbret në

gjuhë dhe jo në zemra. Ndërsa Allahu Teala, të kundërtën e kësaj, e ka thënë për njeriun, i cili ndjen kënaqësi nga kjo shpallje: ***"Ruhu'l Emin (Xhibrili), e zbriti atë në zemrën tënde"*** (Shuara, 193.) Ky është një njeri i tillë, të cilit kjo shpallje i fal një kënaqësi dhe gëzim të papërshkrueshëm. Kur e përjeton këtë, me të vërtetë ai njeri ndjen se Kurani po i zbret direkt në atë moment. Dhe dallimi midis këtyre dy zbritjeve, është se së bashku me Kuranin që zbret në zemër, zbret edhe vetëdija". Allahu iu përgjigj përgjërimit të tij, kur thoshte: *"O Zoti im, ma shto diturinë!"*. Ai që në çdo dy lexime, lexon vetëm një herë me vetëdije, humbet diçka. Ai që ruan freskinë e vetëdijes në çdo lexim fiton gjithmonë. Ndërsa atë që lexon pa kuptuar gjë, Allahu e mëshiroftë!"

Kuptimi i vërtetë i shpalljes, u arrin atyre që janë të dorëzuar, të sinqertë dhe me zemër të hapur. Kurani ia hap veten e tij robërve të bindur, që ecin në gjurmët e Pejgamberit (a.s.) dhe që e zbatojnë sheriatin (ligjin e Allahut) me përpikmëri. Ne duhet të luajmë rolin e Ibrahimit (a.s), Ismailit (a.s) dhe nënës së tij Haxherit (r.a.), Jusufit (a.s.), Musait (a.s.), Hadixhes (r.a.), Hamzait (r.a.) dhe të Bilalit (r.a.). Duhet të ndjekim gjurmët e tyre dhe të përpiqemi të bëhemi si ata. Më parë duhet të ndjejmë mall për Allahun dhe ashtu t'i afrohemi Kuranit. Pastaj ta lexojmë atë me përmallim dhe dashuri hyjnore. Duhet të ndjejmë një etje hyjnore dhe të përdorim syrin e zemrës. Prandaj, përhap dashuri, jep siguri, bëhu bujar, bëj durim ndaj padrejtësive që të bëhen dhe zhytu në oqeanin e njëshmërisë së Allahut Teala. Sepse vetëm atëherë do të mund ta shijosh aromën e këndshme të kuptimeve të fshehta.



Aq sa shtohet ndjeshmëria hyjnore tek dikush, aq tërhiqet edhe ai drejt botës së pafundme të bukurisë së përjetshme. Allahu Teala urdhëron: ***"Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët*** (që u thuhen)***, ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; të tillët janë të mençurit."*** (Zumer, 17-18.)

Kur të jemi në gjendje ta jetojmë të vërtetën kuranore, atëherë do të jemi në gjendje ta ndriçojmë edhe ekzistencën tonë me Kuran. Atëherë do t'i shërbejmë Kuranit me gjithë qenien tonë, në vend që ta analizojmë. Atëherë do të hapet dritarja e zemrës sonë dhe do t'i lexojmë ajetet me dritën e ekzistencës sonë. Atëherë, Kurani Kerim do t'i ndriçojë mendjet tona. E shprehur ndryshe, Kurani do t'ua shfaqë veten atyre besimtarëve që përpiqen dhe luftojnë që ta ngrenë atë.

Shpallja hyjnore e Kuranit duhet lidhur në një mënyrë organike me thelbin e njeriut. E vërteta është se, kur dikush i afrohet shpalljes kuranore, morali dhe personaliteti i tij, mund t'i perceptojë shumë mirë thesaret e moralit të përsosur të atij njeriu të lartë, të cilit iu shpall Kurani. Pra, thelbi i moralit të një njeriu mund ta shohë shumë qartë moralin e përsosur të Pejgamberit tonë (a.s.). Pikërisht kjo është edhe marrëdhënia e përsosur me Kuranin. Prandaj dhe pjesëtarët e umetit të Muhamedit (a.s.), duhet ta kuptojnë mirë se, të duash Pejgamberin, duhet të duash Kuranin dhe të duash Kuranin, duhet të duash Pejgamberin (a.s.). Aq sa e duam Pejgamberin (a.s.), aq duhet ta duam edhe Kuranin. Çdo pjesëtar i umetit të Muhamedit (a.s.), duhet t'u japë rëndësi këtyre pyetjeve: Si duhet ta duam Allahun dhe Pejgamberin? Si mund t'i kthejmë në ujëvarë dashurie këto pak dituri të thata që zotërojmë? Ne duhet të zgjidhim çështjen se si të gjejmë thesarin e dashurisë dhe si t'i kthejmë zemrat tona në kopshte xheneti për të arritur perceptimin dhe përvojën. Pa i stolisur dhe zbukuruar zemrat tona dhe pa i larguar prej aty të gjitha dashuritë e tjera përveç dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), nuk mund ta marrim vizën për në xhenet.

E njëjta gjë vlen edhe për Qaben. Më parë, në sajë të potencialit tonë të brendshëm, duhet të arrijmë thellësinë shpirtërore dhe të gjejmë Qaben e vërtetë që ndodhet aty. Vetëm atëherë mund ta perceptojmë të vërtetën e Qabes. Besimtari që e ka fituar këtë gjendje, kur e viziton Qaben materiale që ndodhet në Mekë, e krahason atë me Qaben që ndodhet në zemrën e tij. Kur e vazhdon haxhin, duke vizituar xhaminë e Pejgamberit (a.s.), në Medine, do ta prezantojë kopshtin e xhenetit material që ndodhet atje, me kopshtin e xhenetit shpirtëror, që ndodhet në zemrën e tij. Pra, e vërteta e zemrës së besimtarit do të bëhet njësh me të vërtetën e Qabes dhe duke u takuar në Medine me dashurinë e jetës, do të rrahë njëherësh me pulsin e gjithë krijimit.

Të duash Pejgamberin (a.s.), do të thotë ta ndjekësh atë në mënyrën më të përpiktë dhe të sinqertë. Dhe jo të imitojmë vetëm veprat e tij të dukshme, por të mund të kuptojmë të fshehtat dhe urtësitë e mësimeve të tij dhe të mund t'i përjetojmë edhe vetë me aq sa kemi mundësi gjendjet shpirtërore, të cilat i ka kaluar edhe ai. Ne mund të arrijmë tek Allahu vetëm duke ndjekur hapat e të dashurit të Allahut, Muhamedit (a.s.).

Shija e Jetës

Mehmet Dinç

"Njeriu i pasur mendon se po shijon lirinë, kur merr ushqime me çanta të tëra dhe pa bërë llogari fare. Njerëzit që përcaktojnë vlerën e tyre, sipas parasë që harxhojnë, mendojnë se kanë arritur kulmin e shijes së jetës. **Mirëpo, pikërisht ata që mendojnë se po e shijojnë jetën në maksimum, mbesin pa dyshim dhe të dështuar përballë jetës.** (Otobüsname, Fatma Karabıyık Barbarosoğlu, fq. 53)

Nëse do të pyesni çfarë është shija e jetës, do të merrnit me qindra përgjigje të ndryshme. Mes përgjigjeve, në mendje vijnë natyrshëm menjëherë: të kesh një kartë krediti të palimituar, të bësh një shëtitje nëpër botë, të blesh makinën apo shtëpinë që pëlqen më shumë etj. Mirëpo, jam në dyshim nëse do të vinte ndonjë përgjigje nga ndonjëri: "*Shija e jetës arrihet kur di të jesh i lumtur me atë që ke!*" Jetojmë në një shoqëri konsumi dhe për arsye të virusit të konsumit që po përhapet me shpejtësi nga njëri tek tjetri, njerëzit besojnë se duke konsumuar do të rrojnë më shumë, se do të jenë më të lumtur. Ndaj dhe për të festuar një gjë që e duan dhe për t'u ngushëlluar për diçka që i mërzit, ndjekin të njëjtën rrugë: konsumin. Ka njerëz, ëndrra e të cilëve është të fitojnë telebingo dhe që fituesit e telebingos i shohin si njerëzit më me fat të botës, për arsye se mendojnë që jetën mund ta shijojnë duke konsumuar dhe konsumimin e shohin si ideal më vete.

Duke fituar nga puna ditë-natë, mendojnë se do të çlodhen duke konsumuar dhe nisin të ndjekin ata njerëz, që e kanë realizuar këtë objektiv. Ndjekin programe të llojit "gossip" dhe lexojnë rreth "thashethemeve mbi të famshmit". Madje, nuk mjaftohen me kaq, por bëhen gazetarë vullnetarë të thashethemeve të zonës ku banojnë, duke analizuar pasuritë dhe mundësitë materiale të të tjerëve dhe "informojnë" fqinjët kur vijnë për vizitë.

Fëmijët që rriten në një rreth të tillë, të krijuar prej këtyre njerëzve, e kërkojnë lumturinë aty ku e kërkojnë të rriturit. Duan ta kenë çdo gjë që pëlqejnë. Çmenden derisa t'u realizohen dëshirat dhe pas një kohe shumë të shkurtër, pasi u realizohet ajo çfarë dëshironin, sillen njësoj me atë që deshën me këmbëngulje, sikur të ishte apo të mos ishte, madje, duke e supozuar që nuk ekziston më, kërkojnë një tjetër.

Tashmë janë bërë legjendë ata fëmijë që flinin me rroba apo këpucë nga qejfi dhe gëzimi që i kishin blerë vetëm për bajrame dhe askush tashmë nuk e beson se një fëmijë i sotëm mund ta përjetojë të njëjtën kënaqësi dhe gëzim.

Mjaftueshmëria, pra, të qenët i kënaqur me atë që ke, është një thesar i çmuar. Të moshuarit na kanë mësuar se jeta shijohet vetëm përmes mjaftueshmërisë. Unë njoh pak njerëz që mjaftohen me atë që kanë dhe që nuk kërkojnë më shumë, njerëz që shijojnë jetën të lumtur, duke u mjaftuar me atë që kanë. Fatëkeqësisht, as një në njëmijë nuk është. Çdokush kërkon të fitojë sa më shumë, me një neps që nuk resht kurrë, kërkon gjithnjë e më shumë të ketë. Mendojnë se jeta shijohet duke fituar sa më shumë, duke konsumuar sa më shumë dhe duke zotëruar sa më shumë gjëra. Mirëpo, si ai që pi ujë të kripur, i cili ndihet gjithnjë i etur, njeriu sa më shumë të konsumojë, ndjen nevojën të konsumojë sërish, sa më shumë të marrë, ndjen nevojën të marrë më tepër, sa më shumë të ketë, ndjen nevojën të ketë më tepër. Por askush nuk mund ta bëjë veten të lumtur me ndjenjën e të pasurit të sa më shumë gjërave. Në këtë botë të vdekshme, këta lloj njerëzish nuk mund ta marrin nga asnjëlloj ushqimi shijen që marrin të varfrit nga një lloj i vetëm ushqimi, kur hanë të uritur në një enë dhe nuk mund të qeshin kurrë me gjithë zemër dhe duke u vezulluar sytë, siç gëzohen të varfrit, nga një gjë e vogël. Këta njerëz bëjnë një jetë të mjerë, duke bërë një garë të pakuptimtë dhe pafund deri në vdekje.

Aftësia shpirtërore për të qenë i kënaqur me atë që ke, është thesari i humbur, pa të cilin nuk ka lumturi. Duhet ta gjejmë dhe ta zotërojmë atë për t'iu kthyer normalitetit, mesatares dhe lumturisë.



Njohja e Prof. dr. Geri Miler me Islamin

Përpara se të punonte si profesor matematike në universitetin e mbretit Faht në Arabinë Saudite, Geri Miler ishte një pastor dhe misionar i përkushtuar në përhapjen e Krishterimit. Pasi Allahu e begatoi me Islamin, në një nga fjalimet e tij të shumta iu drejtua me këtë mesazh të gjithë myslimanëve në botë.

" O Myslimanë! Sikur të ishit të vetëdijshëm për pasurinë e madhe që ju dhuroi Allahu, duke ju bërë të lindni në një familje myslimane,të rriteni e të edukoheni me fenë e bukur islame, do ta falenderonit pareshtur Atë. Feja juaj në të gjitha aspektet qëndron më lart se të gjitha fetë e tjera që njeh bota. Ajo që më ka tërhequr më shumë drejt Islamit, ka qenë qartësia në temat e besimit, qartësi të cilën nuk e kam hasur në asnjë fe tjetër"

Si u bë mysliman?

Miler ishte një misionar ekspert në njohjen e Dhiatës së re dhe të vjetër. Përveç fesë, ai ishte shumë i dhënë edhe pas matematikës. Prandaj i pëlqente që çështjet t'i trajtonte sipas rregullave logjikë. Një ditë mori për të lexuar Kuranin, me qëllimin e vetëm, gjetjen e gabimeve, të cilat më vonë do ta ndihmonin në debatet fetare që do të bënte për të thirrur myslimanët në Krishterim. Pritshmëria e tij ndaj Kuranit ishte një libër i pavlerë, i shkruar në shekullin e 14-të. Por kur filloi të lexonte, ai u mahnit, madje zbuloi të vërteta që nuk mund të gjendeshin në asnjë libër tjetër në këtë botë.

Ai kishte menduar se së paku do të gjente gjurmë të ndjenjave të Muhamedit në Kuran. Kishte menduar se do të gjente patjetër tregimin mbi vdekjen e fëmijëve dhe bashkëshortes së tij të dashur, Hatixhes. Por nuk rastisi asgjë nga ato që priste. Ajo që e mahniti më shumë, ishte se një sure e tërë mbante emrin e Merjemit (Marisë) dhe thurte lavde për të më shumë se bibla. Nga ana tjetër, nuk ekzistonte asnjë sure që mbante emrin e Aishes apo Fatimes (r.a.). Ai u suprizua edhe më tëpër kur vuri re që emri i Isait (a.s.), përmendej plot 25 herë, kurse emri i Muhamedit (a.s.), vetëm 4 herë. Përballë kësaj të papriture filloi ta lexonte Kuranin më me kujdes dhe gjithmonë me syrin kritik, për të gjetur qoftë edhe një gabim të vogël. Por hasi në një ajet shumë të rëndësishëm dhe interesant, prej të cilit u mrekullua. Ajeti ishte: "***A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie."*** (Nisa, 82)

"Testi i falsifikimit" është një parim i njohur sot, që konsiston në studimin e hollësishëm dhe kritik të teorisë së hedhur për të vërtetuar vërtetësinë e saj. Është interesant fakti, që Kurani i fton të gjithë në këtë sfidë dhe në të njëjtën kohë paradeklaron që nuk do mund të gjejnë asnjë gabim në Të.

Asnjë autor në botë nuk mund të guxojë të pretendojë një gjë të tillë. Askush nuk mund të thotë për librin e vet: "Ky libër nuk ka asnjë gabim". Vetëm Kurani e deklaron në mënyrë sfiduese një gjë të tillë.

Një ajet tjetër, që e bëri Prof. Dr. Geri Milerin të reflektojë, ishte: "***A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë***

dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?" (Enbija, 30)

Ky ajet trajton pikërisht temën e kërkimit shkencor, i cili në vitin 1973 fitoi çmimin nobël. Kërkimi shkencor në fjalë trajtonte teorinë e Big Bang-ut. Sipas kësaj teorie, universi është krijuar pas një shpërthimi të madh fillestar. Sipas ajetit të mësipërm, toka dhe qiejt kanë qenë një e tërë. Pastaj, Allahu i ndau për të krijuar universin.

Kurse si përgjigje e atyre që pretendojnë se Kurani është frymëzim i djallit, janë ajetet kuranore: ***"Atë*** *(Kuran)* ***nuk e kanë zbritur djajtë. Jo vetëm që kjo s'u takon atyre, por as nuk kanë fuqi të bëjnë një si ai. Në të vërtetë, ata mënjanohen nga të dëgjuarit*** (e Shpalljes)***."*** (Shuara, 210-112)



Kurse një ajet tjetër urdhëron besimtarët t'i kërkojnë mbrojtje Allahut nga shejtani***. "Kur dëshiron të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar, sepse, në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre. Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut."*** (Nahl, 98-100)

Si mundet që shejtani të ketë ndihmuar në përgatitjen e Kuranit dhe pastaj të mallkojë veten dhe t'i urdhërojë besimtarët t'i kërkojnë ndihmë Allahut prej tij. Këto ajete janë disa mrekulli të këtij libri të pashembullt. Vetë Kurani, të gjitha pretendimeve për trillimin e tij u jep përgjigje jashtëzakonisht logjike. Nuk ka libër tjetër të ngjashëm me stilin e Kuranit. Të gjithë librat e tjerë hyjnorë japin informacion në lidhje me historitë e mëparshme. Tregojnë për luftën e mbretërve dhe vendin ku kanë jetuar dhe informacione rreth familjes së mbretërve.

Kurani nuk është kështu. Ai i jep një informacion të ri lexuesit dhe për të vërtetuar dhe qenë i sigurt që ky informacion nuk është produkt i mendjes njerëzore, i propozon atij kërkimin. Prof. Dr. Miler, pasi u konvertua në mysliman, shkroi shumë artikuj nëpër revista dhe gazeta në lidhje me fetë.

Madhështinë e Kuranit nuk e pohojnë vetëm myslimanët, por edhe jomyslimanët, madje edhe armiqtë më të egër janë detyruar të pranojnë madhështinë dhe mrekullinë e Kuranit.

Ndryshe nga se mendojnë njerëzit, Kurani nuk flet vetëm për jetën në shkretëtirë. Ai është një libër që trajton çdo aspekt të jetës së njeriut. Miler tregon për një detar që është bërë mysliman duke lexuar ajetet kuranore, që flasin për detin dhe gjendjen shpirtërore të atyre që bëjnë udhëtime detare. Fillimisht pandehu se Muhamedi (a.s.), ishte një detar. Kur mësoi të vërtetën, e kuptoi që Kurani ishte fjala e Zotit.

Sipas Profesor Milerit, sikur Kurani të ishte produkt i mendjes së Muhamedit (a.s.), ai patjetër duhet të reflektonte gjendjen e tij shpritërore dhe psikologjike. Por në Kuran nuk konstatohet asnjë moment gëzimi apo hidhërimi nga jeta e Muhamedit (a.s.).

Shkencëtarët i ka mahnitur përshkrimi që u bën Kurani periudhave të zhvillimit të embrionit. Një përshkrim i tillë është i mundur vetëm me zotërimin e një teknologjie të lartë.

Sipas evidentimeve të vetë Profesor Milerit, në enciklopedinë e re të kishës katolike në lidhje me Kuranin, thuhet: "Në lidhje me burimin e Kuranit janë hedhur shumë teori. Por deri më sot asnjë nga këto teori nuk konsiderohet e pranueshme për mendjet e shëndosha." Siç shikohet, vetë kisha katolike është e detyruar të pranojë dështimin e teorive që përpiqen të hedhin poshtë burimin hyjnor të Kuranit. Për kishën katolike, burimi i Kuranit vazhdon të mbetet një problem i pazgjidhur. Ata nuk pranojnë që Kurani është fjalë e Zotit, por teoritë që trajtojnë burimin e Kuranit i konsiderojnë si të papranueshme. Ata punojnë me gjithë shpirt për të vërtetuar që Kurani nuk është fjalë e Zotit. Por nuk kanë sukses. Dhe pas 14 shekujsh përpjekjeje nuk kanë arritur të sjellin as edhe një teori të pranueshme nga mendja dhe arsyeja e shëndoshë. Me këtë, kanë pohuar padashje që Kurani nuk është një libër, që mund të mohohet lehtë.

Prof. dr. Mehmet Görmez



PËRMASA SOCI

Jetojmë në një periudhë dhe në një pamësi botëkuptimore, ku çdo gjë projektohet sipas dëshirave, kënaqësive, veseve dhe prirjeve të egos. Sipas Kuranit, qëllimi i krijimit është ibadeti dhe ndërtimi i jetës, kulturës e qytetërimit në tokë. Kur jeta devijon nga ky qëllim parësor, atëherë ajo shndërrohet thjesht në argëtim, dëfrim dhe lojë. Fatkeqësisht, qëllimi kryesor i jetës po injorohet, duke e paraqitur atë gjithnjë e më tepër si një periudhë që duhet kaluar në përmbushjen e kënaqësive dhe dëshirave fiziologjike. Mënyra mondane dhe hedoniste e të jetuarit po na serviret si një nga qëllimet kryesore të jetës në tokë. Kjo ka sjellë një shfrenim të papërmajtur të epsheve, dëshirave dhe kënaqësive. Njerëzit në mënyrë permanente po largohen dhe distancohen nga vlerat fetare dhe shpirtërore. Të përfshirë nga vorbulla e jetës së përkohshme, kanë harruar qëllimin e vërtetë të jetës, kanë harruar besimin, vdekjen dhe jetën e amëshuar. Njerëzit përpiqen për interesat dhe përfitimet e tyre materiale sikur do të jetojnë përjetësisht në këtë botë.

Nga ana tjetër, jetojmë në një kohë në të cilën përhapja e rrymave të shthurura fetare, ideologjike, morale dhe intelektuale kanë marrë përmasa galopante, duke sjellë jo vetëm prishjen e ekulibrit në rrafshin individual dhe shoqëror, por edhe prishjen e ekulibrit kozmik.

Mohimi i vlerave njerëzore, fetare dhe shpirtërore ka sjellë tëhuajsimin dhe denatyrizimin e njerëzores, ka sjellë shfrytëzimin pa kriter të të mirave materiale dhe pasurive natyrore, ka sjellë legjitimitetin e një sërë perversiteteve dhe shthurjeve. Të gjitha këto e kanë vendosur njeriun përballë problemeve serioze, që rrezikojnë edhe vetë ekzistencën e tij.

Kurse problemi më i madh dhe emergjent i myslimanëve sot, është mungesa e bashkërendimit dhe bashkëveprimit midis besimit dhe veprimit. Pejgamberi (a.s.), e ka vlerësuar besimin, veprimin dhe moralin si një tërësi organike. Përmendja bashkëngjitur e fjalëve besim dhe veprim në Kuran mbi njëqind herë, tregon pikërisht këtë lidhje të ngushtë midis tyre. Kurse Pejgamberi (a.s.), në një hadith, krahas Teuhidit, i cili është formula e besimit, ka përmendur edhe heqjen e një pengese nga rruga. Përkufizimi i imanit përfshin të dyja këto dhe çdo gjë të dobishme që ekziston midis tyre. E njëjta situatë është edhe me koceptet besim, islam dhe ihsan, që kalojnë në hadithin e famshëm, të njohur si hadithi i Xhebrailit, ku të tre nivelet janë të gërshetuar dhe ndërvaruar në mënyrë harmonike me njëri-tjetrin. Prandaj, një besim që nuk përqafohet në tërësinë e tij dhe nuk shndërrohet në stil jete, por ekziston vetëm në rrafshin teorik, pa zbritur në zemrën dhe vetëdijen e njeriut, nuk mund të sjellë transformim



ALE E BESIMIT

të individit dhe shoqërisë. Besimtar i vërtetë është ai që imanin teorik e shfaq përmes imanit praktik. Parimet teorike që ka sjellë Pejgamberi (a.s.), janë për ta çuar besimtarin drejt veprimit dhe pasqyrimit të besimit në jetën sociale. Nga mësimet e Pejgamberit (a.s.), mësojmë se Teuhidi nuk është vetëm besimi në ekzistencën dhe njësimin e Zotit. Teuhidi përmban në vetvete përmasa individuale dhe shoqërore. Ai nuk synon vetëm njësimin e Zotit, por edhe unifikim të arsyes me ndjenjën, të tokësores me qiellloren, të shpirtit me trupin. Nga mësimet dhe sjellja e Pejgamberit (a.s.), mësojmë se imani është që mbi të gjitha të duash Allahun dhe Pejgamberin (a.s .), të duash për hir të Allahut, të duash për tjetrin atë që do për vete, të mos biesh në gjumë i ngopur ndërsa fqinji është i uritur. Imani është të jesh i drejtë në mendime dhe sjellje, të jesh besnik, të jesh fjalëdrejtë dhe fjalëbukur, të ushqesh njerëzit, të jesh tolerant, durimtar, me dinjitet dhe moral të bukur. Imani është të qëndrosh larg ndalesave dhe të jesh sa më afër devotshmërisë, të kujtosh vdekjen dhe të bësh përgatitje për pas vdekjes.

Prandaj, përveç vlerës teorike, duhet t'u mësojmë njerëzve edhe vlerën praktike të besimit. Sepse vetëm artikulimi i shehadetit nuk mjafton për të qenë besimtar. "***Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë',pa u vënë në provë?*** ***Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë."*** (Ankebut, 2-3) Qindra tregues të imanit gjenden në zotërimin social. Kur besimi humbet përmasën sociale, myslimanët humbasin dinamizmin shoqëror dhe, për pasojë, fillon rrënimi dhe rënia e tyre. Sot fatkeqësisht, ekziston një perceptim shumë i gabuar ndaj besimit, duke e privuar atë nga përmasa praktike dhe sociale. Kjo gjë pengon pasqyrimin e moralit të Islamit në nivel individual dhe social.

Si përfundim, imani është të pranosh ekzistencën dhe njësimin e Zotit dhe t'u bindesh me përkushtim të gjitha urdhëresave dhe ndalesave, që rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me Zotin dhe mjedisin. Besimi nuk është thjesht një shqiptim me gojë dhe pranim me zemër, por është një disiplinë që shpjegon gjithë ekzistencën. Boshti i këtij besimi është Allahu. Njeriu fiton vlera në këtë besim, i cili fillon me besimin në një Zot të vetëm, për t'u plotësuar me besimin në botën tjetër. Kuptimi i krijimit, i jetës dhe i vdekjes gjendet vetëm në besim. Sado që imani të përkufizohet si pranim me zemër dhe shqiptim me gojë i ekzistencës së Zotit, treguesi më i madh dhe i rëndësishëm i tij është puna dhe sjellja. Prandaj, në ditën e gjykimit njeriu do të gjykohet sipas veprave dhe jo sipas fjalëve.

"Përse rabinët dhe dijetarët
nuk i ndalojnë ata të thonë fjalë të ulëta (për Zotin)
dhe të hanë fitimet e paligjshme?
Sa keq veprojnë ata!"

(Maide, 63)

Një Ajet

Pejgamberët e kanë konsideruar përçimin e mesazhit hyjnor qëllim të ekzistencës së tyre. Nga ky këndvështrim, pejgamberët kanë punuar me gjithë forcat e tyre dhe pa u dorëzuar për përcjelljen e mesazhit. Nuhi (a.s.), është bërë simbol i vendosmërisë dhe këmbënguljes për përhapjen e mesazhit hyjnor. Muhamedi (a.s.), nganjëherë shqetësohej dhe pikëllohej jashtë mase, për shkak të moskokëçarjes dhe indiferencës së njerëzve ndaj mesazhit hyjnor. Prandaj Allahu e këshillon Profetin e Tij të mos shqetësohet. ***"A mos vallë Ti (O Muhamed) do të shkatërrosh veten, ngaqë ata nuk duan të besojnë?"*** (Shura, 3)

Pas Pejgamberëve shumë njerëz të fesë janë përpjekur për të përhapur mesazhin në mesin e njerëzve. Problemet dhe vështirësitë që hasën gjatë kësaj rruge nuk përbënin pengesë për ta. Në çdo epokë dhe gjeografi kanë kaluar një numër i madh përfaqësuesish të kësaj kauze të shenjtë. Të gjithë ne u jemi borxhlinj këtyre njerëzve.

Sot, kur bëhet fjalë për të kryer këtë detyre profetike, menjëherë të vijnë në mendje njerëzit e fesë. Njeriu i fesë duhet të jetë një figurë shoqërore që ushqen dashuri dhe respekt tek njerëzit. Njeriu i fesë nuk duhet në asnjë mënyrë të konsiderohet thjesht një imam në xhami apo një person që fal namazin e xhenazes.

Sprova e njeriut në këtë botë ndryshon sipas statusit, pozitës dhe mundësive që zotëron. Nga kjo pikëpamje, nuk është e vështirë për të konstatuar rëndësinë dhe përgjegjësinë e madhe të njerëzve të fesë, sepse këta, përveç detyrave individuale, kanë përgjegjësinë dhe detyrën e ndriçimit të shoqërisë. Njeriu i fesë nuk është nëpunës shtetëror.

Sprova më e madhe e njeriut të fesë është përçimi apo jo i mesazhit tek të tjerët. Udhëzimi fetar mbart një rëndësi të veçantë sot, kur njerëzit kanë humbur entuziazmin shpirtëror dhe janë zhytur në batakun e kënaqësive të kësaj bote. Kjo është një detyrë dhe përgjegjësi përpara Allahut dhe shoqërisë.

Detyra e thirrjes është një detyrë që kërkon entuziazëm. Sot ka shumë njerëz të fesë që thirrjen e kanë kufizuar me hutben e xhumasë apo me organizimin e mevludeve. Është shumë i trishtueshëm fakti që një pjesë e mirë e njerëzve të fesë nuk e kanë marrë seriozisht këtë çështje. Qëndrimi indiferent i njerëzve të fesë përballë situatës në të cilën ndodhet rinia dhe shoqëria në përgjithësi, është shumë pikëllues. Allahu nuk e dënon një popull, përderisa në të ka njerëz që urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë nga e keqja. Por, kur në një shoqëri nuk gjendet një grup njerëzish që ta kryejë këtë detyrë, atëherë dënimi i Allahut është afruar. Këtë e konfirmon Pejgamberi (a.s.): *"Betohem tek Ai, në dorë të të cilit është shpirti im, ju ose do të urdhëroni për mirë dhe ndaloni nga e keqia, ose përndryshe Allahu do t'ju dënojë, do t'i luteni, por lutja nuk do t'ju pranohet."* (Tirmidhi, Fiten, 9) Nuk është mençuri të jepesh mbas kësaj bote, në një kohë kur njerëzit janë krejtësisht bosh nga ana shpirtërore. Të gjithë besimtarët duhet të sakrifikojnë, por sakrificën më të madhe duhet ta tregojnë pikërisht njerëzit e fesë. Kjo detyrë nuk duhet të shndërrohet në asnjë mënyrë në profesion. Profeti (a.s.), në një hadith thotë: *"Sëmundja e parë që preku Jehuditë ishte kjo: Kur dikush shikonte dikë duke bërë mëkat, e këshillonte duke i thënë: 'Ki frikë Allahun dhe hiq dorë nga gjërat e ndaluara. Kur e shikonte të nesërmen të njëjtin person duke bërë mëkat, nuk e shqetësonte qëndrimi dhe shoqërimi me të. Në këtë mënyrë, Allahu i përngjasoi zemrat e të mirëve me të këqinjtë."*

Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.),
se Pejgamberi -*sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem*-, ka thënë:
"Një njeri e vizitoi një vëlla të vetin në një fshat tjetër. Allahu i Madhëruar caktoi një engjëll për ta vëzhguar gjatë rrugës së tij dhe kur erdhi tek ai (engjëlli) e pyeti: 'Ku po shkon?' 'Te një vëlla imi në këtë fshat.' - u përgjigj ai. 'A mos ke tek ai ndonjë interes material? - e pyeti më pas. 'Jo, por unë atë e dua për hir të Allahut!' - u përgjigj ai. (Engjëlli) Tha: 'Unë jam i dërguar nga Allahu te ti për të të njoftuar se Ai të do ty ashtu siç e do ti atë njeri." (Muslim, Birr, 38)

Një Hadith

Ky hadith profetik na jep një tablo të qartë dhe të gjallë të dashurisë për hir të Allahut. Dashuria për hir të Allahut konsiston në dashurinë pa interes dhe përfitim. Duke qenë se dashuria midis besimtarëve është për hir të Allahut, të gjithë besimtarët kudo që ndodhen janë vëllezër. Prandaj, Allahu thotë në Kuran : ***"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."*** (Huxhurat,10) Ashtu si Pejgamberi (a.s.), i hapi krahët e mëshirës gjithë njerëzimit edhe ne si ndjekës të Tij duhet t'u hapim zemrat të gjithë atyre që trokasin në të.

Hadithi këshillon për një vëllazëri të sinqertë, të bazuar në Teuhid, larg ndasive etnike dhe sektare. Diversiteti në mendim nuk mund të jetë shkak për cenimin e kësaj vëllazërie. Fatkeqësisht, sot shumë grupe gjoja në emër të së vërtetës dhe larg ndjenjës së vëllazërisë përjashtojnë dhe akuzojnë për blasfemi një pjesë të mirë të myslimanëve.

Duket qartë që në këtë fe universale dhe gjithëpërfshirëse nuk mund të ketë vend për monopol dhe mendjengushtësi. Islami nuk synon vëllazërinë e një grupi të vogël, por vëllazërinë e gjithë ymetit islam.

Hadithi i lartpërmendur e shpreh qartë, që dashuria e vërtetë është ajo për hir të Allahut. Vëllai mysliman duhet të kryejë të gjitha obligimet që i takojnë ndaj vëllait të vet. Kjo lloj vëllazërie lind shfaqjen e dashurisë në forma të ndryshme midis myslimanëve, si konsultimi midis njëri-tjetrit, ndihma reciproke, mbajtja e lidhjeve miqësore, mosmbajtja mëri etj.

Rëndësinë e vëllazërisë në Islam nuk e shpreh kush më bukur se Hadithi Profetik: *"Nuk do të hyni në xhenet, deri sa të besoni dhe nuk do të besoni deri sa të doni njëri-tjetrin."* (Muslim, Iman,39) Besimtari, duke qenë i vetëdijshëm për këtë, i lutet Allahut në këtë formë: ***"O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë ndonjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!"*** (Hashr, 10)

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Vizita tek njëri-tjetri.
2. Dashuria për hir të Allahut.
3. Fitimi i dashurisë së Allahut përmes dashurisë së njerëzve për hir të Allahut.
4. Rëndësia e vëllazërisë.



ZGJEDHJET NË JETË

ZGJEDHJA E SHOQËRISË

Gjendja, që në terminologjinë islame quhet *sari*, kalon nga një një njeri tek tjetri. Nëse një njeri shoqërohet me njerëz të mirë, atëherë do t'i drejtohet së mirës. Nëse shoqërohet me të këqinjtë, ai do të mbetet nën ndikimin e së keqes. Kjo marrëdhënie është një nga ligjet kryesore të psikologjisë njerëzore. Të vjetrit e kanë përkufizuar këtë proces, me shprehjen: **"Sheh rrushi rrushin dhe piqet."**

Njeriu ndikohet nga gjendja e atij njeriu që e vlerëson, nga gjendja e atij me të cilin qëndron, pasi personaliteti dhe karakteri i njeriut është i prirur t'i përngjasojë dhe të imitojë tjetrin. Ndaj dhe njeriu, me apo pa vetëdije, kopjon aspektin privat të atij që pëlqen dhe me të cilin ka afrimitet. Kjo pikë përbën shumë rëndësi, veçanërisht në periudhën e rinisë, atëherë kur formohet personaliteti dhe karakteri.

Ndaj dhe Zoti i Madhëruar, në Kuranin Famëlartë thotë:

"...Bëhuni me ata që janë të sinqertë!" (Teube, 119.)

Vërtet njeriu krijon me njeriun që pëlqen njëfarë uniteti në ndjenjat, mendimet, mënyrën e jetesës dhe në prirje. Ndaj dhe të qëndruarit bashkë me të sinqertët (*salih*), bëhet shkak që të drejtohesh nga pozitivja.

Në këtë gjendje, natyrisht, është me rëndësi të shmanget nga *gafilët* (të shkujdesurit ndaj së keqes) dhe *fasikët* (gjynahqarët). Sa bukur që e shpreh këtë të vërtetë kjo thënie: **"Ai që fle me të verbër, zgjohet i vëngër**."

Lidhur me këtë temë, **Pejgamberi** (a.s.), ka dhënë këtë shembull:

"Gjendja e shokut të mirë dhe të keq, i ngjan gjendjes së atij që shet parfum dhe atij farkëtarit që bën gjyryk. Ai që shet parfum, ose të dhuron pak nga aroma e mirë edhe ty, ose ti merr nga ai. (Ose, përsa kohë që gjenden pranë), *merr erë të mirë. Kurse ai që nxjerr gjyryk, ose të djeg rrobën, ose të shqetëson me erën e keqe të gjyrykut."* (Buhariu, Zebaih, 31.)

Shejh Sadi-i Shiraziu, pasi jep si shembull ngjarjen e djelmoshave të Kehfit (shpellës), që gjendet në Kuranin Famëlartë, thotë:

"Një qen, ngaqë qëndroi bashkë me *salihët*, u bë mik dhe meritoi të përmendet në Kuran. Gratë e Hazreti Nuhut (a.s.) dhe Hazreti Lutit (a.s.), ngaqë qëndruan bashkë me *fasikët*, u bënë rrugëtarët e xhehnemit, duke rënë në *kufër*."

Resulallahu (a.s.), ka thënë:

"Vetmia është më e mirë sesa shoqërimi me njerëz të këqinj; kurse njerëzit salih, janë më të mirë sesa vetmia..." (Hakim, III, 343; Bejhakiu, Shuab, 256/4993.)

Rumiu ka thënë:

"Betohem në Allah që gjarpri i keq është më i mirë sesa shoku i keq! Gjarpri i keq i merr jetën njeriut. Por, shoku i keq e hedh njeriun në zjarrin e përhershëm, e djeg e përcëllon! Edhe sikur të mos flasë, merr vese nga shoku i keq! Zemra merr fshehurazi nga edukimi i tij, e pëlqen edukatën e keqe të tij, e bën edukatë të vetën! Një shok që nuk e di ç'është drejtësia, se ç'do të thotë të kesh diçka të shtrenjtë, të plaçkit gjithçka



tënden dhe ikën!"

Imam Rabbani, jep një shembull të tillë, lidhur me ata që ndjejnë respekt ndaj të këqinjve dhe lidhur me dëmin që të japin miqësitë e tilla:

"Ai që rri me bixhozxhinjtë, ndoshta nuk luan bixhoz. Kështu, mund të mendojë se nuk është ndotur. Mirëpo, për sa kohë që vazhdon të jetë bashkë me bixhozxhinjtë, duke u ndikuar negativisht prej tyre, nis dhe mendon mirë për lojën e bixhozit. Pikërisht ky, është edhe shkatërrimi shpirtëror."

Prandaj, njeriu duhet të shoqërohet me njerëz të mirë dhe vetë ai duhet të manifestojë miqësi të mirë. **Resulallahu** (a.s.), ka thënë:

"Shoqërohu vetëm me besimtarët, qëndro vetëm me ata! Ushqimin të ta hanë vetëm njerëzit e takvasë!" (Ebu Davud, Edeb, 16; Tirmidhi, Zuhd, 56/2395.)

"Sipas Allahut të Madhëruar, më i miri nga shokët është ai që është i dobishëm për shokun e vet..." (Tirmidhi, Birr, 28.)

Një tjetër çështje është nëse njeriu shoqërohet me një njeri që është i njëjtë në dije, në sjellje dhe arsyetim, atëherë ai është njeri i qetë. **Mevlana** –kuddise sirruhu, ka thënë:

"Zogu fluturon vetëm me zogjtë e të njëjtit lloj. Takimi me zogjtë e llojit tjetër është si takimi me vdekjen. Ndërkohë që çdo lloj tërheq llojin e vet, si mund të rrojë tok një sorkadhe bukuroshe me gomerë e derra?.."

"Ah! Pasha shqetësimet që na jep miku që nuk përshtatet me ne!.. Pasha plagët e thella që i shkaktohen zemrës! O njerëz të lartë, o njerëz të mëdhenj; pa mblidheni mendjen dhe kërkoni për veten tuaj shokë të përshtatshëm!"

Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Do të vijë një kohë kur nuk do të ketë gjëra më me vlerë sesa këto: paraja hallall, një vëlla që do ta shoqërosh me gjithë shpirt dhe një Traditë Profetike me të cilën mund të veprohet." (Hejthemiu, I, 172.)

Vërtet njeriu
krijon me njeriun që pëlqen
njëfarë uniteti në ndjenjat, mendimet,
mënyrën e jetesës dhe në prirje.
Ndaj dhe të qëndruarit
bashkë me të sinqertët (salih),
bëhet shkak që të drejtohesh
nga pozitivija.

ZGJEDHJA E PROFESIONIT

Një nga zgjedhjet që i jep drejtim jetës së njeriut, është zgjedhja e profesionit. Një mysliman duhet të zgjedhë një profesion që e bën të meritojë pëlqimin e Zotit të Madhëruar dhe që u bën dobi njerëzve, pasi një zgjedhje e gabuar në këtë drejtim, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë tek lumturia e përhershme. Kur zgjidhet një profesion, nuk duhet bërë kujdes imazhi në sytë e njerëzve, por mbi të gjitha duhet vërjetur ligjshmëria dhe pranueshmëria tek Zoti i Madhëruar. Një punëtor, që fiton punën e tij në rrugë hallalli, me një njeri që ka

ofiqe dhe statuse dhe që është drejtues i punëve jo të ligjshme, padyshim që nuk kanë të krahasuar në syrin e Zotit.

Sahabët e nderuar e pyetën një ditë Resulullahun (a.s.):

"Kush është njeriu më i mirë, me të cilin duhet qëndruar?"

Resulullahu (a.s.), ktheu këtë përgjigje:

"Ai njeri që, kur ta shikoni, t'ju kujtojë Allahun; kur të flisni me të, t'ju shtojë diturinë dhe me veprat që bën, t'ju drejtojë për Ahiret." (Hejthemiu, X, 226.)

ZGJEDHJA E BASHKËSHORTIT/ES

Allahu i Madhëruar i ka krijuar krijesat për të jetuar në çift, vetminë dhe njëshmërinë e ka bërë një cilësi që i përket vetëm Atij. Kështu që, të gjitha krijesat kanë nevojë për njëra-tjetrën.

Ndërkaq, Zoti i Madhëruar u ka vendosur mashkullit dhe femrës një ndjenjë dashurie dhe dhembshurie, si një shkak që i përgatit ata për dashurinë ndaj Tij. Dhe, për realizimin në mënyrë të ligjshme, përmes marrëveshjes së nikahut, ka urdhëruar të krijohet familja. Në këtë pikëpamje, foleja e familjes është një shkallë e pazëvendësueshme e dashurisë ndaj Allahut dhe është po ashtu një ligj për vazhdimësinë e brezave. Pra, aq sa është një nevojë fiziologjike, martesa është po ashtu edhe një institucion me qendër zhvillimin shpirtëror.

Martesa, duke fisnikëruar individët, bëhet shkak që të rriten breza të mbarë. Lidhur me temën në fjalë, Zoti i Madhëruar ka këshilluar në këtë mënyrë:

"O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!." (Furkan, 74.)

Kur zgjidhet një bashkëshorte për të krijuar një familje të lumtur, është kusht që të respektohen me rigorozitet rregullat që ka vendosur Islami. Thelbi i këtyre rregullave është:

Ata që do të martohen, të mos e pëlqejnë bashkëshorten/in vetëm në sajë të shkaqeve kalimtare dhe të atyre që u pëlqen nefsi i tyre, si bukuria sipërfaqësore dhe pasuria. Një martesë që realizohet vetëm si pasojë e dëshirave biologjike dhe epshore, nuk jep frutin e dashurisë dhe të afrimitetit, sepse njerëzit në këto martesa, zakonisht bëhen robër të dëshirave epshore.

Kësisoj, kur njeriu martohet, duhet bërë zgjedhje, duke u vënë peshën cilësive shpirtërore, si imani dhe edukata. Lidhur me temën në fjalë, **Resulullahu** (a.s.), ka thënë:

"Me një grua martohet për katër arsye: për devotshmërinë, prejardhjen, pasurinë ose për bukurinë e saj. Martohu me të devotshmen dhe do të jesh i suksesshëm." (Buhariu, Nikah, VI, 123)



"O Zoti ynë,
dhurona nga gratë tona
dhe trashëgimtarët tanë,
ç'është prehje për sytë tanë
dhe bëna shembull
për të mirët!."

Ky hadith, njëkohësisht, përfshin cilësitë që duhet të kërkohen edhe tek një mashkull, sepse për çdo mysliman gjëja më e çmuar pas devotshmërisë është që njeriu me të cilin martohet, të jetë vepërmirë. **Mashkulli *salih* është shtylla e patundshme e sarajit të qetësisë, kurse femra *saliha* është stolia më e çmuar e oborreve të lumturisë.**

Medoemos duhet bërë kujdes ekuilibri mes familjeve. Ky ekuilibër shihet në pikat që bashkohen dy familjet nga aspekti i pasurisë, sjelljes dhe kulturës.

Të gjithë jemi dëshmitarë të gabimeve që bëjnë të rinjtë tanë kur bëjnë zgjedhjen martesore. Përmes divorceve të pavend shkatërrojnë veten e tyre, fëmijët dhe familjet e tyre. Dhe më e keqja është se sa e sa gafilë, nuk i afrohen martesës dhe shkatërrohen, duke hyrë në vorbullën e gjynaheve dhe harameve.

Ekuilibri dhe harmonia mes bashkëshortëve në martesë përbën rëndësi të veçantë. Pasi, ashtu sikurse thotë edhe **Hazreti Mevlana**:

"Nëse njëra prej këpucëve ta shtrëngon këmbën, atëherë asnjëra prej tyre nuk hyn më në punë.."



"Nëse njëra
prej këpucëve
ta shtrëngon këmbën,
atëherë asnjëra prej tyre
nuk hyn më në punë.."

Bashkimet jashtë nikahut, për arsye se bien në kundërshtim me qëllimin e krijimit të njeriut, përfundojnë me shkatërrim dhe mjerim të plotë. Nga kjo gjendje, dëmtohen shumë si individi, ashtu edhe familja dhe shoqëria.

Për të mbrojtur njerëzit nga çdo rrezik, Zoti i Madhëruar i ka shpallur bashkimet jashtë nikahut si gjynah të madh dhe ka vendosur ndëshkime shumë të rënda ndaj tyre.

Si përfundim, nikahu u përket qenieve që janë të përgjegjshme, si njerëzve dhe xhindëve. Kurse krijesat e tjera janë të lira në këtë pikë. Garancia e nderit dhe dinjitetit të njeriut është e domosdoshme.

HOBET

Sipas botëkuptimit islam, nuk ekziston ndonjë koncept "kohë e lirë". Zoti i Madhëruar thotë:

"Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme)***, përpiqu fort*** (në adhurim) ***dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!"*** (Inshirah, 7-8.)

Edhe atëherë kur njeriu është lodhur në punën e tij kryesore, duhet të çlodhet me veprimtari të duhura dhe "hobe" të dobishme.

Nuk mund të mendohet që një i ri mysliman të zërë kohën me *hobe* që nuk janë të lejuara nga Zoti. Të angazhohesh me një hobi që është *mubah* dhe që nuk bën as dobi e as dëm, është shpërdorim i kohës. Ndaj dhe hobet e një myslimani duhet të jenë të ligjshme dhe vepra të dobishme.

Nuk duhet harruar se njerëzit i krijojnë vetë zakonet. Mirëpo, më pas bëhen pre të atyre praktikave. Një angazhim që nis nga një kureshtje e pafajshme, është mjaft e mundshme që të ndryshojë kryekëput jetën e njeriut.

Për shembull, nuk mund të krahasohet jeta e një djaloshi që vlerëson kohën e lirë duke lexuar librat e dobishëm, me jetën e një tjetri që e kalon kohën e lirë me lojrat kompjuterike dhe në krye të siteve epshore të internetit, duke harxhuar kohën. Një njeri që e shpenzon kohën me gjëra të dobishme, ndërkohë që pasuron dynjanë e tij, pasuron gjithashtu edhe ahiretin e tij. Kurse tjetri, që shpenzon kohën me hobet që janë vetëm shpërdorim kohe, do të arrijë në pragun e një falimentimi të madh.

Ndaj dhe duhet të jemi më të kujdesshëm ndaj hobeve dhe praktikave tona, si sporti, muzika, lojrat dhe dëfrimet.

Hazreti Mevlana, lidhur me praktikat që janë bërë zakon i keq te njerëzit, jep një shembull të tillë:

"Një njeri fjalëmbël, por hijerëndë kishte mbjellë në rrugë një shkurre me gjëmba. Kalimtarët e qortonin, duke i thënë: 'Hiqi këto!' Mirëpo, ai nuk reagonte fare.

Shkurrja me gjemba gjithnjë po rritej. Njerëzit gjakoseshin këmbësh tek kalonin aty. Shqyheshin rrobat nga gjembat dhe endacakët gërvishteshin.

Valiu e urdhëroi:

-Hiqi!

-Dakord, do t'i heq një ditë. – tha.

Pastaj:

-I heq nesër, pasnesër,- tha duke premtuar.

Pas pak kohësh, gjembat u forcuan edhe më shumë.

Një ditë valiu i tha:

-O njeri që nuk mban fjalën! Mos na e zvarrit urdhrin tonë!

Njeriu që kishte mbjellë shkurren, i tha:

-Zotëri, kemi plot ditë përpara, mos u merakosni! Një ditë prej ditësh do ta shkul këtë shkurre. Atëherë valiu i tha:

-Ti thua që nesër e kryen këtë punë, por dëgjo mirë: ato gjemba gjithnjë e më shumë po forcohen. Edhe ai që do ta shkulë, është gjithnjë duke u plakur dhe po i bie fuqia. Shpejto, mos e harxho kot kohën..."



Ja pra, edhe ti pranoje si një gjemb çdo ves tëndin! Ato gjemba sa e sa herë duhet të të kenë shpuar këmbën, të kanë gjakosur. Ti u sëmure nga natyra jote. Mirëpo, ti nuk e kupton shkakun e sëmundjes tënde.

Mirë që nuk e kupton se vesi yt i keq shqetëson edhe të tjerët, i plagos ata, vallë nuk e vëren plagën që ty të ka shkaktuar? Kësisoj, ti je edhe për veten edhe për të tjerët shqetësim, vuajtje!

Ti, o merre sopatën dhe godit si burrë, sikur Hazreti Aliu që këputi portën e Kështjellës së Hajberit, ose bëje fidan të një trëndafili atë gjemb. Pra, injektoje me fidanin e trëndafilit, që të të transformohen gjembat e tua në oborr trëndafilishteje..."

Resulullahu (a.s.), i ka nxitur myslimanët të bëjnë aktivitete të ndryshme, si gjuajtja me shigjetë, notimi, garimi me kuaj dhe deve. Gratë po ashtu, i ka nxitur të bëjnë veprimtari të përshtatshme me natyrshmërinë e tyre, si qendisje, qepje, punët e shtëpisë etj. Ashtu siç shikohet, secila prej tyre sjell dobi. Në këtë mënyrë, njerëzit, kur kanë kohë të lirë, ruhen të mos bien pre e punëve të gabuara dhe gjithnjë përparojnë dhe zhvillohen. Përgatiten që Islamin ta përfaqësojnë nga çdo aspekt, në mënyrën më të mirë të mundshme. Mirëpo, duhet të bëjmë kujdes në këtë pikë; ndërkohë që bëjmë këto aktivitete, duhet të ruajnë rigorozitetin islam, si nga aspekti i veshjes, ashtu edhe nga aspekti i vendeve në të cilat zhvillohen këto veprimtari. Nuk duhet bërë sport me kostume që nuk përshtaten me veshjen islame dhe në ambjente të përziera femra me meshkuj.

Sulltanët osmanë, jashtë kohës së udhëheqjes së shtetit, janë marrë me fusha të ndryshme të artit. Shumica prej tyre kishin prirje për poezi, letërsi, kaligrafi dhe muzikë. Për shembull, **Sulltan Mehmed Ngadhënjyesi** kishte një interesim të veçantë për oborrin e tij, veçanërisht atij i vinte dora për unaza që vendoseshin në gishta në funksion të shigjetave, tokzat e rrypave dhe këllefeve të shpatave.

Sulltan Javuz Selimi kishte hobi argjendarinë.

Sulltan Mahmudi I ishte *hilalist*, *hakkak* dhe argjendar. Veprat e tij i shiste në çarshi dhe paranë e fituar e ndante si *sadaka*. Një ditë, kur veziri i tha:

-Madhëri! Thesari i popullit është thesari juaj. Përse mundoheni kaq shumë?

Sulltani i ktheu këtë përgjigje:

-Thesari i popullit duhet shpenzuar për popullin. Ka tjetër shije paraja që fitohet me djersën e ballit, nga puna e dytë.[1]

Sulltan Abdulhamidi II kishte interesim të veçantë për hipizmin, notin dhe atëxhëllëkun. Krahas aftësisë së tij mbi kakmanë dhe dekorimet, ai ishte edhe një mjeshtër i vërtetë si marangoz. Heraherës çlodhej duke punuar në punishten e tij. Sa e bukur është kjo ngjarje që lidhet me të:

Në vitin 1897 lufta mes turqve dhe grekëve përfundoi në favor të turqve. Mirëpo, gëzimin e Sulltan Abdulhamidit e eklipsonte një shqetësim. Sulltani i pati sjellë në Stamboll të gjithë të plagosurit e luftës. I pati vendosur në Spitalin Gymyshsuju, në Spitalin Etfal të sapopërfunduar në Shishli dhe në një ndërtesë ngjitur me Sarajin Jëlldëz, me qëllim që të vazhdonin kurimin. Gjendjen e pacientëve e ndiqte dita-ditës. Një ditë, sulltani i mëshirshëm shkoi në vendin e punës së tij të marangozit dhe i tha kështu Major Mehmed Efendiut:

-Eja, mjeshtër Mehmed! Preji njëqind e pesëdhjetë drunj bastuni!

Ndërkaq, majori habitet dhe i merakosur pyet:

-Fermani vjen nga zotëria ynë, por çfarë do të bëhen gjithë këta drunj bastuni, madhëri?

Sulltani, prej fytyrës së të cilit dukej ngazëllimi që i jepte vepra e mirë, ktheu këtë përgjigje:

-Pashë që shumica e ushtarëve kishin marrë plagë në këmbë. Edhe kur t'u përmirësohen plagët, do t'u nevojiten bastunë. Le t'u japim nga një bastun dhuratë, që ta marrin me vete në vendin e tyre, kur të dalin nga spitali.

1. Shih. Zeki Kusoglu, Dunku Sanatimiz ve Kulturumuz, Istanbul 1994. F. 26.



Rilindja ka nevojë për njerëz të rinj

Atasoj Myftiollu

Çdo lloj varësie, pasiviteti, nënshtrimi dhe skllavërie është pasojë e paaftësisë, frikës dhe mungesës së shpresës. Individët dhe shoqëritë që mjaftohen me gjendjen në të cilën ndodhen, që në mënyrë pasive u dorëzohen kushteve dhe që nuk kanë aftësinë e qasjes kritike ndaj realitetit, nuk mund të fitojnë lirinë e mendimit dhe nuk mund të krijojnë ide origjinale. Në një mjedis të tillë nuk mund të bëhet fjalë për ripërtëritje dhe prodhim intelektual. Individët dhe shoqëritë që nuk ndërgjegjësohen për përgjegjësitë, nuk e ndjejnë nevojën e ripërtëritjes dhe reformimit, nuk janë në gjendje të marrin asnjë iniciativë për të ecur përpara.

Shoqëria jonë nuk po ndërmerr asnjë veprim për përtëritje, nuk po vihet në gjurmim të gjetjes së mendimeve, ideve dhe njerëzve të rinj. Duke plotësuar njëra- tjetrën, fjala dhe veprimi marrin rrugën për të ecur përpara. Sot. një sërë parimesh dhe konceptesh islame, ngaqë nuk janë aktivizuar në zotërimin e veprimit, shprehin vetëm nostalgji dhe shpresë. Po kalojmë një periudhë ku parimet themelore universale të Islamit po përballen me një tradhti të madhe. Shfaqja më konkrete e kësaj tradhtie është neoliberalizmi, kapitalizmi, imperializmi, nacionalizmi dhe së fundi, Islami i moderuar. Kur integriteti, universaliteti dhe ymeti islam pëson dëmtim, ne nuk mund të shpëtojmë nga pushtimi i njohurive sekulare në mendje. Nëse mendja jonë pushtohet nga njohuritë sekulare, cila preferencë, sjellje, qëndrim dhe këndvështrim mund të reflektojë Islamin e vërtetë?

Shoqëritë islame nuk mund të çlirohen nga obsesionet e imituara koloniale. Për të shpëtuar nga këto obsesione, duhet që në rrafshin universal njohuritë islame të promovohen në histori, jetë dhe shoqëri. Kombet që imitojnë kulturat dhe kombet dominante nuk mund të krijojnë ide dhe mjedis intelektual. Sot gjendemi përballë ideologjive moderne, të cilat nuk pranojnë asnjë vlerë që nuk është perëndimore. Çdo gjë që ka lidhje me Islamin, menjëherë kategorizohet si e keqe. Myslimanët nuk po arrijnë të ngrenë zërin përballë thirrjeve denigruese, diskriminuese, reflektimeve skizofrene dhe përçartjeve paranojake. Myslimanët po ekspozohen gjithnjë e më shumë ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme, kjo më shumë për faktin se nuk po munden të prodhojnë vlera, nuk po munden të veprojnë dhe të aktivizohen në rrafshin e vetëdijes universale islame. Nuk po realizojnë dot shndërrimin e besimit dhe mendimit në vetëdije shoqërore e politike. Epoka pragmatiste e utilitariste në të cilën jetojmë, po e errëson mënyrën e jetës dhe marrëdhënieve tona. Preferencat politike dhe ekonomike po i nënvlerësojnë temat dhe problemet morale. Fatkeqësisht, shumë grupime islame, të cilat për të shtuar pasuritë, për të rritur numrin e anëtarëve të tyre dhe për përfitime politike janë të gatshëm të përdorin të gjitha dredhitë që ofron sistemi. Ideologjia dominuese sot kërkon ta zhveshë botëkuptimin islam nga interesimi për jetën në këtë botë, duke e nxitur atë të merret vetëm me çështjet metafizike.

Ngaqë tregojmë pavendosmëri për ringjalljen e vlerave tona vitale identifikuese, nuk arrijmë të depërtojmë murin ideologjik që na rrethon, por angazhohemi me polemika të shteruara, duke harruar atë që duhet bërë dhe duke mos folur për atë që duhet folur. Debatet e ndërtuara mbi polemikë arrijnë të ngjallin interes publik më shumë së një debat dobiprurës i mirëfilltë. Mungesa e autoriteteve kompetente për dhënien e gjykimeve fetare ka krijuar një zbrazëti, e cila mbushet nga interpretimet egoiste të individëve jokompetentë.

Në mungesë të vetëdijes kolektive nuk arrijmë të prodhojmë ide, mendime dhe plane, që mund të ndryshojnë rrjedhën e historisë. Historia tek ne gjen shprehje vetëm në fushën politike. Ngaqë nuk zotërojmë një vetëdije historike, proceset historike që përjetojmë i kalojmë pa përgjegjësi dhe interes të madh. Në këto kushte, bëhet shumë e vështirë për të kaluar nga Islami formal në Islamin aktiv.

Për të rihapur një epokë të re, duhet realizuar revolucioni i vetëdijes sonë. Për një epokë të re duhen njerëz të rinj. Përtëritja dhe rindërtimi i Islamit nuk mund të bëhet me metoda dhe mendësi të huaja. Për të rifituar vëmendjen historike, duhet një revolucion në ligjërim. Nuk mund të rifitohet vëmendja historike me përralla, me risi dhe ngjarje sensacionale. Interesimi ndaj Islamit nuk mund të kufizohet vetëm me ligjëratat dhe bisedat e përzemërta.

Është e domosdoshme që brezat e rinj të angazhohen në veprimtari kritike dhe ekzaminuese. Rinia duhet pajisur me guximin moral për të sfiduar çdo lloj monotonie dhe mediokriteti. Është i papranueshëm shndërrimi i rinisë në konsumatore pasive nga ana e grupacioneve nostalgjike e romantike. Brezi i ri duhet të përfitojë nga përvoja e të parëve, por nuk duhet në asnjë mënyrë të mjaftohet vetëm me përvojën e tyre. Ata duhet të japin ide, zgjidhje dhe përgjigje për problemet, nevojat dhe pritshmëritë e periudhës së tyre. Revolucioni i vetëdijes mund të realizohet vetëm me përpjekjet e rinisë.



Të qash PËR GJYNAHUN TËND

Salih Zeki Meriç

Më parë, ji përgjegjës për veten. Allahu, më parë do të të pyesë për veten tënde. Pyetjet që do fillojnë së bashku me jetën e varrit, janë: Kush është Zoti yt? Kush është Pejgamberi yt? Cila është feja jote?

Pyetjet do vijnë njëra pas tjetrës dhe do të pyetesh për frymën që merr, hapin që hedh, kafshatën që ha, vendin ku sheh, zërin që dëgjon, për të mirën dhe të keqen më të vogël që ke bërë. Çdo gjë do të të dalë përballë. Asgjë nuk është anashkaluar dhe asnjë detaj nuk është harruar. Çdo çast i yti është regjistruar. Çdo gjë është shkruar në librin e veprave. Të gjitha veprat e tua janë shkruar dhe "pse"-të janë përballë teje.

Ashtu siç ke jetuar, ashtu do t'u përgjigjesh edhe këtyre pyetjeve. Nëse e ke parë nga larg të Dërguarin e Allahut, nëse ke kaluar larg Islamit ose Islami nuk ka qenë kurrë aktualiteti i jetës tënde edhe përgjigja për besimin do të shkruhet "larg".

Nga duhet filluar pastrimi? Çfarë recete duhet të zbatojë njeriu, që t'i kthehet vetes? Si të shpëtojë nga të qenit shpëtues? Si të shpëtojë njeriu, i cili sillet sikur feja ka mbetur vetëm në dorë të tij dhe pandeh gjithmonë se është shpëtuesi, duke qarë hallin e të tjerëve, ndërkohë që ka harruar vetveten?

Për të dalë me shpirt të qetë përpara Zotit tënd, më parë duhet të fillosh nga vetja. Në vend që të shohësh gabimet e të tjerëve, duhet të shohësh të tuat dhe të qash hallin tënd. Më parë duhet të ndriçosh qoshet e errëta të botës tënde të brendshme dhe të ndezësh kandilat, që u janë vjetëruar fitilat dhe u ka mbaruar vaji.

Më parë duhet të pastrosh shpirtin, pastaj gjynahet dhe në fund zemrën.

Pastrimi duhet të bëhet me gjithë shpirt. Nëse pastrohet shpirti, gjithçka kthehet në një kopsht ku çelin njëmijë e një lule dhe dashuria fillon këngën e saj të ëmbël. Dhe, nëse kopshti i shpirtit tënd ngjyroset me ngjyrën e të Vërtetit, do të jesh prej të shpëtuarve.

Shpirti yt të jetë i tillë, që çdo gjallesë të gjejë vend aty. Kopshtet e shpirtit tënd të jenë të gjera si oqeane dhe të dëlira si lëndinat ku nuk gjen qoftë edhe një barishte grami. Shpirti është një vend shumë delikat dhe i brishtë. Prandaj, duhet pasur kujdes edhe ndaj atyre që futen edhe ndaj atyre që nxirren nga shpirti.

Për shembull, me kë je? Dashuria e kujt gjendet në shpirtin tënd? Nëse nuk e mban shpirtin të pastër, nuk mund të rregullosh as gjendjen tënde. Do të shohësh vëngër. Tekun e sheh çift dhe të drejtën të shtrembër. Qesh kur duhet qarë dhe qan kur duhet qeshur.

Pastaj zemra. Zemra është qendra jote. Allahu shikon zemrën. Edhe robërit shikojnë zemrën. Si të jetë zemra, ashtu je edhe ti. Qëllimi lind në zemër dhe po aty zhvillohet. Nëse shpirtin e ke të turbullt, edhe zemrën e ke të tillë. Nëse shpirti yt është i ngushtë, zemra jote s'mund të nxë dashuri të mëdha. Në vend që të gjykosh zemrën e të tjerëve, kthehu në zemrën tënde. Shiko brenda dhe pyet botën tënde të brendshme. Mendo si të ruash zemrën prej sëmundjeve, si armiqësia, urrejtja, smira, degjenerimi dhe mendjemadhësia.

Fillo e qaj për gjynahet e tua. Dhimbja e pendimit le të ngulet si gozhdë në zemrën tënde dhe përgjërimet le të ngrihen prej qosheve më të largëta të zemrës. Qaj, që i



Qaj në agim. Qaj në vetmi.
Qaj në takim me Zotin tënd.
Pastroje me të qarë ndërgjegjen tënde të papastër.
Loti është mëshirë. Loti pastron shpirtin,
rafinon zemrën dhe kthjellon qëllimin.

gjithë trupi yt të pastrohet. Qaj, që të gjitha gjynahet të bien. Papastërtinë e gjynahut mund ta pastrojnë vetëm lotët që dalin prej një pendimi të fortë.

Qaj në agim. Qaj në vetmi. Qaj në takim me Zotin tënd. Pastroje me të qarë ndërgjegjen tënde të papastër. Loti është mëshirë. Loti pastron shpirtin, rafinon zemrën dhe kthjellon qëllimin. Loti nuk del nga çdo njeri. Ka njerëz, që janë si tokë e djerrë. Ka njerëz, që janë si tokë pjellore. Kur njeriu derdh lot, nga toka e shpirtit të tij shpërthen mëshira.

Pastrimi i shpirtit bëhet në agim. Për t'u pastruar, njeriu duhet të ketë kujdes dy gjëra: e para, njerëzit me të cilët miqësohet dhe e dyta, gjërat që ha e pi...

Shikoji njëherë miqtë e tu! Çfarë ka në aktualitetin shpirtëror të këtyre njerëzve që i konsideron miq? Sa prej tyre të tërheqin prej ndjenjave të ulëta dhe të ngrenë në ndjenjat e larta? Për çfarë të nxisin me pavetëdije dhe për ku e orientojnë drejtimin tënd?

Kushti i parë i miqësisë, është të bëhesh mik me Allahun. Sa prej miqve të tu janë miq me Allahun? Sa prej tyre të çojnë tek Allahu?

Sa kujdes ke për ato që të kalojnë në fyt? Bukën, gjellën, ujin, çajin... Sa ndikon kriteri hallall-haram në ato që ha? Përveç kësaj, prej duarve të kujt janë përgatitur ato që ha? Me çfarë ndjenjash? Ato që ha, janë gjëra që ndikojnë menjëherë në karakterin dhe botën tënde shpirtërore. Sa i kujdesshëm dhe sa i ndjeshëm je ndaj tyre?

Pastrimi shpirtëror arrihet duke qëndruar me njerëz shpirtpastër. Arrihet duke marrë ushqim material dhe shpirtëror prej sofrës dhe qëndrimit me njerëzit shpirtpastër. Prej njerëzve që dashurojnë këtë botë, e cila është edhe qëllimi i jetës së tyre, nuk ke asnjë dobi përveç të mirave të përkohshme të kësaj bote. Atëherë, sot, kur gjërat janë ndërthurur me njëra-tjetrën, duhet ta rrisim ndjeshmërinë në nivelin më të lartë, për të ruajtur botën tonë shpirtërore dhe duhet të shoqërohemi me njerëz zemërbutë dhe delikatë, për të ruajtur butësinë e zemrës.

Gjynahet bien në zemrën e njeriut në formën e njollave të vogla. Kur njeriu bën një gjynah, në zemrën e tij formohet një njollë e zezë. Në botën e tij shpirtërore bie një pikë zift. Dhe kur njeriu bën çdo lloj gjynahu, zemra fillon e nxihet. Ndërsa nxirja e zemrës e ngurtëson atë. Dhe kjo reflektohet në shpirtin, veprat, fytyrën dhe gjendjen e njeriut.

Mendo se si të pastrohesh prej gjynaheve të tua. Nëse njeriu pastron vetveten, ndikon edhe tek të tjerët në të njëjtën mënyrë. Nëse shqetësohet për shpëtimin e vetes, edhe të tjerët shpëtojnë duke u kapur pas tij. Por, nëse harron veten dhe merret me shpëtimin e të tjerëve, nuk mund të shpëtojë as veten dhe as të tjerët.

Bota e brendshme duhet të jetë e fortë. Më shumë se fjalë, duhet vetëdije. Më shumë se fjalë, duhet vepër... Para së gjithash, njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për gjynahun e vet dhe të dijë se si të qajë për gjynahun e vet.

Në këtë botë çdo gjë është relative. Pozita, posti dhe gjendja materiale. Vlera jonë tek Allahu matet me devotshmërinë tonë. Ndërsa devotshmëria arrihet me pastrimin e zemrës, shpirtit dhe veprës.



"Ata që e lexojnë librin e Allahut... shpresojnë në një tregti që kurrë nuk humbet"

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Po meditoja në kuptimet e ajetit të "kurrave"[1] (lexuesve të Kuranit): "*Ata që e lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, shpresojnë në një tregti që kurrë nuk humbet...*"[2]

Natyrshëm, fillimi i këtij ajeti me leximin e Kuranit, që i paraprin namazit dhe shpenzimit në rrugën e Allahut, është sinjali më i mirë, që tërheq vëmendjen e njeriut drejt madhështisë dhe vlerës së angazhimit me Fjalën e Allahut, Kuranin, në jetën e tij.

Në hadithin e transmetuar nga Ibni Abbasi (r.a.), një person e pyeti të Dërguarin e Allahut se cila ishte vepra më e pëlqyer tek Allahu. Ai, ndër të tjera i tha: "*...Ta nisësh leximin e Kuranit nga fillimi. Sa herë që ta përfundosh, ta nisësh sërish nga fillimi*"[3], duke nxitur traditën e Hatmes Sherife (leximin e plotë të Kuranit në mënyrë të vazhdueshme).

Ndërsa në hadithin e transmetuar nga Enesi (r.a.), Resulullahi lajmëroi: "*Me të vërtetë Allahu ka të dashur e të përzgjedhur në mesin e njerëzve.*" E pyetën: "Kush janë ata, o i dërguar i Allahut?" Ai tha: "*Njerëzit e Kuranit janë të dashurit e Allahut dhe njerëzit e Tij të afërt!*"[4]

Dhe ndërkohë, leximet më morën për dore drejt një rrëfimi të pashembullt, në mesin e rrëfimeve që lartësojnë angazhimin me Kuran, leximin e tij, mësimin e tij dhe mbi të gjitha, përkthimin e tij në vepra konkrete në jetën e përditshme, në marrëdhënie me veten, me Zotin, me familjen, komunitetin e shoqërinë... Personazhi kryesor i këtij rrëfimi është një nga dijetarët më të shquar të Kuranit në mesin e shekullit të dytë hixhri, Hamza ibn Habib Zejjati, për të cilin mësuesi i tij, dijetari i shquar El-A'mesh (61-148), kur e shihte të vinte, thoshte: "Ky është dijetari i Kuranit".[5]

Rrëfen Kalef ibn Bezzar, nga mësuesi i tij Sulejm ibn Isa, nxënës i Hamza Zejjatit (v. 156 h.): "Hyra një ditë te Hamza ibn Habib Zejjati dhe e gjeta duke qarë, ndërkohë që ishte ulur në tokë, për të cilën fërkonte fytyrën e tij." Thashë: "Allahu të mbrojtë!".

Tha: "Dhe pse po e thua këtë? Mbrëmë pashë në ëndërr sikur ishte bërë kijameti dhe u thirrën 'kurraul-Kur'an' (mësuesit dhe lexuesit e Kuranit) dhe unë isha në mesin e tyre. Dëgjova një zë të ëmbël që tha: 'Mos të hyjnë tek Unë vetëm ata që kanë punuar me Kuran". Unë u tërhoqa duke bërë hapa prapa. Ndërkohë, ai thirri emrin tim: 'Ku është Hamza ibn Habib Zejjati?' Unë thashë: 'Lebbejke, o thirrës i Zotit!'

Një melek ndërhyu dhe më tha: Thuaj: "Lebejkallllahumme!", pra: "Si urdhëron, o Allah"... Dhe unë thashë: 'Lebejke', ashtu si më tha.

Pastaj më futi në një vend, ku dëgjohej gumëzhitja e leximit të Kuranit, ndërsa unë dridhesha i tërë. Dëgjova një zë që më tha: "Mos u shqetëso, ngjit shkallët dhe lexo!"

Solla kokën, kur pashë një minber me smeralde të

1. Shejkh Abdull-llah Siraxhuddin, "Et-Tekarrubu ilall-llahi teala", botimi I, Damask, 1991, fq. 73.

2. Kur'ani, Fatir: 29.

3. Transmetuar nga Imam Tirmidhiu.

4. Transmetuar nga Nesaiu, Ibni Maxheh dhe El-Hakim, sikurse edhe Imam Ahmedi në "El-Musned".

5. Ibnul-Xheuzi, "Sifetu-safve", vëll. III, fq. 156.



bardha, me krahë prej gurësh të çmuar të verdhë dhe shkallat prej diamantësh ngjyrë jeshilë...

Më tha: "Ngjitu dhe lexo!" U ngjita. Tha: "Lexo suren "El-En'am", ndërkohë që nuk dija se kujt po i lexoja. Pasi lexova 60 ajetet e para dhe mbërrita te ajeti: "Ve huvel-Kahiru feuka ibadihi (61)"[6], më tha: "O Hamza, a nuk Jam Unë Mbizotëruesi mbi krijesat e Mia?" I Thashë: Po, je! Tha: "E vërtetë. Vazhdo leximin" Dhe vazhdova derisa e plotësova këtë sure. Më tha: "Lexo", dhe unë nisa të lexoj suren "El-A'rafë". Kur mbërrita në fund të saj desha të bie në sexhde. Ai më tha: "Mjafton e kaluara (pra, në ahiret nuk ka më obligime), mos bjer në sexhde, o Hamza".

Pastaj më pyeti: "Kush ta ka mësuar ty këtë lexim?" I thashë: 'Sulejmani (d.m.th: El-A'mesh)'. Tha: "E vërtetë. Po Sulejmanit, kush ia mësoi leximin?" Thashë: "Jahja" Tha: "E vërtetë. Po Jahja, te kush ka lexuar?" Thashë: 'Te Ebu Abdurrahman Es-Sulemi'. Tha: "Të vërtetën ka thënë Ebu Abdurrahman Sulemiu. Po Ebu Abdurrahman Sulemiun, kush e mësoi?" Thashë: 'Djali i axhës i Profetit tënd, Aliu.' Tha: "Të vërtetën tha Aliu. Po Aliun kush e mësoi?" Thashë: 'Profeti Yt, Muhamedi (a.s). Tha: "Po kush e mësoi Profetin Tim?" Thashë: 'Xhebraili (a.s.). Tha: "Po Xhebrailin kush e mësoi?" Unë heshta.

Tha: "O Hamza, thuaj: ***Ti***". Thashë: Nuk mund ta them (nga madhështia dhe turpi). Tha: "Thuaje o Hamza: ***Ti***" Unë e thashë: '***Ti***...'

Tha: "Të vërtetën the, o Hamza. ***Pasha hakun e Kuranit, do t'i nderoj "ehlul-Kur'an", (njerëzit e Kuranit, të angazhuarit me të) veçanërisht ata që punojnë me Kuran***! O Hamza, ***Kurani është Fjala Ime dhe Unë nuk dua njeri si "ehlul-Kur'an"***!

Pastaj më tha: "Afrohu o Hamza" U afrova, më leu me një erë të mirë dhe më tha: "***Nuk po ta bëj vetëm ty këtë, por ua kam bërë edhe shokëve të tu, më lart e më poshtë teje. Dhe kujtdo që do t'ua mësojë njerëzve Kuranin, sikurse ke bërë edhe ti, me sinqeritet vetëm për hatrin Tim!*** Ndërsa ajo që kam rezervuar për ty, o Hamza, është shumë më e madhe! ***Thuaju edhe shokëve të tu për Dashninë Time ndaj "ehlul-Kur'an"*** dhe shpërblimin Tim për ty. ***Ata janë të përzgjedhurit më të mirë! Pasha Krenarinë dhe Madhështinë Time, nuk do ta ndëshkoj me zjarr një gjuhë që e ka lexuar Kuranin! As zemrën që e ka kuptuar! As veshin që e ka dëgjuar, as syrin që e ka vështruar!***"

Thashë: 'Subhaneke, subhaneke ja Rabbi!' Tha: "O Hamza, ku janë ata që vështrojnë në Kuran gjatë leximit?" Thashë: 'Ja rabbi, hafizët?' Tha: "Jo, atyre ua kam ruajtur shpërblimin për Ditën e Gjykimit, një shkallë për çdo ajet".

Pastaj, Hamzai iu drejtua nxënësit të tij Sulejmit: "Po tani, a po më kritikon se po qaj dhe po e fërkoj fytyrën për dhé?"[7]

Më pas, autori i librit (Imam Ibnul-Xheuzi) vijon: "Thotë Ebu Mus'hil: 'E pashë Kisaiun[8] (*imamin e famshëm të leximit të Kuranit*) në ëndërr, e kishte fytyrën si hëna e plotë. E pyeta: 'Çfarë bëri Zoti me ty?' Tha: 'Më fali për hatër të Kuranit. Po me Hamza Zejjatin?' Tha: 'Ai është në *il-lijjine*, nuk e shohim, vetëm siç shihet ylli që ndriçon".

I kënaqur nga ky rrëfim dhe i bindur në saktësinë e këtij shpërblimi, iu riktheva ajetit të lartpërmendur: ***"Ata që e lexojnë librin e Allahut... shpresojnë në një tregti që kurrë nuk humbet"***[9] Dhe vërtet, ata që angazhohen me Kuran, shpresojnë në një tregti, që kurrë nuk humbet... Sepse, në hadithin e transmetuar nga Ebu Said Khudriu, Resulullahi (a.s.), na tregon se Zoti i gjithësisë ka thënë: "***Ai që angazhohet me Kuranin, ka epërsi në shpërblim ndaj atij që më lutet Mua***..."[10]

Shkodër, 3 gusht, 2013
26 Ramazan 1434

6. Kuptimi në shqip i këtij ajeti, përafërsisht: "*Dhe Ai është Mbizotëru - si ndaj robërve të Vet*".

7. Ibnul-Xheuzi (510-597), "Sifetu-safve", vëll. III, fq. 156-159.
8. Imam Kisaiu, 119-189 h.
9. Kur'ani, Fatir: 29.
10. Transmetuar nga Imam Tirmidhiu.



Çtë mbjellësh do të korrësh

Filiz Konxha

Të dashurit e Allahut Teala, në veprat e tyre të irshadit, tregojnë një shembull konkret, që nxjerr në pah pasojat e padrejtësisë dhe tiranisë:

Një ditë, Musai, alejhi's-selam, tha:

"O Zot! Disa njerëz pandehin se ajo që bëjnë të padrejtët, do të ngelet pa u ndëshkuar. Por drejtësia Jote, herët a vonë, realizohet. Në këtë mënyrë, i padrejti e merr ndëshkimin e padrejtësisë që ka bërë. O Zot, më trego një shembull të drejtësisë Tënde që t'ua tregoj njerëzve, në mënyrë që askush të mos ketë guxim të bëjë tirani dhe padrejtësi dhe që të gjithë ta kuptojnë se padrejtësia do ta marrë ndëshkimin që meriton, herët a vonë! Zoti i Madhëruar i tha:

"O Musa! Fshihu në korije, ku kryqëzohen katër rrugët në sahara dhe shikoji ngjarjet që do të ndodhin në krye të burimit. Kështu, do të shohësh se si e merr ndëshkimin e padrejtësisë ai që e ka bërë atë..."

Musai, alejhi's-selam, u fsheh në mes të pemëve në vendin që u urdhërua dhe filloi të shikonte ngjarjet që përjetonin udhëtarët në krye të burimit përballë tij.

Në krye të burimit erdhi një kalorës. Zbriti nga kali, mori torbën me florinj, u ul në hije të pemës, hëngri ushqimin, piu ujë dhe u largua prej aty duke harruar torbën me florinj.

Udhëtari i dytë që erdhi pas tij, piu ujë nga burimi

dhe vështroi rreth e rrotull. Befasisht pa një torbë rrëzë pemës. E mori torbën dhe u largua menjëherë. Pas tij erdhi udhëtari i tretë, i cili ishte i verbër. Ai u përkul dhe piu ujë nga burimi. Ndërkohë që ishte ulur në një qoshe dhe po pushonte, erdhi i zoti i torbës me kalë. Ai filloi ta kërkonte torbën i zemëruar. Meqë nuk pa asnjë njeri tjetër përveç të moshuarit, i tha:

-Ti e ke marrë torbën që e kam harruar këtu dhe e ke fshehur. Më jep paratë, përndryshe do të ta marr shpirtin!..

I moshuari ia ktheu me të nxehur:

-Unë jam i verbër. Ku ta di unë se ku është torba jote! Kalorësi u zemërua shumë dhe e vrau të moshuarin me një të goditur, duke i thënë: "Mua do të më mashtrosh ti, në këtë moshë?" Pastaj i hipi kalit dhe u largua.

Musai, alejhi's-selam, i pa këto dhe tha:

-O Zot! Torbën plot para të kalorësit e mori një udhëtar i ri dhe iku, ndërsa ndëshkimin për të e hoqi i moshuari që erdhi pas tij. Cila është urtësia e kësaj?.. Allahu i Madhëruar iu përgjigj:

-O Musa! Ja, kështu janë njerëzit. Gjithmonë shohin anën e jashtme të ngjarjeve. Në këtë mënyrë, shpeshherë nuk e shohin drejtësinë e kaderit brenda tyre. Këtu të gjithë e morën shpërblimin e asaj që patën bërë në të kaluarën. Pastaj ia shpjegoi kështu të kaluarën:

"Kalorësi që e harroi në krye të burimit torbën me para, nuk ia pati dhënë hakun një burri të varfër, që dikur punonte për të. Haku i burrit të varfër ngeli te ai...

Ja pra, udhëtari i ri që mori torbën dhe u largua, ishte fëmija i atij burrit të varfër. Paratë që mori ishin haku i babait të tij. I mori ato dhe iku. Në këtë mënyrë, drejtësia e kaderit gjeti vendin e saj. Ai mori hakun e babait dhe u largua. Ndërsa i moshuari që u vra, ishte njeri shumë i padrejtë.

Ai pati bërë shumë padrejtësi dhe asnjëherë nuk pagoi për to. Më së fundi, pati vrarë babanë e kalorësit dhe pati pandehur se nuk do të paguante për këtë. Së fundi, erdhi kalorësi dhe e vrau atë me një të goditur, duke pandehur se i kishte marrë paratë. E vrau atë me një të goditur, siç e pati vrarë ai babanë e tij.

Pastaj Allahu Teala i tha Musait, alejhi's-selam:

-O Musa! Thuaju robërve të Mi të mos i shikojnë me kundërshtim ngjarjet, të cilave nuk ua dinë urtësinë. Le ta dinë se ai që bën diçka të padrejtë, do ta paguajë atë. Padrejtësia që mund të bëjë dikush, nuk ngelet pa paguar. Drejtësia e kaderit do të triumfojë herët apo vonë. Siç e pagoi me një torbë florinj kalorësi hakun e punëtorit që punoi për të apo siç e vrau me një të goditur atë që i vrau babanë... Për këtë arsye, të mëdhenjtë tanë kanë thënë:

"Allahu Teala e merr hakun e një robi me një rob tjetër. Njeriu i shkujdesur pandeh se e bëri robi vetë."

Po, asnjë të mos pandehë se nuk do të paguajë për atë që ka bërë, sepse Allahu, i cili është i drejtë absolut, jep kohë, por kurrë nuk neglizhon. Befasisht shohim se i padrejti e ka paguar dëmin e padrejtësisë së tij në një çast të papritur. Por njerëzit nganjëherë nuk e kuptojnë se ky ndëshkim është kundërvlera e padrejtësisë që bën i padrejti dhe pandehin se ajo ngelet pa ndëshkim.

Le të mendojmë kështu:

Sa e vështirë do të jetë gjendja e atyre që bëjnë padrejtësi në masë, që përpiqen t'i bëjnë njerëzit ta shesin fenë për këtë botë siç veprojnë edhe vetë, që përpiqen të luftojnë me Allahun dhe dispozitat e Tij, që përpiqen të nxjerrin shpifje për librin e Allahut dhe nuk e zbatojnë atë, që përpiqen të shtypin të vërtetën dhe të drejtat e të tjerëve, që thonë se parimet e tyre janë të vlefshme dhe jo ato të Allahut Teala, që përpiqen t'i fusin njerëzit në xhehnem grupe-grupe dhe jo në xhenet dhe që përpiqen t'ua nxijnë të ardhmen shoqërive?



E VËRTETA IME!

Ma. Luan Afmataj

Dikur kam menduar se vetëm unë kam të drejtë dhe se vetëm në mua gjendet e **VËRTETA**. Kam menduar se të tjerët, ata që janë ndryshe nga unë gabojnë dhe ajo ç'ka thonë nuk është në pajtueshmëri me timen dhe në shumë raste është e pavërtetë! Dhe sot... akoma mendoj që unë kam të drejtë, që unë e di të vërtetën, por këtë aftësi të të menduarit e gjeta në diversitetin e të tjerëve. Çfarë krijimi madhështor...! 7 miliard e 500 milion të vërteta si kjo e imja! Dhe më e çuditshmja, secila më e vërtetë se tjetra! Si është e mundur në një numër kaq të madh të të krijuarish në secilin prej tyre të ekzistojë një dallim unik nga tjetri!

Dëshira për t'ia detyruar apo imponuar tjetrit me çdo mënyrë atë ç'ka ne e konsiderojmë të vërtetë ose të shenjtë është pikërisht në thelbin e garimit tonë si qenie njerëzore. Mundohemi me çdo kusht që çdokush të përvetësojë të vërtetën tonë, të mendojë si ne, të bëhet "ne". Dëshira jonë e vetme është të paraqesim një botë, e cila transmetohet vetëm nëpërmjet ekranit tonë e për këtë arsye vazhdojmë t'ua imponojmë të tjerëve gabimet e insistimit tonë. Jo se nuk kemi të drejtë, por problemi është se metodat që kemi zgjedhur shpeshherë na largojnë nga ky realitet. Padyshim se në fund të kësaj beteje në mes të vërtetave do të fitojë vetëm e vërteta! Dhe kjo e vërtetë është se ne jemi të ndryshëm. Kur të arrijmë ta kuptojmë këtë ndryshim, atëherë do të njohim më mirë "tjetrin" dhe do të dimë më shumë mbi rrugët për ta ftuar atë në të drejtën/vërtetën tonë universale, për të cilën mundohemi kaq shumë. Shkaku i të qenit i krijuar në raca e popuj të ndryshëm, paska qenë për t'u njohur në mes njëri-tjetrit, për të njohur tjetrin, mbase thellë- thellë për të njohur vetveten. I madhi Zot paska dashur që nëpërmjet tjetrit të njohim vetveten, sepse pa njohur tjetrin nuk mund të kuptojmë vetveten. Ose, nëse mund ta themi ndryshe: Pa "ti" nuk mund të ketë "unë". Në fund të fundit, kujt do t'ia tregoja "unin", nëse nuk do të ishe "ti"!

Jemi pjesë e një të tëre. Secila pjesë ndihmon në formimin e tjetrës. Ata që na duan e na rrethojnë, ata që na mbështesin në hapat e jetës e të ideve, ata që janë indiferentë ndaj këshillave tona, ata që na urrejnë e madje edhe ata që na luftojnë, së bashku plotësojnë një pjesë tonën dhe na bëjnë të ndihemi dhe të kuptojmë në të vërtetë se cilët jemi ne. Ata që janë në krahun tonë na japin forcë dhe na motivojnë të ndihemi më të aftë dhe më aktivë në hapat tonë, kurse ata që janë përballë nesh dhe që ne i cilësojmë si kundërshtarët tanë, na ofrojnë mundësinë të kuptojmë se sa lart jemi ne ndaj tyre dhe se sa falënderues duhet të jemi ndaj Atij që na e ka mundësuar këtë gradë të lartë. Përse gjithmonë për të kuptuar nimetet (të mirat dhe begatitë) që të janë dhënë, të është dashur të harrosh ose të jesh larg atij realiteti! Përse gjithmonë për të kuptuar se sa fatlum je, të është dashur të shikosh përballë një "fatkeq" (dikë që nuk e ka atë çka ti e ke)? Kjo gjë shpesh të shpie të mendosh se edhe ti dikur ishe një "fatkeq". Herë- herë të shpie të mendosh edhe se sa "fatkeq" që je, përderisa i gjendur në mirësinë e të qenit "i zgjedhur", nuk kupton të mirat në të cilat gjendesh. Atëherë ti, o "uni" im... filloje me vetveten. Mësimet e para si ta ftosh një tjetër në të vërtetën tënde, nxirri nga vetja jote. Dhe në fund, mos harro se "*Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin që të gjithë sa janë në tokë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?*" (Junus, 99)

Dikur kanë jetuar njerëz si ne me trup e shpirt, por

me virtyte të larta si engjëjt. Quheshin pejgamberë, për shkak të mesazhit të fuqishëm që sillnin për t'u rikujtuar njerëzve shkakun e krijimit dhe misionin e tyre hyjnor, që ishte harruar në rrjedhën e kohës. Këta pejgamberë, përveç angazhimit të tyre kryesor në zbatimin dhe përcjelljen e mesazhit me të cilin ishin ngarkuar tek të tjerët, shpeshherë ndërmjetësonin tek Allahu i Lartësuar edhe për zullumqarët jobesimtarë, me shpresë se do të pendoheshin një ditë. Nuk e di nëse dikush prej nesh ka menduar ndonjëherë sikur të ishte profet, por mendoj se është pozicioni më i lartë i të qenit njeri dhe, nëse sot "njeriu kryelartë" në natyrën e tij, do të kërkonte të vetmin shembull për ta imituar në botë, ai shembull do të ishte figura e një profeti. Këta njerëz të zgjedhur (profetë), i luteshin Zotit të mos i dënonte popujt e tyre deri në minutat e fundit. Sepse misioni i tyre ishte për të shpëtuar njerëzit dhe jo për të shpëtuar prej tyre. Nuhu (a.s.), u mundua t'i "gënjente" melekët e Zotit kur shkuan për t'ia dënuar popullin e tij, me pretekstin se në mesin e tyre gjendeshin edhe shumë besimtarë. Kur i thanë sa besimtarë kishte, filloi të kërkonte në mes njerëzve dhe nuk gjeti as sa një grusht (as edhe një familje) prej atyre që i besonin, pas një daveti (thirrjeje) 950 vjeçare. Ibrahimi (a.s.), debatoi me melekët e dërguar për të shkatërruar popullin e Lutit (a.s.), aq shumë, saqë melekët i thanë: "Mjaft më, o Ibrahim, sepse dënimi i tyre tashmë është shkruar." Luti (a.s.), u doli kundër melekëve, duke iu lutur të mos ia dënonin popullin e tij, derisa u bind se në mesin e njerëzve nuk ekzistonte as edhe një burrë i vërtetë. Muhamedi (a.s.), në Taif, kur të gjithë ia kthyen shpinën dhe e goditën me gurë tha: "O Zot im, të kërkoj falje për dobësinë time në zbatimin e mesazhit Tënd...fali, se ata nuk dinë çfarë po bëjnë!" e sa e sa shembuj të tjerë që na i shpjegon Kurani Famëlartë.

Në këtë pikë, ia vlen të rikujtojmë pozicionin tonë, pozicionin e të marrurit shembull të një profeti, pozicionin e të qenit pasues i një profeti ose, thënë ndryshe, i të qenit një "i zgjedhur" i Zotit në ditët e sotme! Kur të tjerët ua kthejnë shpinën këshillave tona; kur të tjerët nuk pranojnë të vërtetën tonë; kur na ofendojnë atë më të shenjtën, ne reagojmë menjëherë, shpeshherë edhe duke thyer çdo normë morale e njerëzore. Reagojmë, sepse ai ofendim na vret, por harrojmë se kjo nuk është ajo për të cilën jemi urdhëruar. Misioni ynë obligues mbaron aty ku fillon kufiri i tjetrit. Pastaj na takon të presim dhe të shpresojmë që ky mision i yni të ketë arritur një rezultat të mirë. A nuk thoshte Kurani: *"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin që të gjithë sa janë në tokë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?"* (Junus, 99). Në këto raste nuk duhet të mendohet heshtja si zgjidhje (edhe pse heshtja nganjëherë është përgjigjja më e fortë), por domosdoshmëria e zbulimit të kapaciteteve, mundësive dhe karakterit të lartë të një njeriu shembull (besimtari), i cili di t'i përgjigjet dhunës me durim e heshtje dhe heshtjes me drejtësi.

Më herët, njerëzit ndaheshin në popuj e ymete. Kishte një Zot, një fe dhe të tjerët. Kishte "ne" dhe të "tjerët". Këta njerëz kishin ideale të qarta, kishin moral, burrëri e besë. Për t'i arritur ato ideale për ata ishte e thjeshtë; nëse ishte nevoja mjaftoheshin me sakrifikimin e asaj më të lehtës, me jetën e tyre, e mu për këtë përmenden akoma në ditët e sotme. Njerëz me ideale... Sa çuditshëm tingullon kjo shprehje në veshin tonë! A nuk jemi ne që në shekullin e 21-të kemi zgjedhur si ideale kapitalizimin e njeriut, pasurimin me çdo formë e mënyrë, shfrytëzimin e tjetrit në emër të të drejtave dhe lirisë së njeriut, shkatërrimin në masë të natyrës në të cilën jetojmë, përhapjen e dhunës, konflikteve, luftërave dhe mbi të gjitha, atë më të rëndin dhe më shkatërruesin, atë që vret më shumë se çdo armë dhe shkatërron më shumë se çdo luftë, indiferentizmin përballë tjetrit ose më mirë të themi, konsiderimin e tjetrit si "hiç". Akoma nuk e kemi kuptuar se nuk janë pasuria dhe pushteti, ato që esenca jonë kërkon. Nuk është thelbi i krijimit tonë të kesh e të kesh... Ajo që na duhet dhe që është jetësore për ne, është thjesht të jemi të pranueshëm nga të tjerët. Akoma jemi në pritje të asaj dite, kur do të bindemi se pasuria më e madhe për njeriun paska qenë të jetë i vlerësuar dhe i pranuar nga të tjerët".

Ndërsa sot..., ndodhemi brenda pazarit të pafund të diversiteteve, të cilat "stolisen" me kultura, raca, ngjyra, besime e mosbesime nga më të ndryshmet. Nga pamundësia për të dalë nga ky pazar i globalizimit botëror, na duhet të bëhemi pjesë e tij: të blejmë dhe të shesim. E çfarë mund të bëhet tjetër në një pazar! Ajo që i nevojitet një tregtari të mirë është të dijë çfarë t'u shesë të tjerëve dhe ajo ç'ka i nevojitet një klienti të mirë është të dijë se çfarë të blejë. Në këtë "allishverish" të pashmangshëm ndërkulturor apo ndërfetar ekziston mundësia e ekspozimit të vlerave zotëruese ose më mirë të themi, ekziston mundësia për të ekspozuar ato vlera, për të cilat pretendojmë se i kemi, por në të njëjtën kohë ekziston edhe rreziku i paaftësisë për t'i mbrojtur këto vlera dhe përqafimi i ideve të ndryshme, të cilat të dërgojnë larg vlerave të tua. Në këtë rast, kërkohet një furnizim personal i dyfishtë; së pari një studim i thelluar dhe përvetësim i vlerave dhe mesazhit që ti dëshiron të përcjellësh, i cili të aktivizon në vetëbesimin për t'u ekspozuar, dhe së dyti, njohja në mjaftueshmëri e produktit të ofruar nga rivali yt ose nga ai që ne e thërrasim "tjetri". Vetëm atëherë kur ta njoh mirë pazarin, do të mund të jem i suksesshëm në tregtinë time; vetëm atëherë kur do t'i njoh të tjerët, do të jem unë ai, që ka të drejtë dhe vetëm atëherë të tjerët do të pranojnë se vetëm në mua gjendet e **VËRTETA**!

Xhemal Nar



Të jetosh është një çështje shumë e rëndësishme. Ne e dimë se jeta së cilës i japim kaq shumë vlerë dhe mund e djersë, vjen një çast dhe merret prej nesh pa asnjë lloj diskutimi. Kësaj jemi të detyruar t'i themi po, sepse, nëse i themi jo, përsëri asgjë nuk do të ndryshojë.

Vallë, a bëhet mjaftueshëm llogaria e kësaj? A e llogarit njeriu këtë?

Njeriu në përgjithësi ikën nga kjo. Vallë, nëse në emër të jetës nuk ikën dhe e bën këtë llogari, çfarë do të ndryshonte?

Edhe nëse nuk e bëjnë llogarinë, ditën kur njerëzit ndahen nga kjo botë, duan të lënë një emër dhe një kujtim të mirë. Vallë, a thua punojnë për ta realizuar këtë dëshirë?

Kur njeriu do diçka, duhet natyrshëm të bëjë atë që është e nevojshme. A është e mundur të duash dhe të mos bësh atë që duhet? Le të pyesim veten tonë. Le të shohim rreth e rrotull. Çfarë shikojmë? Cila është bindja që kjo pamje lë te ne?

Veçanërisht shekulli ynë, është një shekull që e përshpejton jetën tonë. Le të themi se kemi një jetë njëqindvjeçare. Sikur kjo të jetohej para pesë shekujsh, mund të dukej si një mijë vjet. Mendoni, çfarë ndryshimi ka një qerre qesh me një taksi të tipit të fundit në shpejtësi? Ja pra, sot shkojmë me makinë në vendin ku shkonin me qerre. Menjëherë e arrijmë qëllimin dhe puna mbaron. Kur të mbarojë puna, mbaron edhe jeta sigurisht.

Jeta gjithmonë ia vlen të jetohet. Mirësitë e Allahut Teala nuk mund të numërohen. Ndoshta dhjetë shekuj më parë natyra ishte më e bukur dhe më e gjallë. Njerëzit e asaj kohe ishin të kënaqur nga jeta. Dhe kur i vinte vdekja, në ndërgjegjen e tyre ishte projektuar një llogari.

Po ne kur të vdesim, a do të bëhemi pishman për ato që kemi jetuar?

Për shembull:

Shekulli ynë është i shpejtë dhe nuk të lejon të sjellësh në mend pyetje të tilla. Ne pandehim se në këtë shekull nuk kemi kohë të mendojmë. Por, a nuk duhet të ndalojmë për të menduar?

Jetën, të cilën e kemi amanet, sigurisht që e bëjnë të vlefshme ndjenjat, në mënyrë që të mos bëhemi pishman për ato që kemi jetuar kur të vdesim. Domethënë, të ndahemi me nder nga kjo botë. Këtu mendoj se të gjithë janë dakord. Problemi qëndron në arritjen e suksesit në këtë çështje.



A e di njeriu mënyrën e arritjes së suksesit në këtë çështje?

T'i thuash kësaj "jo", është një mosmirënjohje e madhe, do të thotë të injorosh gjithë ata pejgamberë, dijetarë dhe evlija. Më e keqja, kjo është mospërfillje ndaj Zotit, që na ka dhënë jetën si amanet dhe ndaj librave të shenjtë që na ka dërguar. Do të thotë injorim i vetes sonë, i zemrës, i ndërgjegjes dhe i shpirtit tonë. A mund ta pranojë njeriu këtë qëndrim brutal?

Nëse jo, rruga dhe udhëzimi është i qartë. Le të ngrihemi sot nga krevati, të çohemi në këmbë, ta përshëndesim familjen si një njeri shembullor, apo si njeriu i parë, apo si Pejgamberi i fundit dhe t'i përshtatim me shpalljen hyjnore, për hir të Allahut Teala, punën, ushqimin, shokët dhe të gjitha aktivitetet e jetës që na janë dhuruar nga asgjëja dhe që një ditë do na merren patjetër. Në këtë dukuri sublime, nuk ka dyshim, kështu që ta bëjmë të vlefshme një ditë tonën. Nëse na pëlqen, le të vazhdojmë...

Sidoqoftë, përballë kemi vdekjen që do të vijë. Ndoshta sot, ndoshta nesër. Ardhja e vdekjes është e caktuar dhe nuk mund të iket prej saj. Ne e kemi në dorë që ta lehtësojmë, ta bëjmë të bukur dhe të shkojmë pa u bërë pishman. Faktikisht kjo, në të njëjtën kohë është edhe shndërrimi i jetës së përkohshme në të përhershme.

Përse nuk i themi dot "po" kësaj? Edhe pse e dimë se, nëse nuk i themi "po", do të bëhemi shumë pishman dhe do të përjetojmë vuajtje kur ta lëmë këtë jetë, por edhe në jetën e pastajme. Atëherë, përse nuk mund t'i themi "po"?

Sot, si të gjithë njerëzit, edhe myslimanët janë të hutuar. Përse?

Shkaku i kësaj është shumë i thjeshtë. Ky hutim buron nga mungesa e përjetimit të fesë në jetën tonë.

Pjesërisht mund t'i kuptojmë mohuesit e fesë. Përpara tyre ndodhet një grumbull me justifikime, propozime dhe teori. Por kjo nuk ia heq jetës së tyre aktin e përgjegjësisë para Krijuesit. Përse nuk mendojnë se çfarë i ka shkaktuar jetës mundësia e praktikimit në kaos të mijëra teorive? Përse nuk marrin mësim prej dështimeve dhe sukseseve? Nga feudalizmi në fashizëm, nga kapitalizmi në komunizëm, ndërsa tani, pak nga kjo e pak nga ajo, përse nuk mendojnë për shkakun e pendimit të njeriut, kur vdes dhe ndahet nga kjo jetë?

Po! Njeriu ka nevojë për një shpëtimtar, kjo është e qartë. Por duhet të jemi të ndërgjegjshëm. A nuk është i qartë shpëtimtari?

TËHUAJËSIMI
ASPEKTI ETIK DHE ESTETIK

Edison Çeraj

Në lidhje me fjalën *tëhuajësim*, për ata që mund të mos e kenë të qartë, fillimisht dua të bëj një sqarim paraprak. Siç e vëmë re edhe nga ana gjuhësore, te kjo fjalë e përbërë, kemi fjalën *i/e huaj*, gjë që na jep sinjalin e parë për ta dekoduar. E thënë përmbledhtazi, tëhuajësimi është një lloj denatyrimi i njerëzores përbrenda individit (që lidhet me aspektin etik), pra një lloj rënieje e njeriut. Ndërsa më konkretisht këtu, me tëhuajësim kuptojmë tjetërsimin tonë në marrëdhënie me veten, me tjetrin dhe me rrethanat. Pra, fjala është për përmasën e fetarisë, e cila duket qartë që është cenuar ose është tkurrur.

Në pjesën më të madhe të të ashtuquajturave veprimtari fetare vëmë re një lloj zhurmnaje vërtet shqetësuese, pjesët përbërëse të së cilës, të mbledhura bashkë, përbëjnë as më shumë e as më pak sesa një spektakël që sa vjen e po masivizohet, duke iu bashkëngjitur kështu shoqërisë që na rrethon, shumicës pra, për të cilën kemi harruar se janë të përhumbur, siç lexojmë në Kuran; ajo shumicë që Guy Debord e quan "shoqëria e spektaklit", ku në njëfarë mënyre forma është përmbajtje. Muzikë, aktrim, performancë, njësim gjinish, surpriza e kështu me radhë. Ku është përmasa e domosdoshme religjioze këtu? Çfarë bëhet me të, kur po jepemi kaq shpesh pas aktivitetesh të kësisojta? Ku është thjeshtësia, përmbajtja, serioziteti dhe maturia?

Abdesi po vjen duke u reduktuar vetëm në higjienë. Kurse namazi vetëm në një barrë që duhet hequr, ngaqë jemi shumë të zënë; ose vetëm në ndoca lëvizje gjimnastikore që shërbejnë si shajni për të ledhatuar kompleksin e palestrave që u japin formë trupave të dorëzuar me qira. Pa folur pastaj për muajin e ramazanit, që sa vjen shndërrohet në një mbrëmje të stërzgjatur gala, duke plagosur rëndë përshpirtshmërinë dhe të qenurit të përmbajtur, që është thelbi i agjërimit.

Shkoj me bindjen se shqetësimi më i madh në këtë rast është: problemi nuk qëndron te gjynahet që bëjmë, por te dhënia me kaq pasion pas gjërave të lejuara, gjë që përbën një hedonizëm *sui generis* – të llojit të vet. Dhe për pasojë, ky është hapi i parë për të davaritur dallimin midis të lejuarës dhe të ndaluarës.

Tani dua të përqendrohem te një nga shkaqet kryesore që ka shkaktuar të tilla dukuri si ato që preka më lart, që është **ndikimi**, fakti që jemi ndikuar aq sa "nuk mban më kosi ujë", për t'u shprehur përmes një narrative popullore. Duhet ta kujtojmë më shpesh thënien e njohur të Profetit: "*Kush i përngjan një populli, ai është pjesë e tij.*" Fatkeqësisht, ky hadhith është interpretuar përgjithësisht vetëm nga ana formale, ajo më pak e rëndësishmja, duke e reduktuar çështjen vetëm te veshja, stili i qethjes e të tjera kësodore, duke lënë mënjanë kësisoj thelbin: ndikimin nga ana botëkuptimore, që i jep formë më pas mënyrës sonë të jetesës, sepse çdokush është peng i botëkuptimit të tij, ose i mungesës së një botëkuptimi të caktuar, duhet të ketë edhe kështu.


Pra, mendoj se i kemi kaluar kufijtë për sa i takon ndikimit. Me pak fjalë, e kemi tepruar, dhe çdo teprim ka pasoja të rënda, aq më tepër kur bëhet fjalë për çështje botëkuptimore!

Ajo për të cilën duhet të vetëdijesohemi sa më shumë, është se duhet ta njohim mirë *background*-in botëkuptimor apo filozofik që qëndron pas mënyrës së jetesës në kushtet e një bote të ashtuquajtur moderne, e cila u ngjiz në Rilindjen Europiane dhe evoluoi kohë pas kohe deri në ditët tona. E thënë troç, në Rilindje u synua rrënimi i botës me Zotin në qendër dhe ndër-

timi i një bote me individin në qendër, që vazhdon të ndërtohet edhe sot e kësaj dite. Pikërisht këtu qëndron enigma e utopisë, kur e pamundura besohet si e mundur!

Si rrjedhojë, siç thuhet në Kuran, "harruan Zotin, dhe Ai bëri që ata të harrojnë veten".

Më shumë se me asgjë e askënd tjetër, njeriu sot është në një lloj konflikti të ftohtë/heshtur me veten, shenjat e të cilit kanë marrë dhenë. Nga njëra anë, mund të themi ashtu "lehtshëm" se kjo është pasoja që shkakton ankthi pa përgjigje/qëndrim i qenies-në-botë. Kurse nga ana tjetër, mund të themi me siguri të plotë se, nëse ka një çështje që meriton përqendrim dhe thellim në këtë kohë, është pa dyshim njerëzorja, natyrisht jo vetëm nga pikëpamja fizike dhe e rrethanave që po krijohen, por, mbi të gjitha, nga pikëpamja metafizike – sepse gjithë çfarë po ndodh në botën e kapshme nga shqisat, nuk është gjë tjetër vetëm se pasojë e një shtrembërimi apo ngërçi të madh metafizik.



Ja pra që njeriu nuk është fëmijë/pjellë e natyrës, sepse po të ishte, nuk do përjetonte kurrfarë ankthi, e si rrjedhojë nuk do shtronte asnjë pikëpyetje dhe konflikti me veten do ishte thjesht një pamundësi.

Pa kthjelluar çështjen e origjinës, nuk mund të hidhet hapi i parë për të mbajtur qëndrimin e duhur mbi ankthin. E nëse hidhet ky hap, atëherë qenia përballet me një tjetër "ankth", i cili ka burim/objekt, dhe nuk e topit qenien si i pari, por e motivon drejt përmbushjes.

Trajtat e konfliktit me veten sa vijnë e bëhen edhe më të papritura edhe më befasuese. Këto trajta po shfrytëzohen në formë masive sa në industrinë e filmit (mbase përfaqësuesi më tipik i kulturës masive), sa si subjekte për letërsinë e për artin pamor (i cili ka kohë që është zhytur në realitet, duke u bërë vetëm një zgjatim i tij në trajta paksa të tjera), deri edhe për formate të caktuara spektakli humori, ku, natyrisht, pjesë e tyre dhe brenda vetë vorbullës së shënjuar janë edhe shënjuesit.

Një qenie e tillë, sa sipas Darvin-it, që u orvat shkencërisht të eklipsonte origjinën; sa sipas Freud-it, që i bëri thirrje për t'u "çliruar" nga kufijtë tradicionalë (si ndalesat, tabutë, komplekset etj.); e sa sipas Sartre-t, që *de facto* e mbështeti Darwin-in me formulimin pikant "*l'existence précède l'essence*[1]", e sa sipas *neo*-istëve të tyre, gjendet sot kryekrejt në udhëkryq e tërësisht e paralizuar përballë çdo pushteti që e mësyn me devizën e përhershme që *kështu duhet të jesh*.

Pra, për sa më sipër, del që njeriu nuk lind, por bëhet, dhe duhet të bëhet me patjetër, cilado qoftë kostoja e eksperimenteve në këtë drejtim.

Kush e merr përsipër të llogarisë vetëm kostot fizike të shekullit që lamë pas dhe të këtij në të cilin kemi hyrë? A ekziston ndonjë ekuacion që merr përsipër të zgjidhë thjesht dëmet fizike që i janë shkaktuar njeriut në emër të njeriut qoftë dhe vetëm në "shekullin e madh të zhvillimit të paprecedent e të arritjeve të paimagjinueshme më parë"[2]? Çfarë paskemi arritur kështu?

Një qenie e tillë është krejt e çarmatosur, sepse është bërë shumë që të harrojë thelbin me të cilin vjen, madje edhe të distancohet prej tij me vetëdije për të qenë e "lirë", për ta gjetur atë rrugës, ku të dalë, ndër rrethana të cilat na japin trajtë, në vend që t'ua jepnim ne atyre; ndër rrethana që na farkëtojnë si mos më përçudshëm, në vend që t'i farkëtonim ne si mos më përshtatshëm për të ruajtur thelbin me të cilin lindim/vendosemi si qenie-në-botë, atë thelb që tani ua kërkojmë me vrull e pezëm rrethanave, ndërkohë që e kemi përbrenda – ato vetëm sa na e kanë vënë në gjumë me një anestezi fantastike.

E si mund të jetë i lirë njeriu kur ka humbur lirinë e brendshme dhe çdo veprim e ndërmerr jo së brendshmi, por së jashtmi, në varësi të rrethanave, ashtu si t'ia diktojnë ato.

Lira përjetohet dhe manifestohet njëherësh kur njeriu i zotëron rrethanat, e jo e kundërta.

Por, i gjithë problemi është se këtë duhet ta meritojmë.


Dhe pas kësaj, pyetja që nxjerr krye pashmangshëm është:

A është normale kjo normalja jonë?

Nganjëherë sjelljet tona të kujtojnë Charlie Chaplin-in në kasollen e vet në filmin *Dyndja drejt arit*, kur ky merret me punë shtëpie pa e ndierë fare se banesa e tij po lëkundet, po shket për në greminë.

1. Ekzistenca i paraprin thelbit.
2. Siç thërrasin sot mbetjet e projektit të iluminizmit.

Në përgjithësi jemi të prirë të mendojmë se rendi në të cilën jetojmë është në rregull, që gjërat janë përbrenda një normaliteti që përsoset, dhe kështu rendi na duket i natyrshëm, sepse kështu bojatisin politikanët, analistët dhe intelektualët e oborrit dhe mediat e kontrolluara, që shpërndajnë kartolina të parajsës këtu dhe tani. Kur dalim nga shtëpia, shtëpitë dhe ngrehinat shumëkatëshe që na rrethojnë gjithandej na ngjajnë më shumë sikur janë pikuar nga një planet inteligjent qysh prej kohësh që nuk mbahen mend, e jo "thjesht" si ndërtesa të projektuara nga njeriu e të bëra po nga njeriu për njeriun. Profesioni që ushtrojmë na duket si i domosdoshëm për mbarëvajtjen e harmonisë në botë. Bisedat apo diskutimet që bëjmë me miq apo të njohur i shohim si të nevojshme për të ndryshuar *status quo*-në në vendin tonë. Pozita dhe profesionet e të tjerëve, cilatdo qofshin dhe pavarësisht si ushtrohen, jo vetëm që na duken pjesë e një rendi normal, por na zhysin shpeshherë edhe në lakmi sëmbuese.[3]



Specialistët dhe ekspertët që ngjyejnë ekranet dhe gazetat me pudrën bio i marrim si fallxhorë të përshtatur që na rrëfejnë se çfarë duhet të bëjmë e si duhet t'i bëjmë gjërat. Rrobat që përdorim janë bash ato që duhet të jenë; as që e çojmë nëpër mend se ndonjëri mund të dalë lakuriq ose me një veshje të "çuditshme" e të shprazë një karikator kallashnikovi ndër kalimtarë – madje, kjo na vlen vetëm sa për pakëz humor spontan, ngaqë pak gjë e qenësishme ka mbetur për t'u shkëmbyer. E kur kjo ndodh, si në rastin e Breivik-ut[4] e të qindra sivëllezërve e simotrave të tij këndejpari tokës së humanizmit, mbajmë gojën hapur përballë njëri-tjetrit, në pritje të ndonjë anestezie lokale.

Po ashtu, as që e çojmë ndër mend se mbi ne mund të shfaqet një avion bombardues e të shfarosë një qytet të tërë për disa sekonda, nëse na kap lapsi i ndonjë të (super)fuqishmi; apo, tanimë këto janë taktika/teknika të vjetruara, sepse kjo po ndodh ngadalë (jo si ekspresi që gjerbim nën stres mëngjeseve pa ag) përmes farmacive dhe ushqimeve që konsumojmë? Edhe bankat që i kemi në çdo qoshk strategjik në kuadër të urbanistikës postlaike, na duken se mu aty ku janë duhet të jenë, se përndryshe na derdhet qyteti si *cola* ndër copa akulli standarde. Bankat janë vetë paraja e përkthyer në tri përmasa (3D), ose një instalacion & performancë postmoderne me shkas nga paraja dypërmasore. Po, bash bankat, mbretëreshat e kohës që kanë më shumë skllevër se ç'kanë patur të gjitha mbretëritë e kaluara të marra së bashku. Edhe këto pra na duken krejt të natyrshme!

Vetëm të ashtuquajturat skandale[5], që u bë një kohë e gjatë që janë bërë thjesht *intermexo*-t e mediave, sikur na tundin pakëz, por vetëm për e shumta tre ditë, se vjen radha e tjetrit. Ose gjëmat a tragjeditë – edhe këto sikur na shkundullojnë, ndoshta më shumë për faktin se na duket vetja aq të pafuqishëm, sa edhe fjalët nga ngecin në grykë.

Vetëm kështu duhet të marrim vesh ne? Jo. As këto nuk po na bëhen mësim. Jemi rënduar aq shumë vetëm me pësime metafizike, saqë komunikimi me veten dhe me *tjetrin* sa vjen e na bëhet edhe më i pamundur, ose postabsurd. Me sa duket jetojmë në një kohë postabsurde. Po ç'është postabsurdja? Pse, i kemi dhënë gjë përgjigje absurdit? Jo. Po nihilizmit? Jo. Po iluminizmit? Jo. U dashka shkuar pak larg... E kush po e vret mendjen për këto! Këto janë punë për filozofët; meqë i kanë shpikur, le t'i gjejnë vetë po të duan.

E nëse të gjitha këto na duken normale, atëherë le të urojmë njëri-tjetrin për tullën që kemi vënë në këtë ngrehinë. Por, askush nuk do e marrë iniciativën të urojë i pari!

E në të kundërt, atëherë le të merremi me dritaret, se, në gazmend e sipër, kemi harruar t'ia bëjmë.

Konkluzion

Vetëm ai që nuk e njeh sa dhe si duhet besimin dhe botëkuptim e vet, mund të jetë i ekspozuar ndaj ndikimit për të cilin folëm, i cili, si e analizuam, tëhuajëson. Kjo është një çështje sa e brendshme për secilin veçmas, por edhe një çështje që ka një lidhje të fortë me dijen, pra se sa ia dimë vlerat asaj që përfaqësojmë. Përsiatja dhe thellimi në dije ka qenë dhe mbetet përmendja më e fuqishme për çdokënd, gjë që përbën një shpluhurosje të sigurt të qenies nga shtresat e harresës që i mbivendosen gjatë rrugës si qenie-në-botë, aq më tepër sot, që me sa duket ka një ngërç në adresimin e vetes te një model i caktuar.

3. Meqë jemi në këtë pikë, Picasso-ja thoshte se "nuk ka rëndësi se çfarë bën artisti, e rëndësishme është kush është artisti".

4. "I rënduar nga ana psikike", na thanë! Mos ndoshta ishte i rënduar nga ana metafizike?

5. Me çfarë morali janë të tilla, përderisa çdo gjë është e lejuar ose përderisa qëllimi e justifikon mjetin, siç na kanë mësuar hebrenjtë babaxhanë?

XHAMIA E SLLOVËS

FOTO NGA A. KALI



Hutbe të zgjedhura

Ferid Piku

Feja DHE NJERIU I MIRË

Omer Ibnul Hatabi (r.a.), teksa po rrinte me disa prej shokëve të tij në një shtëpi të thjeshtë, i pyeti ata: "Çfarë dëshire keni, që t'jua plotësojë Zoti?"

Ata u menduan dhe i pari tha: "Do të kisha dëshirë që kjo shtëpi të ishte e mbushur me pasuri e ta shpërndaja në të katër anët e botës për njerëzit nevojtarë."

Dikush tjetër tha: "Do të kisha dëshirë që kjo shtëpi të ishte e mbushur me armë, që t'u vijmë në ndihmë atyre, që u është bërë padrejtësi." Foli i treti, foli i katërti e ai vetë heshti. Pastaj shokët e pyetën: "Po ti, o prijësi i besimtarëve çfarë dëshire ke?"

Ai tha: "Unë do të kisha dëshirë që kjo shtëpi e thjeshtë të ishte e mbushur me burra, si Ebu Ubejde Ibn Xherrah dhe t'i shpërndaja në të katër anët e botës, t'u sillnin njerëzve mirësinë!"

Omer Ibnul Hatabi (r.a.), ishte nga ata njerëz, që e dinte se suksesi vjen nga besimtarët, vjen nga njerëzit e mirë. E dinte se, po të kishte qoftë dhe një shtëpi me burra si Ebu Ubejde ibn Xherrah, do të ndryshonte gjendja e kësaj bote. Omeri (r.a.), e dinte se njeriu i mirë e sjell pasurinë, sjell armën, bën strukturat dhe i heq të gjitha pengesat që mund t'i dalin përpara.

Islami është fe e Zotit, është fe e gjithë njerëzve, është fe e ekuilibruar dhe e natyrshme.

Tani, ç'kërkon Islami prej njeriut? Ç'kërkon prej familjes? Çfarë kërkon ky Islam prej botës?

Ky Islam kërkon gjënë më kryesore, **NJERIUN E MIRË**.

Objektivi kryesor i kësaj feje është të edukojë një njeri të mirë, qoftë dhe një, por ama ky të jetë njeri i mirë. Nuk është fjalë e lehtë të edukosh një njeri të mirë. Mund të ndryshojë bota, mund të lëvizin malet prej vendit të tyre, mund të ndryshojë rrjedha e lumenjve, mund të rregullohen rrugët tona, mund të mos ketë ndërprerje dritash dhe uji, por pyetja është nëse ndryshon njeriu. Ky është problemi serioz, problemi më i madh.

Njeriu mund ta ndryshojë veshjen e tij, shtëpinë e tij, mund t'i përmirësojë dhe kushtet e tij, por pyetja që të rri në zemër është: "A ka ndryshuar ky njeri?"

Islami ka ardhur për ta ndryshuar njeriun, për ta përmirësuar atë, për ta bërë atë njeri të mirë.

Prandaj vëllezër, sikur të punonte shteti e të jepte investimet më të mëdha për të edukuar njeriun e mirë, do ishte gjëja më e madhe që mund të bënte ai shtet. Prandaj shoqëria duhet të përqendrohet te njeriu i mirë. Nëse njeriu është i mirë, atëherë ai ka për t'i bërë rrugët, ka për t'i sjellë edhe dritat, ka për t'i rregulluar të gjitha. Diçka të tillë nuk e them unë, por e ka thënë historia.

Sikur shkolla të punonte për të nxjerrë një nxënës të mirë, që në të ardhmen ai t'i shërbejë shoqërisë, kjo do të ishte gjëja më e madhe që mund të bënte ajo shkollë.

Sikur prindi të mundohej të edukonte një fëmijë të mirë, që nesër të bëhej njeri i mirë, ky do të ishte kontributi më i madh që ky prind do të bënte për të gjithë njerëzit e tjerë.

Sikur vetë njeriu të rrinte pak me veten e tij, të bëhej njeri i mirë, kjo do të ishte puna më e madhe, investimi më i madh që mund të bënte për gjithë botën, për gjithë shoqërinë.

Profeti Muhamed (a.s.), ishte i zgjuar. Ai realisht nuk ndërtoi kështjella as kala, nuk vendosi gur mbi gur, por u mor me njeriun, me edukimin e tij për 13 vite në Mekë dhe 10 vite në Medine. E gjithë puna e tij ishte njeriu i mirë dhe këtu investoi gjithçka, sepse e dinte se njeriu i mirë i sjell të gjitha. Pikërisht këtë bëri Islami. Ai nuk fitoi me ushtri, as me pasuri e as me kështjella, por fitoi me njerëzit e mirë. Këta njerëz hynë në zemrat e njerëzve të tjerë, se ishin të drejtë, ishin të mëshirshëm. Ata nuk ishin njerëz mashtrues, njerëz që pushtonin për qejfet e tyre dhe mbarë bota e pa se ata ishin ndryshe, ishin njerëz të mirë dhe prandaj ua hapi zemrat, ua hapi dhe shtëpitë. Për këtë investoi profeti Muhamed (a.s.).

Sot, ne krenohemi me punën e atyre që ishin para nesh. Shikoni xhamitë e myslimanëve. Është gjë e mirë

që xhamitë të jenë të bukura. Por kush është brenda këtyre xhamive?

Shikoni kështjellat e lashta të myslimanëve. A ka burra brenda këtyre kështjellave?

Nuk është ky civilizimi vëllezër. Civilizimi islam pati në qendër njeriun dhe të gjithë duhet të kontribuojmë për njeriun.

Kush është njeriu i mirë? Të gjithë njerëzit duan të jenë të mirë, madje thonë: "Jemi njerëz të mirë". Zoti ka vendosur disa rregulla, me të cilat mund të matet njeriu, që me të vërtetë të quhet njeri i mirë.

Njeriu i mirë, pikë së pari është ai njeri që beson në Zot, është njeriu që beson në veten e tij. Ai ka besuar se nuk ka ardhur kot në këtë jetë, se ka një Zot të mëshirshëm, një Zot që e ka krijuar në formën më të bukur. Ky Zot i ka dhënë mendjen, i ka dhënë të gjitha aftësitë: aftësinë për të folur, për t'u shprehur, për të punuar, madje i ka dhënë edhe aftësinë për të kundërshtuar Allahun (xh.sh.). Ky është Zoti i gjithësisë. Nëse njeriu nuk beson te ky Zot, ky njeri realisht nuk ka vlerë.

Njeriu i mirë është ai që beson tek Allahu (xh.sh.), është njeriu që beson tek vetja e tij. Ai nuk sorollatet natën e ditën, pa ditur se ku të shkojë. E di se ka ardhur njëherë dhe ka për të dalë prej kësaj bote. Çdo njeri është unik në botë dhe myslimani e di këtë. Ai punon, sepse e di se është mëkëmbës i Zotit në tokë, prandaj mundohet të bëjë mirë, t'i shërbejë kësaj toke, ta rregullojë atë, se ia ka lënë amanet Allahu (xh.sh.).

Njeriu i mirë është ai që e di se një ditë ka për të dalë përpara Zotit. E di se ka për të dhënë llogari për gjithçka para Zotit, i cili e ka parë në çdo moment.

Ai njeri që nuk beson në jetën tjetër, kushdo qoftë, nuk ka mundësi të rrijë pa mashtruar, sepse nefsi është i dobët. Kurse njeriu, që e di se do të dalë një ditë përpara Zotit, në mos sot, nesër do të bëhet njeri i mirë patjetër dhe do të mundohet të përmirësohet çdo ditë.

Njeriu i mirë është ai që e ka çliruar njëherë e mirë mendjen e tij dhe ka thënë: "Këtu ka vetëm një Zot, nuk ka zot tjetër veç Allahut". Nuk adhurohet pushteti, nuk adhurohet pasuria, nuk adhurohet epshi, adhurohet vetëm një, Allahu (xh.xh.). Njeriu i mirë ka kuptuar se edhe gjëja më e vogël i shërben asaj që është më lart, e ka kuptuar se bota jo-organike i shërben botës bimore, bota bimore i shërben asaj shtazore e të gjitha këto bashkë i shërbejnë njeriut.

Po ti, o njeri, kujt i shërben? Ti për kë je? Gjithçka qenka për ty. Ti vallë, për kë je? Njeriu i mirë e ka kuptuar thënien, ku Zoti thotë: "***Unë i krijova xhindët dhe njerëzit, vetëm për adhurim***". (Dharijat: 56)

Prandaj ai e kujton Allahun (xh.sh.), në çdo moment dhe çdo punë e bën për të fituar kënaqësinë e Tij. Por kur ky njeri nuk njeh Zotin e gjithësisë, nuk respekton Allahun (xh.sh.), vallahi e ka treguar jeta, se askush s'ka për ta respektuar këtë njeri, sepse ai s'ka respektuar veten e tij.

Njeriu i mirë është njeriu i virtytit dhe moralit, njeriu i pastër, i pastër në shpirtin e tij, i pastër në mendjen e



tij, i pastër në rrobën dhe trupin e tij. Ai është i pastër në të gjithë kuptimin e fjalës "i pastër". Shembulli më i mirë është profeti Muhamed (a.s.). Ai (a.s.), ka thënë: "*Mua më ka edukuar Zoti dhe ma ka përsosur edukatën, prandaj merrmëni për shembull*".[1] Atë nuk e edukoi prindi, por e edukoi Allahu (xh.sh.) dhe e bëri atë njeriun më të moralshëm."

Njeriu i mirë është ai që është i drejtë, është i mëshirshëm, është besnik, është bujar me të gjithë njerëzit.

Njeriu i mirë nuk është ai që thonë çifutët: "Brenda nesh, çifutëve, duhet të respektojmë rregullat, ndërsa me njerëzit e tjerë nuk ka problem, se nuk janë njerëz, janë gjysmë njerëzish, madje janë kafshë." Njeriu i mirë nuk është kështu. Njeriu i mirë është njëlloj me të gjithë njerëzit e tjerë, besimtarë apo jobesimtarë qofshin, sepse gjithçka e bën për Allahun (xh.sh.).

Ky është njeriu, për të cilin ka nevojë sot bota. Njeriu që në çdo situatë është i rregullt, është i moralshëm, nëse në të vërtetë beson në Allahun (xh.sh.).

Sipas fesë islame, njeri i mirë është ai që respekton mendjen e tij, që mëson, që lexon, që e ka kuptuar se fjala e parë që zbriti, ishte fjala "**IKRA" (lexo)**. Ai njeri që është i paaftë në zanatin e tij, i paaftë në klasën e tij, që pret ndihmë prej të tjerëve, nuk është njeri i mirë në konceptin islam.

Ti mund të jesh i mirë në zemrën tënde, por je i paaftë, të tjerët të shikojnë me mëshirë dhe Zoti nuk e do diçka të tillë. Ai nuk do që besimtari të shikohet me mëshirë, përkundrazi do që ti të jesh më i afti, më i miri, më i miri për fëmijët e tu, për familjen tënde, më i dobishmi për njerëzit e tjerë.

Kjo fe na ka mësuar, se nuk është ndonjë habi e madhe të jesh shkencëtar dhe të jesh besimtar, pasi kjo është gjëja më normale. Habia më e madhe është të pretendosh se

1. Nuk është hadith. Shejhul islam Ibn Tejmijeh thotë: "Ky nuk është hadith, ndërsa domethënia e fjalës është e vërtetë".

je shkencëtar dhe nuk beson te Zoti, apo beson tek Zoti dhe nuk mëson.

Kjo fe na ka mësuar se të dyja janë prej Allahut (xh.sh.). Ky është njeriu i mirë, njeriu që çdo ditë lartëson veten e tij, çdo ditë përmirëson shkencën e tij, njeriu që zbaton urdhrin e Zotit.

Allahu (xh.sh.), shprehet në shumë vende në Kuran: "A s'e keni parë veten tuaj? A s'e keni parë botën ku jetoni? A s'e shikoni ushqimin që hani?" Kujt i drejtohen këta urdhra?

Neve na drejtohen të gjitha. Pra Allahu (xh.sh.), duket sikur na thotë: "Shikojeni botën, mësoni dhe përfitoni çdo ditë"!

Njeriu i mirë është njeriu i punës, nuk është ai që rri në xhaminë e tij e nuk del, duke menduar se "më mirë jam këtu, jam më i qetë me Zotin e gjithësisë", por është njeriu që derdh djersën e tij për t'i shërbyer të gjithë botës. Njeri i mirë është ai që ka kuptuar se puna është ibadet, puna është xhihad i shenjtë. Puna më e mirë është t'u shërbesh fëmijëve tuaj me djersën e ballit, që nesër të mos shtrijnë dorën.

Njeriu i mirë e ka kuptuar drejt hadithin e profetit (a.s.), i cili ka thënë: "*Nëse Kiameti është duke ndodhur dhe ndonjëri prej jush ka në dorë një fidan, le ta mbjellë atë*". [2]

Njeriu i mirë është ai që beson, se ushqimi më i pastër është ushqimi që e fiton me djersën e ballit. Njeriu më i mirë është tregtari, që është besnik. Profeti (a.s.), ka thënë: "*Tregtarin besnik e ringjall Zoti me shehidët dhe me dëshmorët në rrugën e Allahut (xh.sh.)*".[3]

Njeriu i punës fatkeqësisht po humbet në xhamitë tona, po humbet në ambientet e myslimanëve. Sot shohim myslimanë, që kanë ngatërruar dynjanë me ahiretin, besimin tek Zoti me mbështetjen tek Zoti, njerëz që s'po kuptojnë se puna ka qenë dhe është ibadet, siç është namazi, si çdo lloj adhurimi tjetër. Ky është njeriu që do Zoti i gjithësisë.

Një nga myslimanët bashkëkohorë, Zoti e mëshiroftë, e përshkruante njeriun mysliman prej të cilit pritet hajr me 10 cilësi:

Ai thoshte: "Njeriu i mirë që duam të edukojmë, duhet të jetë:

1- I shëndoshë në besimin e tij.
2- I rregullt në adhurimin e tij,
3- I fortë në moralin e tij,
4- I rregullt në trupin e tij,
5- Me kulturë të gjerë,
6- I aftë për të fituar,
7- I dobishëm për të tjerët,
8- Shumë kërkues ndaj vetes së tij,
9- I kujdesshëm ndaj kohës së tij,
10- I sistemuar në punët e tij,

Prej këtij njeriu, dashtë Allahu, do të vijnë shumë mirësi".

Qëllimi kryesor i kësaj feje është njeriu i mirë. Islami kërkon njerëz të punës dhe jo njerëz të librave, as njerëz të historisë. Mos thuaj: "Ka qenë babai im, ka qenë gjyshi im", por tregoje me punën tënde se kush je ti. Ky është njeriu që kërkon Zoti i gjithësisë, njeri që e tregon veten e tij me punë, me angazhim.

Për ta përmbledhur, dua që të mbani mend dhe të kuptoni dy gjëra:

1- Gjëja e parë: A e di se kontributi më i madh që mund të bësh, është rregullimi i vetes tënde. Nëse ti mundohesh të rregullosh veten tënde, ke bërë gjënë më të madhe. Nëse dëshiron ta lartësosh fenë e Zotit, lartëso besimin tënd. Feja është me njerëz, nuk është me xhind, nuk është me krijesa të padukshme. Ne jemi pjesë e fesë. Kur ti e respekton veten tënde, kur ti ngre veten tënde, ke ngritur fenë e Allahut (xh.sh.). Prandaj profeti (a.s.) tha: "*Xhihadi më i madh është xhihadi me veten*".[4] Shpesh rrimë dhe bëjmë llogaritë e të tjerëve. Nëse njeriu do të merrej seriozisht me veten e tij, nuk do t'i dilte koha as të shikonte nga tjetri e jo më të merrej me të metat e tij. Prandaj le t'i kthehemi vetes sonë, të korrigjojmë gabimet dhe të përsosim punët dhe moralet tona, sepse tek e fundit, Zoti do të na pyesë në Ditën e Gjykimit vetëm për punën tonë.

2- Gjëja e dytë: Të punosh me një njeri, me qëllim që ta bësh atë njeri më të mirë, është gjëja më e madhe. Profeti (a.s.), shfrytëzonte rastet më të habitshme për të bërë një njeri të mirë.

Në betejën e Hajberit, profeti (a.s.), caktoi si komandant Aliun (r.a.). Pasi i dha shpatën, i tha: "*Merre o Ali dhe dije se, nëse Allahu (xh.sh.), të bën shkak që një njeri i vetëm të udhëzohet në Islam, do të ishte më mirë për ty sesa e gjithë dynjaja me ç'ka brenda*".[5] Edhe në ato momente Profeti (a.s.), mendonte për vlerën e madhe që ka besimi dhe njeriu i mirë.

Mendoni pak vëllezër. Dikush është bërë sebep që ne kemi hyrë në këtë fe. Përse të mos bëhemi unë e ti shkak, që dikush të udhëzohet në Islam. Kjo është gjëja më e madhe që ne mund të bëjmë. Ai, për të cilin ti do të bëhesh sebep, do të bëhet sebep për një të tretë. Kështu shtohet e mira dhe pakësohet e keqja.

E lus Zotin e gjithësisë me mëshirën e Tij më të pafund, me cilësitë e Tij më të bukura, me emrat e Tij më të lartë të na udhëzojë tek rruga e mirë, të na ndihmojë të bëhemi njerëz të mirë. Të na e tregojë rrugën e mirë tamam siç është ajo e të na japë forcë ta ndjekim atë, të na e tregojë të keqen siç është e të na japë forcë t'i largohemi asaj. E lusim Allahun (xh.sh.), të na bëjë njerëz të mirë, njerëz që kontribuojnë për familjen e tyre, për fëmijët e tyre, për shoqërinë e tyre.

Amin!..

2. **Hadith i vërtetë**. Ahmedi (3/191). Shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të vërtetë.

3. **Hadith i pranuar për shkak të dëshmive përforcuese**. Tirmidhiu (1209). Shejh Albani e vlerëson hadithin të dobët, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të pranuar për shkak të dëshmive përforcuese.

4. **Hadith i dobët**. Bejhakiu në Zuhd (384). Hafiz Iraku e vlerëson h - dithin të dobët.

5. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (2847) dhe Myslimi (2406).

kur suksesi bëhet mëkat!

Dr. Aid El Karni

Kur popujt jetojnë në injorancë dhe prapambetje, sulmohen nga sëmundja e fanatizmit medhhebor (juridik fetar), nga ngurtësimi ideor dhe autoritarizmi politik. Për rrjedhojë, ky individ, nëse ndeshet me të vërtetën, nuk njeh vetëm se atë çfarë është lindur në të e që e ka trashëguar nga etërit e tij.

Në këtë kontekst, Allahu i Lartësuar, lidhur me idhujtarët thotë: **"**(Idhujtarët thanë:) **I kemi gjetur etërit tanë në një fe dhe ne po ecim pas gjurmëve të tyre."**

Në këtë situatë, këta popuj e konsiderojnë opinionin kundërshtues, edhe nëse është i drejtë, të gabuar dhe të papranuar. Kësisoj, ata mësyjnë dhe i turren çdo novatori dhe të suksesshmi.

Volteri, sikurse vjen në librin "Kënaqësia e të folurit" të Davidit, thotë: "Suksesi është një "mëkat", që e kryejnë disa njerëz me qëllim të mirë, porse kolegët e tyre nuk ua falin atë."

Vërtet, sa vlera dhe ndere të strategëve, i përdhosën injorantët. Të mjafton të shikosh sulmet, agresionet dhe armiqësitë me të cilat të marrët dhe të poshtëruarit prej idhujtarëve, i përballën profetët (a.s.).

Disa strategë heshtën dhe nuk e thanë të vërtetën, të influencuar nga frika e turmës dhe zemërimi i masës.

Mbi këtë realitet, Sheukiu thotë:

Të mençurit e kuptuan bretkocën,
Kur "Kam ujë në gojë", - ajo tha:
A është e mundur të flasë,
Dikush që gojën plot me ujë e ka?

Ngjashëm shprehet poeti i madh Ebu Zejd Muhamed ibn Ahmed es Sudejriu:

Sa veta fshehin çka që nuk e trazojnë,
S'ia beson as edhe më të afërmit person,
Pasi druhet se shkarja e tij tjetrin e gëzon,
Paçka se tjetri dukshëm, dashuri reflekton.

Kuptimi i kësaj është se ka shumë e shumë njerëz, që bartin në kraharor sekretin e tyre personal, të cilin nuk mund ta nxjerrin nga goja e t'ia thonë dikujt, qoftë ai edhe më i afërti i të afërmve; të influencuar dhe të zhgënjyer nga individi, të cilit nuk mund t'i besohet asnjë sekret, nuk mund t'i qahet asnjë hall, madje që e gëzon gabimi dhe shkarja jote, që shtiret se është në krahun tënd, ta shfaq shoqërinë dhe dashamirësinë, porse brendia e tij është e nxirë nga smira dhe antipatia kundër teje, më zi se shufra e hekurit, të cilën e ka shpërfytyruar zjarri dhe tymi.

Shkëlqesitë dhe të suksesshmit, që përballen me sulmet dërrmuese të trashanikëve, i ngushëlloj me biografinë e shkëlqesisë së krijesave, Profetit (a.s.), që u përball me injorancën e injorantëve, aq sa kundër tij dhe thirrjes së tij u formuan fraksione idhujtarësh viranë, dyfytyrëshash besëprerë, hebrenjsh komplotues, të krishterësh smirëzinj dhe të afërmish të vrazhdë; por pavarësisht gjithë kësaj ai (a.s.), vijoi të bënte durim, të shpresonte shpërblimin e Zotit të vet, të rezistonte, të fitonte dhe së fundi, të kurorëzohej me kurorën: **"Ne të dhamë ty një fitore të sigurt."**

Në këtë kontekst, poeti Abdullah el Berduniu, në lavdërim të shkëlqesisë së njerëzimit, Profetit të kombit islam (a.s.), në përshkrim të guximit, qëndresës dhe durimit të tij, thotë:

Brofi djaloshi i dashur i udhëzimit,
Veshur me rrobën e dritës dhe zjarrmimit,
Në pëllëmbën e tij pishtari udhëzon,
Në gjak ka besimin që çdo tiran e sfidon.

Shiko epokën e zgjerimeve të myslimanëve, sesi u arrit reformimi, novacioni dhe u shpalosën kraharorët karshi mendimit ndryshe të kapërdishëm, sesi kombi islam u angazhua me zgjerimet, triumfet, ndërtimin dhe civilizimin.

Kurse, kur kombi islam u ligështua dhe gjendja e tij u dobësua, ai ra në luftërat fantazëm të konfliktit medhhebor (juridik fetar), fanatizmit dhe imitimit të verbër, në hijen e udhëheqësve dhe tiranëve, disa prej të cilëve qenë fëmijë e disa qenë të rritur mendjelehtë; aq sa për disa prej tyre Dhehebiu dhe Ibn Kethiri thonë: "Ky udhëheqës u preokupua shumë me vashat, pirjen dhe ahengun. Ai ishte i pasionuar pas zënies së qenve dhe deshve."

Në kohën e të këtillëve u bojkotuan kreativiteti mendor, reformimi shkencor, liderët e fesë (imamët), gjenitë dhe të kualifikuarit. Asokohe u burgos Ibn Tejmije, u përndoq Ibn Khalduni, u vra El Mutenebiu në shkretëtirë, u izolua Ali ibn Rushdi në shtëpinë e tij, u dogjën librat e Ibn Hazmit dhe u përzu nga qyteti i tij, u eliminua Lisenu Din ibn Khatabi...

E gjitha kjo, sepse novacioni, suksesi, përparimi dhe talenti, janë mëkate që s'i falin dështakët, parazitët dhe përtacët.

Shqipëroi: Altin Torba

REFORMA ÂSHT SHPIRTI I MYSLIMANIZMIT

Në numrin shtatë të rivistës së vlefshme "Zani i Naltë" me kënaqë të madhe të shpirtit lexuem artikullin e z. Salih Vuçiternit, qi fliste mbi nevojen e reformavet të Xhema-ati Islamijes. Gjendja e jonğ e sodshme si Mysliman, sakt âsht për t'u dhimët e për t'u vajtue, për arsye se gadi në kurrnji pikpamje nuk pajton kerkund me parimet e bukra të Dini Islamit. Prandej âsht mjeft arsye e madhe të thohet se, Myslimani deri sa mos të ndjeki praktikisht urdhnat e nalta të Kur-anit Shêjt, kurr s'ka me qenë i zoti me çue krye për m'u mëkambë si njeri i qytetnuem e i kulturuem, por gjithmonë ka me qenë mbrapa e i poshtnuem.

Nji qi ka studjue për s'afërmi fen Islame, nji qi njef mirë dispozitat Kuranore e nji qi ka kuptue shpirtin e fjalvet të H. Muhamedit, me të vertetë çuditet kur të na shofin ne Myslimant se sa jemi largue prej Dini Islamit. Un kujtoj se muhafezqarlleku (konservatorizma) ndër ne âsht kuptue aq keq sa qi me dinin t'onë s'ka të bâjë asnji fije. Dispozitat ndryshojnë me ndryshimet e kohës, âsht nji formul i prem qi s'na lên t'a pranojmë âshtu si duen t'a marrin nji palë. Përndryshe, kishte me dashtë m'u thanë se Kaide-i Usulija (el-Ahkamu tetegajjeru bi tagjiri'z-Zaman) sot s'ka mâ fuqi. Me çë sy të mirë e këqyrë mbandej Dini Mubini Ahmedija atê qi perpiqet të ndreqi nji send qi âsht në zhgatrrim e sipër, atê qi gjallë nji gjâ të re për dobin e njerzis, kujtoj se s'ka nevojë aq me e permendë.

Atëherë pra ne, për me muejtë e me qindruem si element Mysliman në kohen e sodçme, ne ket kohë qi dija e shkenca po vijnë dita me ditë tue perparue e tue bâ evolucjonin e vet, na duhet të diftohemi pak të gjallë, të ndjekim dhe na pak a shum gjurmat e gjyshnavet e të stërgjyshnavet t'onë e aty kû të shofim mâ të voglen dobi e interresë t'onen, të shpetojmë sa mâ parë të bâjmë reformë.

Gjyshat e stërgjyshat t'onë, s'kan qenë jo, me fjalë të thata Mysliman, por e kanë pasë diftue vedin me vepra; atê qi kanë thanë me gojë e qi e kanë besue me zemër, e kanë bâ edhe me punë e s'u âsht dhimët as shpirti as parja. Këtê qi thomi, e provojnë udobisht hajratet qi kanë lânë. Po, gjyshat t'onë, e kanë pasë imanin e fortë, sa qi efekt' i madh qi ka bâ besimi në shpirt të tyne, i ka shty të bâjnë punë të mira, të cilat kanë me kujtue shpirtnat e tyne për jetë të jetës.

T'i këqyrim pak për s'afërmit nji herë veprat e bukra të gjyshavet t'onë: shif nji herë xhamijat qi kem; shumicen e tyne i kanë goditë ata me të hollat e veta; s'kanë mjaftue me kaq por mbassi i kanë shtrue edhe mirë e mirë, për m'i mbajtë çilë e gjallë në kambë, kanë lânë për to edhe Vakfe – kû dugâjë, kû tokëe ku pare me devër – për me muejtë kështû me mbajtë imamin e mezinin e në rasë se kanë me pasë ndonjiherë nevojë për meremetim, le të kenë me se me e goditë; kanë ngrefë medreze e kanë çilë mejtepe, tuej lânë edhe për to gjithnji vakfe; kanë menduem për pritëm, sa qi deri për talebe qi ndjekshin medrezet, kanë lanë vakfe, qi t'u vihet disi në ndihmë; ata burra skanë mjaftue me kaq, por me vepra të mira kanë shkue edhe mâ përtej; kanë ndreqë me paret e tyne udhë të mira, kanë bâ ura e kaldreme tuej lânë edhe për këto, gjithnji vakfe, qi të meremetohen e mos të lêhen m'u prishë; ata burra ken bâ edhe mâ: kû kan pa se ka nevojë, pa i u dhimët aspak të hollat, me nji herë kan çilë pusa uji, qi të kenë njerzija se kû të marrin ujë; njerzvet të mdhaj qi kanë pasë nji famë për të mirë, s'janë kursye me i u bâ tyrbe, për mos me lanë qi të harrohet si emni si e mira e tyne; qe se edhe për këto gjâna, lânë prap vakfe. Na këtû s'po ngjatemi mâ gjatë qi t'i numurojmë nji nga nji edhe të mirat tjera qi kanë bâ e lanë mbas vedit, por po mjaftojmë me kaq, tue i ngrehë për nji herë vrejtjen si vedit si juve o lexuesa të ndershëm, qi të vijmë pakës në mend e të shofim se sa mirë kanë punue e se sa parangul kanë mendue për punë të shpirtit të vet e të njerzis mbarë.

E na? Mos e pvet hallin t'onë! Le qi mâ nji gurë s'qem të zotët m'e shtue e m'e përmirësue por ça âsht mâ zi, u sollme mjeft keq edhe kundruell vakfevet të lânuna

e, për deri sa u organizue Drejuorija e Pergj. e vakfevet qi nisi me kontrollue hesapet e tyne, s'mendoj njeri i gjallë m'i sjellë syt makare nji herë kah këto vakfe, qi ishin nder duer t'atij e të ktij e perdoroheshin si doshin vetë, por ndejme e këqyrme për sejrë, pse na vinte zori me prishë qjefe me shoqi-shoqin. A s'âsht kshtû, a po ndoshta ka qenë shart'i vakfit në ket mënyrë?

Deklaratat e z. Salih Vuçiterrnit, qi njef për së afërmit gjendjen e xhema-ati Islamijes, s'do marrë si nji mendim e me kalue, por do vûe pa vonim në zbatim sepse për ndryshe âsht frigë se kemi me shkue në gangren e kështû edhe Dini Ahmedija, ruejna Zot, âsht në rrezikme hikë këndej pari, sikuer âsht zhdukë ndersa e sa vende t'Europës!

Pikat qi përmban deklarata se kanë nevojë të shofin reformë, sot për sod janë ato mâ të parat qi lypset të merren në dorë pa bjerrë kurrnji fije kohë. Kuer të marrim para sysh mbandej vedin që s'jemi kah bâjmë asnji ndihëm e kurrnji sakrificë, at-herë nevoja e reformave vjen e shtohet edhe mâ tepër, sa s'din gojë me e diftue. Edhe po t'u diftojshin ndopak të gjallë e të epshim ndihmat qi parashef Statusi i Xhema-atit, prep se prep çashtja e xhamijave e ajo e medrezeve ka nevojë të domosdoshme m'u marrë në dorë e me u rregullue, tuej i bâ qi të pajtojnë me kohen e sotshme mâ së miri.

Po, po; âsht nevojë domosdoshme të losim pakper së gjallit e aty kû të shofim mâ të voglen dobin t'onen sa mâ shpejt qi të jet e mundun, t'i hîhet reformës. Me thanë se s'ka mbetë në ne zerre hamijeti denijet, s'mund e tham, me thanë se na janë prishë shiset t'ona sa mos me qenë mâ t'afta me ndie e me dallue të miren prej së keqes, as ket s'due t'a tham, me thanë se na kan hikë mendt prej kreje e s'dijmë çë me bâmas ket s'më vjen t'a besoj, pse per të gjitha këto, shitemi se i kem, edhe njimend, me qenë se e vêmë gishtin në tamth e bâjmë pakës hesapë, me 'i herë kishim me ra në rrugen e drejtë të pështimit të perjetshem e të lulzimit të dishruem, prej së cilës mjerisht ka kaq kohë qi jemi larguem.

Po, aty kû të ket xhamija të teperta, të punohet sa mâ parë si mbas hyqmi sher-is. Âsht koha per ne qi Xhamijat, t'i mbajmë si kushi, tuej i ndreqë e shtrue mâ mirë se shpijat t'ona qi kemë, pse ata janë pernjiheri edhe shpijat e perbashkta t'onat e madje janë edhe qi na paraqesin para të huejve gjendjen shoqnore t'onën! Imamët e mezinat t'i paguejmë e mos t'i lâmë në nji gjendje të keqe sikuer janë sod, pse me ket gjidish, ka të drejtë të plotë me thanë z. Salih Vuçiterni, se mbas tashit sâ me bâ mâ kush djalë hoxhë, gjâ të cilen jemi tuej e pa edhe sod me sy, sa qi as hoxhët vetë, s'janë kah i bâjnë mâ bijt e tyne hoxhë, por secili po perpiqet t'i mësojë nji mjeshtri djalit të vet, qi mos t'a lânë me vuejtë, sikuer po hjek vetë! A s'âsht kështu?

At-herë si do bâhet puna e ynë? Ruejna Zot, mbas pakëskohe, do t'i kemi, nemos të gjitha përnjiherë, shumicen e xhamijave pa imamë e mezina e s'ka me pasë as se kush të prîjë as të këndojë ezanë; e n'e paçim qitë ceken qi kështû e këndej, do mund i kryej secili prej nesh këto nevoje fetare, pa qenë nevoja për imamë e mezina të veçantë, at-botë, s'mbetet çë me thanë. Por kujtoj se as puna kështû mundet me hecë as na s'kemi si me i u bâ kësajë razi. S'na jet rrugë tjetër pra veç e m'i dalë punës me kohë para e me i a gjetë fiellin qysh tash, pse në ndejshim tuej thanë se kështû s' bân e ashtû na djeg, heret e vonë do rrijmë pa kurgjâ e me duer thatë. T'a dijmë mirë edhe qi po s'bâmë njênen e tjetren, kemi m'i la duert për jetë të jetës prej myslimanizmit e at-herë vebali e gjynahi ka me qenë i gjith neve. Të marrim vesht mâ se, rri të rrîjmë, s'perkon me as nji ligjë, sado primitive qi të jet, jo mâ qi, mbas Sherjatit të H. Muhamedit!

Në qofshim se i thomi vedit tamam mysliman, në qoftë se jemi pernjimend ashtû si na k'ande m'u shitë, at-herë t'a çilim pakës kuleten e shkretë, secili natyrisht mbas kerçikut e takatit qi të ket e mos të rrijmë me folë fjalë kote, pse prej fjalve kësodore do shkojmë dita me ditë edhe mâ teposhtë. Jo jo, në qoftë se na dhimet dy parshi sikuer âsht kah na dhimet, at-herë mos t'u bâhemi makare ferrë nepër kambë atyne qi u vjen për ndoresh me ndreqë nji send qi ka nisë m'u prishë!..

Po edhe për medreze do vue pikërisht në zbatim mendim'i z. Salih Vuçiternit, pse kështû si janë sod në shumicen e qarqevet, s'mund të na apin për pritem elementin e duhun. S'e bânë mâ koha qi talebeja të rritet me xherr d.m.th. me lëmoshë, me pare iskatesh e zeqatit. Talebeja qi do bâhet nesër hoxhë, të mbahet mbrenda nji konvikti, të shohë nji dishiplinë të fortë, të veshet hieshëm, t'ushqehet mirë, pa i u prekë e thye kerkund nderi e izzeti nefsi, qi kështû kuer të bâhet mbandej neser hoxhë, të dalë si kushi me ndjenja të plota në vend, sa të jet i zoti me rrojtë me ballë çilë, pa qenë nevoja e kuej e, për me muejtë m'i sjellë e m'i sigurue vendit kësi hoxhësh, sa mâ parë do bâ syprimim'i gjith medrezeve qi kem e, t'ardhunat e tyne mbandej, t'i pështeten të gjitha nji medrezes së vetme, e cila të jet e zonja me pregaditë për pritem hoxhë të zotët e dijes e të punës qi të kryejnë mâ së hishmit misjonin sa të lartë aq të shêjtë të vetin.

Me qi jam krejtsisht i bindun se me të vûemit në zbatim dy pikat essencjale të deklaratës së bâmun mbi nevojen e reformave, pozicioni i ynë sa më i mënershem aq i rezikshëm, me'i herë kishte m'u sjellë me fitim të plotë në favor t'onin, i shoqnohem me gith mish e shpirtë kushtrimit qi ep z. S. Vuçiterni, kushtrim, të cilit jemi qind për qind të sigurtë se i Nderti Këshilli Kontrallues i Xhematit t'onë, pa dyshim ka me iu përgjegjë...

Marrë nga revista "Zani i Nalte",
n. 9, fq. 277, Prillë 1927.

PJESHKA DHE SHALQIRI, DY FRUTAT VERORE



Të hash një pjeshkë në ditë nënkupton furnizimin e trupit me rreth 15% të kërkesave të përditshme të vitaminës C, e rëndësishme për mbrojtjen nga infeksionet e ndryshme.

Konsumi i frutave verore, sidomos e shalqirit dhe pjeshkës, duhet të bëhet edhe për shkak të vlerave ushqyese dhe kuruese që ato kanë. Në studimet e fundit është vërejtur se shalqiri është një ndër frutat që ka përqindjen më të lartë të ujit, 93 për qind të energjisë. I konsideruar si një ndër frutat më të freskëta, shton arsyet e konsumit më shumë gjatë kësaj vere të ngrohtë.

Po kështu, jo më pak arsye ka edhe pjeshka, një frut që, përveçse furnizon trupin me energji, ndihmon organizmin në tretjen e ushqimeve.

Shalqiri

Nga të gjithë frutat, shalqiri e ka përqindjen më të lartë të ujit, 93 për qind dhe një vlerë të ulët të energjisë, vetëm 20 kalori për njëqind gram. Për shumë njerëz, shalqiri është një freskues ideal veror. Studimet e fundit tregojnë se ky fryt i shijshëm mund të jetë edhe një mjet i rëndësishëm për uljen e shtypjes së lartë të gjakut.

Mineralet dhe shtypja e gjakut

Nëse keni tension të lartë të gjakut, mjekët së pari do t'ju këshillojnë të zvogëloni konsumimin e kripës. Sipas revistës "Journal of Medical Association", konsumimi i zvogëluar i natriumit ka një efekt të kufizuar në uljen e shtypjes së lartë të gjakut dhe një efekt minimal te njerëzit me shtypje normale të gjakut.

Megjithatë, hulumtimet e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zbulojnë se konsumimi i matur i natriumit të kombinuar me konsumim të shtuar të kaliumit, kalciumit dhe magneziumit, minerale që gjenden në fruta, perime dhe produkte më pak të yndyrshme të qumështit, i shërben zvogëlimit të shtypjes së lartë të gjakut më shumë se vetëm kufizimi i konsumimit të natriumit. Këto katër minerale: natriumi, kaliumi, kalciumi dhe magneziumi ndihmojnë në rregullimin e shtypjes së gjakut.

Hulumtuesit nga Universiteti USDA në Nevadë dhe Oklahoma, kanë bërë një hulumtim në të cilin të anketuarve u është rritur niveli i argininës për 22 për qind, pasi kishin pirë lëng shalqiri për tri javë në secilën shujtë. Arginina është një substancë e nevojshme për të prodhuar monoksid të natriumit, i cili ndikon në zvogëlimin e koagulimit të gjakut dhe mbron nga infarkti. Studimi ka përfshirë 23 vullnetarë, të cilët çdo ditë kanë pirë 1560 gram lëng nga shalqiri.

Përfitimet shtesë

Vetë emri i këtij fruti në anglisht (watermelon) tregon se nga çka është i përbërë. Nga të gjitha llojet e frutave, shalqiri ka më së shumti përqindje të ujit, 93 për qind dhe vlerë të ulët energjetike, vetëm 20 kalori për 100 gram. Shalqiri është një diuretik i shkëlqyeshëm, sepse stimulon aktivitetin e veshkave dhe rrit prodhimin e urinës, që lehtëson zhdukjen e toksinave. Yndyra pothuajse nuk ka fare, por janë të pasura me karrotenoide dhe likopene.

Pjeshka

Pjeshka, simboli i jetëgjatësisë dhe pavdekësisë



në Kinë, ka origjinën e vet në këtë vend ku është kultivuar për më shumë se 5000 vjet. Ky frut i ëmbël është freskues, me pak kalori dhe i shëndetshëm. Ai është i përbërë nga 90% ujë dhe mineraleve të ndryshme, ndër të cilat më i bollshëm është kaliumi dhe më pas, natriumi, hekuri, kalciumi dhe fosfori.

Konsumi

Të hash një pjeshkë në ditë, nënkupton furnizimin e trupit me rreth 15% të kërkesave të përditshme të vitaminës C, e rëndësishme për mbrojtjen nga infeksionet e ndryshme, thelbësore për fortifikimin e eshtrave dhe absorbimin e hekurit në gjak. Përveç kësaj, një marrje e duhur e vitaminës C zvogëlon rrezikun e kancerit së paku 70%.


Një element tjetër i rëndësishëm është betakarrotene, e cila stimulon melaninën që favorizon nxirjen dhe ndihmon lëkurën të qëndrojë elastike dhe e re. Jo rastësisht pjeshka përdoret gjerësisht në prodhimin e kremrave kozmetike dhe maskave të fytyrës. Ndër të tjera, pjeshka ka dhe vlera antioksiduese.

Elementet

Ajo pasuron organizmin me minerale, stimulon lëngjet e stomakut dhe rregullon tensionin e gjakut, për shkak të përmbajtjes së kaliumit dhe manganit. Ajo plotëson organizmin me mineralet e humbura nga djersa. Pjeshka është e përsosur si një vakt i lehtë pas mëngjesit, pa shtuar sheqer, tretet lehtë dhe prandaj është e përshtatshme për ata që kanë probleme me tretjen.

Këshillohet të hahet larg vakteve, pasi "përzierja" e qumështit dhe karbohidrateve mund t'i shkaktojë parehati zorrëve. Së fundi, duhet të jeni të vetëdijshëm se nuk duhet të pini shumë ujë pas ngrënies së këtij fruti, sepse rrezikoni acidin cianidrik që ndodhet në pjeshkë.

USHTRIMET FIZIKE NGADALËSOJNË PLAKJEN



Të moshuarit, me moshë mesatare 70 vjeç, që morën pjesë në studim, u krahasuan me një grup personash më të rinj, mosha mesatare e të cilëve ishte 21 vjeç.

Në fillim të studimit, midis dy grupeve, siç mund të kuptohet, dallimi ishte i madh. Të moshuarit nuk kishin ndonjë problem shëndetësor, por kurrë nuk kishin kryer ushtrime të tilla fizike në një mjedis si ky.

Për 6 muaj, nga një orë çdo ditë të javës, të rinjtë dhe të moshuarit ndoqën të njëjtin program fizkulture. Specialistët, autorë të studimit, shpresonin të vërtetonin se ushtrimet fizike ndihmojnë në përtëritjen e forcave. Por ajo që ata zbuluan ishte se mes të moshuarve, ushtrimet fizike përmirësuan dukshëm funksionin mitokondrial.

Mitokondria furnizon qelizat me energji. Me rritjen në moshë ndodh mosfunksionimi mitokondral, çka sjell dobësimin e muskujve apo humbjen e elasticitetit të tyre dhe si rrjedhim uljen e aftësive fizike.

Në fillim të studimit, njerëzit e moshuar ishin thuajse 60 përqind më të pafuqishëm sesa të rinjtë. Në përfundim të studimit, atletët e moshuar, megjithëse ende më të dobët sesa të rinjtë, treguan një përmirësim prej 20 përqind në shtimin e energjive.

Kjo pjesëmarrëse e moshuar thotë se mund të ushtrohet për 30 minuta pa ndjerë asnjë lodhje. Ndërsa ky i moshuar thotë se tani pas ushtrimeve ai ndihet shumë më mirë dhe tepër i kënaqur.

Simon Melov pranë institutit BUCK për të moshuarit, që kreu studimin, thotë se kjo përtëritje e energjisë dhe fuqisë fizike tek të moshuarit tregon se kurrë nuk është vonë për të kthyer prapa procesin e plakjes.Ai thotë se gjatë studimit shumë të moshuar thanë se ndjenin vështirësi në përballimin e programit të ushtrimeve, por pas studimit ata e ndjenë vetën me energji të shtuara dhe gëzimi u shkëlqente në fytyrë.

NUMRI I FËMIJËVE REFUGJATË SIRIANË ARRIN NJË MILION

Agjencitë e OKB-së thonë se numri i fëmijëve të detyruar të largohen nga Siria ka arritur në një milion, ndërsa numri i fëmijëve të zhvendosur përbrenda Sirisë arrin dy milion.

Lufta dyvjeçare, përpos 100.000 viktimave sipas numrit zyrtar, ka shkatërruar me dhjetëra mijëra familje.

Tri të katërtat e këtyre fëmijëve refugjatë thuhet të jenë nën moshën 11- vjeçare, sipas OKB-së.

"Fëmijët sirianë po humbin shtëpitë e tyre, familjarët e tyre dhe të ardhmen e tyre," tha komisioneri i lartë i OKB-së për refugjatët, Antonio Guterres.

"Edhe pasi kalojnë kufirin në siguri, ata janë të traumatizuar, nën depresion dhe në nevojë të arsyes për shpresë," tha ai.

Shumica e këtyre fëmijëve kanë arritur në Turqi, Liban, Jordani, Irak e Egjipt dhe një numër në rritje i sirianëve janë duke ikur për në Afrikën Veriore dhe në Evropë.

KOMUNITETI MYSLIMAN TURK REFUZON NDIHMA NGA OKB, SHKAK HESHTJA NDAJ MASAKRAVE NË SIRI

Dijaneti turk ka refuzuar ndihma financiare nga OKB-ja për një projekt që synonte parandalimin e dhunës ndaj grave, si shkak heshtja e OKB-së ndaj sulmit me armë kimike në periferi të Damaskut, që la të vrarë qindra civilë të pafajshëm të mërkurën.

Projekti ishte një bashkëpunim në mes Dijanetit turk dhe Ministrisë së Familjes dhe Politikave Sociale dhe do të përfshinte kontributet e zyrtarëve fetarë në luftën kundër dhunës në familje. Në ceremoninë e nënshkrimit zëvendëskryeministri Bekir Bozdag, ministrja Fatma Sahin dhe kreu i Dijanetit Turk Prof. Mehmet Gormez, njoftuan se ata kishin vendosur të refuzojnë mbështetjen financiare dhe se do t'i financonin këto projekte me mjete vendore turke.

Përfaqësuesja e UNFPA (Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara) për Turqinë, e cila ishte e pranishme në ceremoni, u informua me këtë vendim nga Prof. Gormez.

"Para se të merret me çështjen e dhunës në familje, OKB-ja duhet së pari të ndalojë masakrimin e popullit. Për këtë projekt ne nuk do të shpenzojmë as edhe një qindarkë nga OKB-ja," tha ndër të tjera Gormez

TURQIA, DIPLOMACI SEKRETE PËR TË TAKUAR MURSIUN

Ministri i Jashtëm turk Ahmet Davutoglu tha të mërkurën se Turqia po kryen diplomaci "sekrete" me Egjiptin, për të takuar presidentin e burgosur Muhamed Mursi.

"Nëse politika efektive dhe aktive është të bisedojmë me administratën e tanishme, por pa folur për Mursin, ne nuk do ta bëjmë këtë. Por, në qoftë se politika aktive e jashtme është që të përdorim diplomacinë sekrete, atëherë ne tani për tani po e kryejmë atë," tha Davutoglu në një intervistë televizive .

Ai hodhi poshtë akuzat se Turqia ka marrë anën e Vëllazërisë Myslimane të Egjiptit, duke thënë se "ajo që ka rëndësi nuk është Vëllazëria Myslimane, por ekzistenca e një administrate legjitime në Egjipt."

Lidhur me ndërmjetësimin turk për të zgjidhur krizën në Egjipt, Davutoglu tha se "në mungesë të kontaktit në mes të palëve, ndërmjetësimi nuk është i mundur."

Ai shtoi se Turqia kishte punuar ditë e natë për të bindur të gjithë ministrat e jashtëm në botë për të lëvizur në veprim.

"Nëse ne do ta ndalim tani, Egjipti do të dëshmojë më shumë vdekje sesa Siria," tha ai.

I pyetur në lidhje me lirimin e menjëhershëm të Hosni Mubarak, Davutoglu tha: "Me Mursin nën arrest, lirimi i Husni Mubarak do ta kthejë procesin mbrapa."

Inteligjenca turke ishte takuar me Mursin

Davutoglu shtoi gjithashtu se dhjetë ditë para trazirave të 30 qershorit, kryeministri Rexhep Tajip Erdogan kishte dërguar shefin e inteligjencës turke Hakan Fidan që të takohej me Mursin lidhur me trazirat.

Sulmi kimik në Siri

Duke u përgjigjur një pyetjeje në lidhje me qëndrimin e Turqisë mbi akuzat e përdorimit të armëve kimike në Siri, Davutoglu tha se ai bisedoi me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për të lejuar hetim efektiv dhe të papenguar rreth përdorimit të armëve kimike.

Ai tha se i kishte kërkuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së të takohej për të diskutuar sulmet.

"Turqia do të përgjigjet në mënyrën më të ashpër ndaj grupeve që kanë kryer masakrën," tha Davutoglu, duke iu referuar sulmit të djeshëm që la 1300 viktima.

LABORATOR FLUTURUES PËR STUDIMIN E MOTIT

Bota është duke u bërë një vend më i ngrohtë. Në vitin 2012 nivelet e karbonit u ngritën. Nivelet e detit arritën rekorde lartësie, ndërsa akulli i Detit Arktik kapi nivel të ulët historik. Këto janë disa të dhëna të një raporti të ri të publikuar nga Administrata Kombëtare amerikane për Oqeanet dhe Atmosferën. Disa studiues të këtyre tendencave kanë nisur të punojnë në qiell, me anë të një laboratori të ri fluturues.

Ky avion Gulfstream 5, është modifikuar për të plotësuar nevojat e shkencës. Al Cooper është shkencëtari kryesor i Qendrës Kombëtare për Hulumtimet Atmosferike, që ndihmoi në udhëzimet për krijimin e avionit nga skicat deri në fluturim.

"Komuniteti shkencor kërkonte një mjet të tillë për disa arsye: njëra ishte mundësia e punës në lartësi, pasi ata donin të arrinin pjesët e sipërme të atmosferës. Tjetra ishte zotërimi i aftësive teknike për veprime me rreze të gjatë mbulimi, për të realizuar studime me qëllime të përmasave globale."

Laboratori qiellor quhet Platforma Fluturuese për Hulumtime të Mjedisit ose HIAPER. Aeroplani mund të ngjitet deri në 16 mijë metra lartësi dhe të përshkojë një distancë prej 11 mijë kilometrash, para se të ketë nevojë për rimbushje me karburant. Ai monitoron stuhitë në kohë reale prej sipër reve dhe mund të regjistrojë kimikatet e atmosferës, ndërsa ato qarkullojnë rreth globit.





"Gjëja kryesore është se kjo na jep mundësinë të masim të dhënat në vend. Pra, instrumentet që ka ky avion regjistrojnë të dhëna gjatë fluturimit dhe matjet janë me rezolucion të lartë, shumë më të lartë sesa mund të arrihet me ndonjë mënyrë tjetër."

Në mesin e dhjetëra instrumenteve të motit në bord të këtij laboratori fluturues janë edhe këta tuba matës me cirkuite elektrike, të cilët lëshohen nga avioni për të regjistruar trysninë atmosferike, temperaturën, lagështinë dhe shpejtësinë e erës, thotë inxhinieri i atmosferës Nick Potts.

"Pajisja i mat parametrat në rënie e sipër. Dhe si një telefon celular, i dërgon të dhënat në këtë aeroplan, në vend që t'i dërgojë në një stacion bazë."

Me anë të një kompjuteri në bord, një inxhinier dërgon komandën për lëshimin e matësit prej një pajisjeje në pjesën e pasme të avionit.

"Shpesh këto pajisje përdoren gjatë uraganeve. Pra, ne shkojmë atje ku ka uragane apo stuhi dhe duke fluturuar rreth tyre vendosim se ku duam të lëshojmë matësit."

Zoti Potts thotë se të dhënat e mbledhura nga laboratori fluturues, me një vlerë prej 81,5 milionë dollarësh, mund të ndihmojnë në përmirësimin e modeleve parashikuese për uraganet dhe aktivitete të tjera të rënda atmosferike. Këto parashikime, thotë ai, janë të rëndësishme pasi mund të shpëtojnë jetë.

Arbëria Design

Të gjitha në një vend!

- Studio dizajni
- Shtypshkronjë
- Shtyp - sitë (screen printing)
- Shtypi në format të madh
  PVC • Tekstil • Bilboard
- Reklama ndriçuese
- Organizimi i fushatave promovuese
- PR dhe Marketing

TETOVË - R. e Maqedonisë
Tel. +389 44 35 33 70
www.arberiadesign.com

N.T.P. MAHMUT-HOLDING
Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux®
SPECIALIST IN PAINT
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR

NGJYRNA - LLAQE - PJESË TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN
BOYA - VERNIK - MOBILYA AKSESUARI VE MEDIYAPAN

- SAMET LLAGERA PËR FIOKA
- MEDIJAPAN
- KËND MALLTERIT
- KËND ME RRJET
- KËNDE KNAUFIT NGA ALUMINI
- RRJETA PËR FASADË


APEL GLUE
kale COLOR
KALE SUNTA VIDASI
MOBELLUX
eskim
YaPaş
smirdex COATED ABRASIVES INDUSTRY



Lagja Arbanë Prizren
mahmut_holding@hotmail.com

Mob: +377 044 242 468
+377 044 230 751
+377 044 339 452
+377 044 390 538
Turk/Mob: +90 537 887 1210

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë
dhe

SHOQATA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE DHE KULTURORE E STAMBOLLIT

Konkurs







Për rregjistrimin e kandidatëve për HAFIZ (mësimin e Kuranit përmendësh) në institutin e hifzit, Medreseja e Madhe në Gjakovë.
Në institut mësohet Kurani përmendësh, shkollimi zgjatë katër vjet dhe është falas.
Kandidati, shkollimin do të vazhdon po ashtu në njërën nga shkollat shtetërore në Gjakovë.
Gjatë këtyre katër viteve mësohet Kurani përmendësh dhe në fund nxënësi merë diplomë për Hafiz.
APLIKIMI:
1. TË JETË NË KLASEN 5 - 9.
2. TE JETË NË MOSHEN 10 - 15 VJEQ.
Afati i rregjistrimit është prej datës 15 Qershorë deri me 30 Gusht. (përparësi do të kenë ata të cilët kanë sukses të lartë, pastaj sipas rënditjes së aplikimit).
Për informacionet më të hollësishme mund të kontaktoni në: 0390/327 106, 044 535 735.
email: hafizat@live.com.







"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëpllaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesoarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mveshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.





















N.P. "LUX DEKOR"- Prizren, NRB: 80249179, adresa: rr.Tirana p.n. (zona Industriale ish - Voqare)
e-mail: luxdekor4@hotmail.com, tel.: +381 29 242 174, mob.: (vala +377) & (ipko +386) 198 709, 141 253

ÇAPA® musluk
















REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera në KOSOVË

ELEGANCË, BUKURI, CILËSI
DHE 5 VJET GARANCI
ME ÇMIME TË VOLITSHME

TSE TS EN 200 TSE TS EN 817 ISO 9001 5 ★★★★★ Yıl Garanti

www.capamusluk.com.tr www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Vurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni përmes telefonave dhe web faqes.


Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHTIT 2005



KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR





Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address:"Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail:abi@abimilk.com

www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës
Numri i licencës : AVUK-001
"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033